



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERVBAL

Tiranë, më 15.01.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen -

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Kostituimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të Përkohshëm) 2019.
2. Përgatitja e akteve nënligjore dhe e rregullave të brendshme, sipas detyrimeve dhe delegimeve të ligjit nr. 115/2016, të nevojshme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Afatet, përparësitë dhe veprimet për përgatitjen dhe miratimin e tyre në kohen më të shkurtër dhe të arsyeshme.
3. Informacion për pozicionet vakante, të shpallura nga Presidenti i Republikës, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë, për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, numrin e kandidaturave dhe administrimin e dokumentacionit përkatës.
4. Informacion për problematikën lidhur me pozicionin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, numrin e kandidaturave dhe administrimin e dokumentacionit përkatës.
5. Çështje të organizimit, dokumentimit dhe administrimit të dokumentacionit dhe të çështjeve, si edhe mbi nevojat e mbështetjes administrative dhe me personel nga Gjykata e Lartë për mirëfunksionimin dhe efektivitetin e veprimitarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------------|------------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 7. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 8. Medi Bici | (anëtar zëvendësues) |
| 9. Gurali Brahimllari | (anëtar zëvendësues) |
| 10. Klodiana Veizi (Mema) | (anëtare zëvendësuese) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Genci Gjonçaj, përfaqësues i kryetarit të Kuvendit.
3. Ulsi Manja, kryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar “Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” në Kuvend.
4. Enkelejd Alibeaj, zëvendëskryetar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar “Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” në Kuvend.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :

1. Agnes Bernhard, drejtuese e misionit EURALIUS
2. Anita Mihailova, eksperte e EURALIUS
3. Klodian Rado, ekspert i EURALIUS
4. Michelle Lakomy, këshilltare ligjore rezidente.

HAPET MBLEDHJA

Ardian Dvorani - Mirëdita të gjithëve zonja dhe zotërinj.

Duke vërejtur se anëtarët e KED dhe anëtarët zëvendësues të zgjedhur me short nga Kuvendi, sikurse edhe subjektet e ftuar janë të pranishëm po e deklaroj të hapur mbledhjen e parë të KED (Të përkohshëm) 2019.

Përpara se të kalojmë në punimet sipas pikave të rendit të ditës, në cilësinë që më ngarkon ligji si kryetar i KED 2019, *së pari*, më lejoni që fillimisht t'iu uroj mirëseardhjen në Gjykatën e Lartë, e cila është edhe selia e KED, pra edhe ambienti jonë natyral i punës.

Së dyti, meqenëse fillimi i veprimtarisë, apo më saktë kjo mbledhje e parë e KED 2019, përkon me fillimin e vitit uroj të keni shëndet, lumturi dhe mbarësi për vitin 2019.

Së treti, kam edhe një falënderim të veçantë për gjithsecilin anëtar dhe të ftuar pjesëmarrës në këtë mbledhje, për mirëkuptimin, seriozitetin dhe gatishmërinë e treguar në komunikim dhe në bashkërendimin e veprimeve për realizimin e mbledhjes në ditën e sotme. Shpreh konsideratën që kjo qasje e parë dëshmon përgjegjshmëri institucionale, profesionale dhe qytetare.

Sipas Kushtetutës dhe ligjit, ndonëse KED është organ kolegjal, nuk i përmbush kompetencat e tij vetëm kur është i mbledhur, por edhe nëpërmjet veprimtarive komplekse dhe intensive të përgatitjes së çështjeve për vendimmarrje e që do të kërkojnë angazhimin e anëtarëve të veçantë.

Prandaj, për anëtarët e Këshillit, pjesëmarrja si në mbledhje ashtu edhe në veprimtaritë që paraprijnë dhe përgatisin çështjet që kemi në kompetencë për të vendosur, nuk përbën thjesht një detyrim formal. Herë kolegjalisht dhe herë individualisht, është e detyrueshme që të përmbushim detyrat tona në substancë gjatë trajtimit të çështjeve që kemi në kompetencë. Edhe përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë tona janë jo vetëm kolegjiale por edhe individuale.

Mendoj se, edhe Avokati i Popullit, jo vetëm ka të garantuar të drejtën e pjesëmarrjes, por edhe ka detyrën kushtetuese e ligjore që të vëzhgojë dhe kontribuojë me mendimet e tij, si në mbledhjet dhe në veprimtaritë e KED.

Njëkohësisht, edhe pse sipas ligjit nuk është e detyrueshme, pjesëmarrja në mbledhjet e KED të përfaqësuesve të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit dhe dy deputetëve të nderuar, jam i bindur se do të mbështesë dhe do të ndihmojë veprimtarinë e këtij Këshilli për të pasur një ecuri pune, mendime, qëndrime dhe vendimmarrje jo vetëm në përputhje me ligjin, por edhe sa më të pjekura e sa më cilësore.

Në çdo rast vlerësoj se përbën vlerë të shtuar për mirëfunksionimin e një organi kolegjal, mundësia dhe nevoja për të dëgjuar dhe shkëmbyer mendime. Nuk është e thënë që, në çdo rast e për çdo çështje, të jemi të gjithë të një mendje. Por, dëshira dhe durimi për të dëgjuar dhe për të respektuar radhën e fjalës, mendimin dhe kontributin e gjithsecilit pjesëmarrës në mbledhjet tona, duke pasur parasysh edhe pozicionin e gjithsecilit, do të na ndihmonte të gjithëve të përmbushnim me sa më shumë sukses detyrën.

Këto konsiderata vlejné akoma më tepër për këtë Këshill, i cili duhet të përballojë punën përgatitore dhe duhet të vendosë së paku për 8 pozicione vakante, kjo në kushtet e jashtëzakonshme kur Gjykata Kushtetuese nuk është funksionale, për shkak se ka vetëm 1 anëtar në detyrë dhe ende nuk është zgjedhur Inspektori i Lartë të Drejtësisë, veprim pas të cilit mund të kryhen edhe hapat e tjera për ngritjen dhe funksionimin e këtij institucioni kushtetues.

Të nderuar zonja dhe zotërinj.

Dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj se, në proceset e diskutimeve dhe përgatitjes së akteve të reformës në drejtësi, por edhe pas miratimit të paketës së kësaj reforme, të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë kanë pasur dhe vijojnë të kenë mbështetjen dhe asistencën e pazëvendësueshme të institucioneve ndërkombëtare. Pa asnjë hezitim, do të veçoja dy prej tyre: EURALIUS dhe OPDAT.

KED ka jo vetëm detyrimin ligjor, por edhe e ka të domosdoshme që, përpara se të fillojë punën me verifikimin dhe vlerësimin e kandidaturave, të përgatisë dhe miratojë aktet rregullatorë të brendshme dhe aktet nënligjore normative që lidhen me rregullimin e hollësishëm të kompetencave verifikuese, vlerësuese dhe renditëse të kandidaturave për Gjykatën Kushtetuese dhe ILD.

Për këtë qëllim, KED 2018 ka kërkuar dhe ka siguruar përgjatë vitit 2018 mbështetjen institucionale dhe me ekspertizë nga misioni EURALIUS. Grupi i përbashkët i punës, ku kanë marrë pjesë anëtarë të KED 2018, kanë përgatitur tashmë një pjesë të projektakteve, të cilat, secili prej jush i ka në dispozicion në tavolinë.

Tashmë i takon këtij KED 2019 përgjegjësia për të përmbyllur punën për hartimin e tyre dhe ti miratojë në kohën më të shpejtë të mundshme. Ndërkohë që, mbështetja dhe asistenca e posaçme e këtyre institucioneve ndërkombëtare do të vijojë, jo vetëm në përgatitjen e projektakteve rregullatorë dhe nënligjore, por edhe për trainimin e strukturave të KED për përmbushjen e detyrave të tij dhe në forma të tjera mbështetjeje.

Gjithashtu, duke qenë mbledhja e parë e KED 2019, ky është njëkohësisht edhe momenti që përmbyll konstituimin e këtij Këshilli. Është edhe moment solemn. Edhe në

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

mblledhjet e para të organeve të tjera të qeverisjes së drejtësisë, mund të keni vënë re se kanë qenë gjithmonë të pranishëm përfaqësues të misionëve ndërkombëtare që mbështesin e kontribuojnë substancialisht në Reformën në Drejtësi.

Prandaj, duke pasur parasysh këto motive, meqenëse ligji përcakton se mbledhjet e KED janë të mbyllura, ndërkohë që lejon vetëm në raste të caktuara të ftohen që të jenë të pranishëm e të japin shpjegime, për aq sa është e nevojshme, institucione a individë, pasi e diskutuam paraprakisht me zonjën Tusha, zëvendëskryetaren e KED dhe me Avokaten e Popullit, kemi vlerësuar ti përgjigjemi pozitivisht interesimit të misionëve EURALIUS dhe OPDAT që, përjashtimisht, të jenë të ftuar dhe të pranishëm në këtë mbledhje të parë të Këshillit, ku gjithsesi nuk ka çështje verifikimi a vlerësimi kandidaturash të cilat pashmangshmërisht kërkojnë respektimin e procedurës së mbledhjes së mbyllur.

Gjithsesi, për këto subjekte të ftuar kërkohet edhe dakordësia e anëtarëve të KED.

Anëtarë të Këshillit ka ndonjë kundërshtim?

Mirë, ju falënderoj për mirëkuptimin.

Dëshiroj të kalojmë menjëherë tek pika e parë e rendit të ditës, e cila është “Kostituimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të Përkohshëm 2019”.

Enkelejd Alibeaj - Zoti kryetar, të nderuar anëtar të KED jam i ftuar këtu të marr leje për të folur në këtë mbledhje ende pa filluar kostituimi, për të vendosur edhe paksa rregull në këtë mbledhje, sipas kompetencave që i jep ligji përfaqësuesve të Parlamentit, i opozitës jam në këtë rast. Kërkoj fjalën në këtë moment pa filluar ende rendi i ditës. Këshilla është që, besoj kushdo që e kërkon fjalën, unë e kërkoj në këtë rast, të shpreh mendimet që në këtë moment.

Ardian Dvorani - Unë përpara se të filloja të thoja mendimin tim për pikën e parë të rendit të ditës, në fakt kam menduar që mënyra e diskutimit të jetë kjo, pra të tregohet pika e parë e rendit të ditës që shqyrtohet, në fillim e merr fjalën kryetari i Këshillit duke përmbushur njëkohësisht detyrimin për të diskutuar për pikën e rendit të ditës, pas kryetarit sipas radhës dhe konfigurimit të tavolinës që ka këtë formë ashtu si na ka renditur Kuvendi në aktin e shortimit, do të marrin fjalën me radhë anëtarët e KED-së, anëtarët zëvendësues, pas tyre kemi menduar t'i jepet fjala Avokates së Popullit dhe në vijim, subjekteve që janë të ftuar, pra ku jeni edhe ju sipas radhës dhe në përfundim të këtij raundi fjale, pastaj mund të ketë debat, kjo nuk ka ndonjë radhë, por sigurisht duke respektuar një lloj disipline që të dëgjojmë të gjithë cilindo që mendon dhe vlerëson se ka edhe gjëra të tjera ende për të folur e diskutuar, pastaj për të arritur në një përfundim se si do procedohet për pikën përkatëse të rendit të ditës. Pra këtë kemi menduar si mënyrë procedimi.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Enkelejd Alibeaj - Atë isha duke thënë. Mora shkas nga fjala juaj që në përfundim të fjalës tuaj hyrëse ju sapo thatë që kalojmë te pika e parë e rendit të ditës që do të thotë efektivisht kalohet në mbledhje. Në fakt, për të saktësuar pozicionin e të ftuarve që, meqë ra fjala, nuk është në diskrecionin tuaj për të marrë pjesë apo jo. Ju mund t'i ftoni, por dera e këtij organi është e hapur për këdo nga ata të cilët sipas ligjit kanë të drejtë të marrin pjesë. E kam fjalën për përfaqësuesit e Kuvendit dhe ata që ligji përcakton. Sigurisht që është e këshillueshme dhe mirë bëtë që keni marrë një vendim edhe pse ekstra mbledhje për të marrë pjesë në mbledhje edhe përfaqësues të OPDATIT apo EURALIUSIT. Transparenca është gjithmonë e mirë dhe kjo është në diskrecionin tuaj. Pjesa tjetër pasandaj është e drejtë nëse ne e shfrytëzojmë apo jo, atë që ligji e ka përcaktuar. Pozicioni procedural i përfaqësuesve, e imja dhe e Ulsiut në këtë rast, në këtë mbledhje nuk mund të përcaktohet nga ju, jo vetëm kaq por dhe e drejta për të diskutuar për të gjitha çështjet është e jona, nuk marrim pjesë në votim, fare e qartë kjo s'e kemi këtë pretendim e kemi të qartë. Por meqë ju pretenduat që të kalojmë te pika e parë e çështjes është koha për të diskutuar, nëse do kalohet në një diskutim paraprak solemn, po dakord unë pres radhën. Besoj që isha i qartë.

Ardian Dvorani - Jo unë ju kuptova qartë. Nuk e di, ndoshta mund ta perifrazoja më ndryshe por unë besoj se thashë i falënderoj subjektet që kanë të drejtë të marrin pjesë dhe sipas vullnetit dhe vlerësimit të tyre mund të marrin fjalën kur e çmojnë të nevojshme dhe sa herë që është e nevojshme. Unë besoj se këtë thashë, nuk thashë ndonjë gjë tjetër. Kjo ishte fjala hyrëse dhe rendin e ditës ju e keni parë të shpallur tashmë, dhe pika e parë është kostituimi i Këshillit, cilat janë qëndrimet e gjithsecilit për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi të Përkohshëm për 2019-ën. Duhet të veprojnë apo nuk duhet të veprojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është pika e parë e rendit të ditës.

Enkelejd Alibeaj - Qartë që të mos e zgjasim, për këtë dua të flas, por kur të më vijë radha.

Ardian Dvorani - Po patjetër,

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ardian Dvorani - Nuk mund ta imagjinoj dot që këtu nuk do ketë mundësi për të folur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ardian Dvorani - Ju kuptova. Pika e parë është kostituimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Nuk do të kishte kuptim nëse nuk do të diskutonim, por ama do të marrim fjalën, me radhë, të gjithë. Do të kemi kujdes që të flasim me mikrofon, edhe zoti Alibeaj nuk e bëri,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

si edhe ta keni sa më afër sepse mbledhja regjistrohet. Nëse i hapim njëkohësisht mund të ketë probleme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ardian Dvorani - Mirë do përpiqemi ta respektojmë. Për çështjen e parë të rendit të ditës pra është “Kostituimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të Përkohshëm për vitin 2019”.

Unë po jap qëndrimin tim dhe mendimet e mia dhe pastaj, sikurse thashë, sipas radhës gjithsecili, pra anëtarët e Këshillit sigurisht janë të detyruar të thonë mendimet dhe qëndrimet e tyre dhe të ftuarit ta vlerësojnë vetë nëse duan të thonë mendimin e tyre apo jo.

Kostituimi, si nocion juridik, përfshin veprimet, procedurat dhe vendimmarrjet për emërimin apo formimin, p.sh të një organi publik, në rastin tonë të KED.

Kushtetuta dhe ligji përcaktojnë se KED është organ kushtetues i përhershëm, ndërsa anëtarët në përbërje të KED kanë mandat të ushtrojnë detyrën në mënyrë të përkohshme, brenda vitit kalendarik për të cilin janë zgjedhur.

Prandaj, për sa i takon kësaj përbërje të KED, tashmë të zgjedhur nga Kuvendi për të ushtruar veprimtarinë gjatë vitit 2019, diskutimin mbi kostituimin e konsideroj jo si veprim a procedurë formale themeluese, por si hapin përfundimtar përmbyllës të emërimit nga ana e Kuvendit, nëpërmjet procedurave të shortit, të përbërjes së re të KED për vitin 2019.

Ne jemi anëtarë tashmë të zgjedhur të KED për të ushtruar këtë detyrë gjatë vitit 2019 dhe detyrimi jonë është të mblidhemi si organ kolegjal sa herë është e nevojshme, si edhe për të kryer të gjitha veprimtaritë e tjera përgatitore për përmbushjen e detyrave dhe kompetencave që na ngarkon Kushtetuta dhe ligji.

Në këtë kuptim, edhe kjo pikë e parë e rendit të ditës, ka vlerën e momentit kur KED si organ kushtetues kolegjal, me përbërjen e re, edhe në mënyrë solemne, përmbush detyrimin për tu mbledhur, duke realizuar mbledhjen e parë të tij.

Krahas faktit që zgjedhja me short e përbërjes së këtij Këshilli nga Kuvendi në datën 07.12.2018 është bërë publikisht duke u përcjellë drejtpërdrejt nga media, sjell në vëmendjen tuaj që, me shkresën nr. 3897/2 prot., të datës 13.12.2018, Kuvendi na njofton zyrtarisht për zhvillimin e procedurës së zgjedhjes së anëtarëve të KED dhe për përbërjen e zgjedhur. Kopjen e kësaj shkrese e gjeni bashkëlidhur në materialet që janë në dispozicionin tuaj.

Unë kam mendimin dhe qëndrimin se, ky Këshill, i zgjedhur me këtë përbërje, jo thjesht mundet por ka edhe detyrimin të vijojë punën dhe të ushtrojë të gjitha kompetencat që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji. Vlerësoj të parashtoj, së paku për dy motive, për të cilat do të kërkoja durimin dhe mirëkuptimin tuaj për kohën që më nevojitet për tu shpjeguar.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Së pari, Kuvendi ka zgjedhur 8 anëtarë nga 9 të tillë që përcakton Kushtetuta dhe Ligji. Për shkak të mungesës së kandidaturave të mjaftueshme nuk mund të realizohej zgjedhja e një anëtari tjetër nga radhët e prokurorëve pranë gjykatave të apelit.

Pas shkarkimit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, njëkohësisht anëtar i KED, zotit Bashkim Dedja, numri i anëtarëve të KED tashmë ka zbritur në shtatë (7).

Ndërkohë, vërej se nuk mund të realizohet as edhe plotësimi i KED 2019 me 9 anëtarë pjesëmarrës në mbledhjet që do të mbajë. Për mungesë të kandidaturave, nuk ka qenë e mundur që Kuvendi të zgjedhë edhe anëtarët zëvendësues, përkatësisht për Gjykatën Kushtetuese dhe për Prokuroritë pranë Gjykatave të Apeleve. Po kështu, për mungesë kandidaturash, nuk ka qenë e mundur që Kuvendi të zgjedhë edhe anëtar zëvendësues nga Prokuroria e Përgjithshme.

Lidhur me këto rrethana, vlerësoj të evidentoj që, Kushtetuta dhe Ligji nr. 115/2016 i nxjerrë në pajtim me të, nuk kanë parashikuar jo vetëm mundësinë, por as edhe nuk e kanë konsideruar të nevojshëm që, menjëherë apo gjatë vitit kalendarik, të përsëritet procesi i përzgjedhjes me short të përbërjes së KED ose të realizohet ndonjë procedure shtesë përzgjedhjeje disa anëtarësh të rinj, përkatësisht në rastet kur nga procesi i zgjedhjes me short i muajit dhjetor apo përgjatë vitit pasardhës kalendarik ndodh që KED të rezultojë apo mbetet me më pak se 9 anëtarë, përfshirë këtu edhe rastin kur anëtarët zëvendësues nuk mund të plotësojnë këtë numër.

Nga njëra anë, pjesëmarrja në veprimtaritë dhe në mbledhjet e KED është e detyrueshme. Por, nga ana tjetër, për rastet kur nuk mund të arrihet numri prej nëntë anëtarësh, përfshirë edhe nëpërmjet mekanizimit të anëtarëve plotësues, apo edhe në lidhje me llojin e shumicës së kërkuar për votim, me synimin për të mënjeluar çfarëdo interpretimi me natyrë penguese apo bllokuese për vlefshmërinë e mbledhjeve të KED dhe për ushtrimin e kompetencave të tij, Ligji nr. 115/2016, në pikën 3 të nenit 229, përcakton shprehimisht dhe qartë se: *“Këshilli vendos me shumicën e votave në prani të të paktën pesë anëtarëve”*.

Është pikërisht ky *quorum* minimal, *prania* e pesë anëtarëve, në mbledhjet dhe veprimtaritë e KED, i cili, nëse nuk ekziston, e bën të pamundur veprimin e KED në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjes konkrete apo në tërësi, për përmbushjen e kompetencave të tij. Këtu, është thelbësore të mbahet parasysh që, në kuptim të kësaj dispozite, *prania* e anëtarëve të KED në mbledhjet dhe veprimtaritë e tij për garantimin e *quorum*-it minimal prej 5 anëtarësh, nuk ka të bëjë me vlerësimin e anëtarëve për të marrë ose jo në mbledhje. Nëse nuk kemi pengesë ligjore të konfirmuar me vendim nga kryetari apo zëvendëskryetari, si edhe nuk kemi

ndonjë rast mungese për arsye objektive, atëherë pjesëmarrja jonë në mbledhjet dhe veprimtaritë e KED është e detyrueshme.

Megjithatë, bazuar në parimet kushtetuese të garantimit të funksionalitetit të Kushtetutës dhe institucioneve kushtetuese, e që synojnë mënjanimin e situatave bllokuese për ushtrimin e funksioneve kushtetuese, unike dhe të pazëvendësueshme, sikurse janë ato të KED, pikërisht për të garantuar këtë *qourum* minimal ligjor prej pesë anëtarësh, anëtari i KED apo zëvendësuesi i tij, edhe në qoftë në pengesë për shkaqe papajtueshmërie a konflikti interesi, tashmë është i detyruar të marrë pjesë në veprimtaritë dhe në mbledhjet e KED. Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me to janë miratuar për të qenë funksionale. Garantimi i funksionalitetit kërkon interpretim dhe zbatim të tillë të normave që të parandalohen situatat bllokuese dhe të mundësohet funksionimi i institucioneve kushtetuese. Këtë qëndrim ka mbajtur Gjykata jonë Kushtetuese, në praktikën e saj gjyqësore, për raste të garantimit të funksionalitetit të institucioneve të parashikuara në Kushtetutë.

Prandaj, nisur nga ky arsyetim, kam mendimin dhe qëndrimin se, në interpretim të Kushtetutës dhe ligjeve, situata aktuale faktike e KED të përzgjedhur për vitin 2019, nuk përbën pengesë që ky Këshill, me këtë numër anëtarësh dhe përbërje, të përmbushë detyrimet dhe kompetencat që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji.

Së dyti, deri më tani, rezulton që katër (4) nga shtatë (7) anëtarët e Këshillit kanë kaluar *procesin e rivlerësimit kalimtar*, sikurse edhe një nga tre anëtarët zëvendësues të tij.

Sipas Kushtetutës dhe ligjit, rivlerësimi kalimtar për anëtarët tashmë të zgjedhur të KED, duhet të kryhet menjëherë apo me përparësi. Në këndvështrimin tim pak rëndësi ka shprehja rivlerësim kalimtar “menjëherë” apo me “përparësi”. Kjo ka të bëjë, në një masë të caktuar, me rëndësinë që ka shpejtësia e rivlerësimit kalimtar për integritetin e këtij KED. Por, nga ana tjetër, nuk përbën kurrsesi një element me natyrë penguese apo paragjyquese mbi integritetin e këtij KED, të zgjedhur me short sipas ligjit nga Kuvendi.

Jam i mendimit se rivlerësimi kalimtar i magjistratit nuk është kusht për të filluar dhe vijuar ushtrimin e detyrës së anëtarit të KED. Nëse do të ishte ndryshe, Kushtetua dhe ligji do ta përcaktonin këtë si një (para)kusht për kandidim, pra për përfshirjen ose jo të magjistratëve në listën e atyre që shortohen për anëtar të KED.

P.sh, në rastin e KLGJ dhe KLP, sikurse përcaktojnë qartë dhe shprehimisht, përkatësisht pikat 1, 4, 5 e 6 të nenit 276 dhe pikat 1, 4, 5 e 6 të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016, përpara votimit të kandidatëve nga mbledhja e gjyqtarëve dhe nga mbledhja e prokurorëve, kandidatët magjistratë që kanë shprehur interesin për të qenë anëtarë të këtyre Këshillave, paraprakisht duhet të kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Pra situata ligjore është e ndryshme thelbësisht në rastin e KED sepse për ne nuk ka as kushte dhe as ndonjë procedurë të tillë pararendëse ndaj asaj të zgjedhjes me short të anëtarit të KED.

Së fundi, sipas kuptimit tim mbi Kushtetutën dhe ligjin, anëtarësia në KED është detyrë për të gjithë ata që janë magjistratë. Pra, nëse zgjidhen me short, ata detyrimisht përmbushin funksionet e caktuara nga Kushtetuta dhe ligji në KED. E përmbushin këtë detyrë njësoj sikurse ata dhe të gjithë magjistratët vijnë funksionet e tyre aktuale gjyqësore dhe prokuroriale, edhe pse ende nuk i janë nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar. Ligji vendos vetëm disa (para)kushte të tjera, të natyrës së përhershme, të lidhura me vjetërsinë në karrierë dhe mospasjen e hetimeve apo ndëshkimeve disiplinore, administrative ose penale, në mënyrë që magjistrati të përfshihet ose jo në listën e kandidaturave për zgjedhje me short nga Presidenti/ose Kuvendi, por që gjithsesi nuk kanë lidhje me procesin kalimtar të rivlerësimit.

Prandaj, përfundimisht, edhe për këto motive, kam mendimin dhe qëndrimin se, në interpretim të Kushtetutës dhe ligjeve, situata aktuale faktike e përbërjes së KED të për zgjedhur për vitin 2019, nuk përbën asnjë lloj pengese që ky Këshill të përmbushë detyrimet dhe kompetencat që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji. Ne jemi gjyqtarë dhe i bindemi vetëm Kushtetutës dhe ligjeve që janë në fuqi. Ndaj edhe kemi përgjegjësinë ligjore që të garantojmë funksionalitetin e këtij organi kushtetues dhe përmbushjen e kompetencave unike dhe të pazëvendësueshme që na ngarkon vetë Kushtetuta dhe ligji.

Njësoj si ne, edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, e njeh dhe ka detyrimin të zbatojë Kushtetutën dhe ligjin. Është në kompetencën dhe përgjegjësinë ligjore të tyre që të vlerësojnë përparësinë dhe shpejtësinë e rivlerësimit kalimtar të anëtarëve të këtij Këshilli ende të pavetuar. Por kjo nuk mund dhe nuk duhet të pengojë këtë Këshill të përmbushë detyrimet dhe përgjegjësitë që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji.

Ju faleminderit për vëmendjen. Tani, sipas radhës, fjalën e ka zëvendëskryetarja e këtij Këshilli, zonja Tusha.

Vitore Tusha - Përsëritje të gjithëve.

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës që lidhet me kostituimin, mendimi im është ky Pas hedhjes së shortit më datën 7 dhjetor 2018 nga Kuvendi i Shqipërisë dhe ardhjes së momentit kohor më 1 janar 2019, organi kolegjal KED i kompozuar dhe i krijuar nga shorti i zhvilluar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor të ushtrojë veprimtarinë e tij. Në këtë kuptim, përgatitja paraprake e mbledhjes së parë që është bërë nga kryetari dhe thirrja e mbledhjes dhe veprimtari të tjera që na imponohen nga Kushtetuta dhe nga ligji, bën që ne të vazhdojmë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

dhe të përmbushim detyrimet që janë përcaktuar dhe janë në misionin tonë përgjatë periudhës njëvjeçare apo sipas veprimtarive dhe çështjeve konkrete që do të kemi, kandidaturave etj. etj. deri në finalizimin dhe krijimin e Gjykatës Kushtetuese të re dhe zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Është e vërtetë që Kushtetuta, krahas misionit, krahas kompetencave ka përcaktuar edhe numrin që duhet të ketë prej nëntë anëtarësh dhe është detyrim i organeve që të krijojnë dhe të respektojnë Kushtetutën dhe ligjin. Po ashtu ligji ka përcaktuar edhe anëtarët zëvendësues të cilët janë në funksion të garantimit dhe qëndrimit në vazhdimësi të anëtarësisë që ka përcaktuar Kushtetuta prej nëntë anëtarësh.

Po kaq e vërtetë është edhe se ligji ka përcaktuar edhe një kuorum prej pesë anëtarësh me të cilin veprimtaria e Këshillit mund të vazhdojë të funksionojë dhe të ushtrojë kompetencat funksionale. Kjo mendoj unë është çështja ose zgjidhja, pjesa më e rëndësishme ligjore e që na imponon të përmbushim detyrimin kushtetues dhe duke u devijuar paksa nga elementet teorik apo ndoshta jo thjesht teorik, ne kemi misionin që të zbatojmë detyrën që na ka ngarkuar ne Kushtetuta. Misionet e tjera i kanë organet e tjera, i kanë sipas Kushtetutës, krijimin e organit në numrin e caktuar apo bërjen e ligjeve e që janë jashtë nesh. Ne kemi gjithsecili të përmbushim detyrimin kushtetues dhe, në këtë kuptim, unë mendoj që edhe me këto kushte, me këtë anëtarësi, kostituimi ose krijimi i organit duhet të deklarohet dhe të vazhdojë veprimtaria në përputhje me kompetencën që ka.

Ardian Dvorani - Ju faleminderit. Zonja Marku fjala për ju.

Arta Marku - Faleminderit zoti kryetar. Në fakt ju e kishit përgatitur dhe e kishit ndërtuar në detaje ato lloj problematike që mund të krijojë diskutimi në këtë mbledhje të parë.

Tani për të mos rënë në përsëritje po ndalem shkurt vetëm në disa prek pikave dhe argumenteve të mia.

Nuk është kusht që anëtarët të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar. Kriteret dhe kushtet parashikohen shprehimisht në nenin 221 të ligjit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Së dyti nuk parashikohet ndonjë procedurë për zgjedhjen e anëtarëve të rinj zëvendësues në rastet e krijimit të pozicioneve vakante në këtë Këshill. I vetmi kuorum që duhet respektuar dhe që e parashikon ligji është ai për praninë e pesë anëtarëve në mbledhje. Kështu që mendoj se janë plotësuar kushtet që ky Këshill të funksionojë dhe është detyrim kushtetues dhe ligjor që të fillojë të funksionojë. Prandaj në respektim të rendit të ditës mendoj që Këshilli duhet të konstituohet. Faleminderit.

Ardian Dvorani - Ju faleminderit. Zoti Islamaj.

Fatri Islamaj - Faleminderit zoti kryetar. Përshëndes kolegët anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të ftuarit dhe pjesëmarrësit në këtë mbledhje të parë që ka për rend dite, si pikë të parë, konstituimin e KED.

Duke pasur parasysh atë që ju parashtruar në mënyrë të detajuar dhe analitike, por dhe analizën ligjore të dispozitave të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, por edhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenin 149 pika d, nuk kam ndonjë koment ose mendim ndryshe nga mënyra se si ju e parashtruat për sa i përket faktit që duhet të konstituohet ose jo KED. Nuk shoh ndonjë pengesë për secilën prej hipotezave që ju shtruat dhe bëtë analizën ligjore, kështu që nuk dua të bie në përsëritje të dispozitave, qoftë nenit 229 për sa i përket kuorumit apo nenin 221 etj. të ligjit. Thjesht i uroj suksese dhe mbarësi këtij Këshilli dhe duke pasur parasysh përgjegjësitë e mëdha profesionale dhe ligjore që KED ka në kuadër të detyrave kushtetuese dhe faktit që, qoftë Kushtetuta, qoftë legjislacioni në zbatim të Kushtetutës, ka afërsisht dy vite që pret për tu zbatuar dhe ndihet nevoja e konstituimit dhe fillimit të funksionimit të institucioneve kushtetuese dhe të KED-së me funksionit që ka. Faleminderit.

Ardian Dvorani - Faleminderit zoti Islamaj. Radha për fjalën është e zonjës Buhali.

Margarita Buhali - Faleminderit kryetar.

Të nderuar anëtarë, të nderuar pjesëmarrës Lidhur me pikën e parë që ju shtruat në rendin e ditës konstituimin, duke e lidhur këtë me numrin e anëtarëve, nuk kam ndonjë kundërshtim, bie dakord me ju. Duke pasur parasysh se mendoj që funksionimi i organeve nuk mund të kushtëzohet dhe nuk mund të pengohet për shkak të numrit të kandidatëve ose të numrit të anëtarëve në listën që kanë institucionet, qëllimi është që institucioni të ketë vazhdimësi dhe të vazhdojë të funksionojë sidomos në kushtet aktuale.

Megjithatë, unë kam një mendim ndryshe për sa i përket konstituimit, për sa i përket pikës së dytë, lidhur me faktin që duhet të ketë kaluar, minimalisht për mua, të paktën mendoj që, anëtarët e KED duhet të kenë kaluar procesin e vetting-ut. E lidh këtë me parashikimin që ka në nenin 284 të ligjit tonë të posaçëm, nisur me faktin që pikërisht që për këtë qëllim ne na quan Këshill i Përkohshëm i Emërimeve në Drejtësi dhe nuk na quan Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Mendoj se afati njëvjeçar është për çdo rast të zgjedhjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Por, duke qenë se në pikën 9 parashikohet se anëtarët e KED të Përkohshëm, dhe e thekson, i nënshtrohen rivlerësimit me përparësi, mendoj që rivlerësimi ndoshta është kushti që ne do të na japi për tu shndërruar nga një Këshill i Përkohshëm në një Këshill të Emërimeve në Drejtësi. Për këtë pjesë kam këtë mendim. Faleminderit.

Ardian Dvorani - Ju falënderoj zonja Buhali për fjalën tuaj. Radha është për zonjën Memçaj.

Fatjona Memçaj - Faleminderit kryetar. Përshëndetje të gjithëve.

Nuk shoh ndonjë argument ligjor tjetër që të parashtrohet më tej nga siç u parashtuan nga ana e anëtarëve të tjerë. Meqenëse diskutohet kalimi i procesit të rivlerësimit nga ana e të gjithë anëtarëve, gjykoj se ligjërish por edhe moralisht të gjithë anëtarët e Këshillit të vetuar ose jo e kanë tagrin për të ushtruar këtë detyrë që, për nga rëndësia gjykoj se është shumë e madhe për funksionimin e një institucioni siç është Gjykata Kushtetuese. Edhe për ato anëtarë të Këshillit që janë gjyqtar dhe që çdo ditë japin vendimmarrje nëpër Gjykata kanë të gjithë tagrin që ta vazhdojnë ushtrimin e kësaj detyre dhe prandaj ky Këshill të vijojë funksionimin. Duke i uruar suksese Këshillit dhe punë të mbarë të gjithë anëtarëve, ju falënderoj.

Ardian Dvorani - Faleminderit zonja Memçaj. Zoti Eriol ka radhën për fjalën dhe qëndrimet e tij.

Eriol Roshi - Faleminderit zoti kryetar dhe duke përshëndetur dhe pjesëmarrësit në mbledhje.

Siç u evidentua ngërçi është krijuar për shkak të mungesës së anëtarit të dytë nga Gjykata Kushtetuese dhe anëtarëve që vijnë nga Gjykata Kushtetuese në këtë Këshill dhe për moskalimin në mos gaboj të katër anëtarëve në procesin e rivlerësimit kalimtar.

Për pikën e parë mendoj se nuk shtrohet diskutimi në këtë fazë që jemi pasi në qoftë se nuk do kostitohemi për këtë shkak i bie që nuk do ketë asnjëherë Gjykatë Kushtetuese dhe asnjëherë KED. Do të arrijmë në pamundësinë e ushtrimit të funksioneve nga institucioni, gjë që fryma e Kushtetutës nuk e lejon.

Për pikën e dytë bashkohem me mendimin dhe po shprehem që ne përderisa jemi magjistratë, pra edhe pjesa që nuk ka kaluar rivlerësimin kalimtar, ushtrojmë një funksion kushtetues ndoshta jo më pak të rëndësishëm se ky për qytetarët, që është dhënia e drejtësisë, çdo ditë pa e kaluar këtë proces. Kështu që nuk e kuptoj pse në njërin rast duhet të vlejë dhe në rastin tjetër jo. Kështu që mendoj se duhet të vazhdojmë me konstituimin e plotë. Faleminderit.

Ardian Dvorani - Ju falënderoj zoti Eriol. Radha për fjalën është e zotit Bici.

Medi Bici - Faleminderit zoti kryetar.

Statusi im në këtë mbledhje ndryshon. Unë jam anëtar zëvendësues i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, kështu që nuk kam të drejtë të jap mendim, në lidhje me kostituimin, mund ta bëj vetëm atëherë kur të krijohen kushtet ligjore për të qenë anëtar i këtij Këshilli. Për të respektuar mbledhjen e parë erdha që të marr pjesë. Mendoj që ne anëtarët

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

zëvendësues nuk duhet të marrim pjesë në çdo mbledhje. Krahas saj dua të parashtroj se zgjedhja ime si anëtar zëvendësues është bërë para datës 12.12.2018, ditë që u zgjedha edhe anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Mandati im si anëtar i Gjykatës së Lartë është i pezulluar në ditën e nëntë. Kështu që nuk jam në gjendje të them që këto dy detyra funksionale mund të kryhen në të njëjtën kohë.

Ardian Dvorani - Faleminderit zoti Bici. Zoti Brahimllari.

Gurali Brahimllari - Faleminderit kryetar. Përshëndetje të gjithë pjesëmarrësve.

Edhe unë jam me statusin e anëtarit zëvendësues sipas shortit që është hedhur në Kuvendin e Shqipërisë. Megjithatë mendoj se meqenëse është mbledhja e parë e këtij Këshilli, mendoj që mund të japim mendim edhe zëvendësuesit në lidhje me konstituimin ose jo të Këshillit, pasi nuk do e kemi më herë tjetër mundësinë apo ndoshta nuk do ta sjelli rasti që të jemi në cilësinë e anëtarit, duke zëvendësuar ndonjë nga kolegët që janë anëtarë të Këshillit dhe do të na takojë pastaj, sipas pozicionit, për të qenë anëtarë.

Prandaj, shpreh mendimin se është momenti për tu konstituar si organ, kjo jo vetëm për faktin sepse është një emergjencë për momentin në të cilin kalon reforma në drejtësi. Por njëkohësisht edhe për shkakun sepse, sidomos lidhur me problematikën e kalimit apo jo në vetting të një pjese të anëtarëve të zgjedhur me short, në të cilin bëj pjesë edhe unë, që ende nuk kam kaluar vetting-un, mendoj se do të bllokohej puna e organit dhe do të bllokoheshin edhe krijimi i institucioneve të tjera.

Ndërkohë ashtu siç u shprehën dhe kolegët më parë, në tërësi, pa rënë në përsëritje, legjislacioni ka përcaktuar në mënyrë të saktë që zgjedhjen e organeve të reja të drejtësisë, siç ishte Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kërkohet në mënyrë të detyrueshme kalimi në vetting dhe pastaj votimi, në këtë rast ligji ka përcaktuar zgjedhjen nga Kuvendi dhe fillimin e veprimtarisë me procedurë të menjëhershme nga ana e organeve të vetting-ut për kontroll, por pa penguar veprimtarinë, në mendimin tim, të KED-së. Pra, përfundimisht jam pro vazhdimin të mbledhjes dhe konstituimit të Këshillit. Faleminderit.

Ardian Dvorani - Faleminderit zoti Gurali. Zonja Klodiana.

Klodiana Veizi (Mema) - Edhe unë jam anëtare zëvendësuese. Vij nga Gjykata Administrative. Nuk e kam kaluar ende procesin e vetting-ut. Që ky Këshill të mblidhet absolutisht jam pro sepse ka kuorumin e nevojshëm.

Kuptohet që ndërçi është ky procesi i vettingut. Produktet e këtij Këshilli, po them që produktet e këtij Këshilli, pra edhe vendimmarrja do të ishin absolutisht në përputhje me gjithë reformën në drejtësi nëse do kishte pesë anëtarë që do ta kishin kaluar procesin e vettingut. Kjo do të zhdukte çdo lloj paragjykimi, sepse të mendosh që ky Këshill Emërimesh

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

në Drejtësi do të kalojë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të cilët, këta duhet të kenë kaluar më parë procesin e vettingut, ndërkohë që anëtarët e Këshillit jo? Nuk më duket më e mira. Gjithsesi, që ky Këshill të vazhdojë të funksionojë, mendimi im është pro.

Ardian Dvorani - Faleminderit zonja Klodiana. Në fakt edhe arsyeja pse sot janë prezent edhe anëtarët zëvendësues është sepse kjo është mbledhja e parë, duhet ta thonë edhe ata fjalën e tyre.

Mirë tani, sipas radhës, ashtu siç i ka renditur vetë ligji, subjektet e ftuar do ti ftoja të thonë mendimet dhe fjalën e tyre. Jo, më falni, u ngatërrova në radhën sepse është Avokatja e Popullit, e cila, jo është e ftuar, por është pjesë e veprimtarive të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Ju kërkoj ndjesë.

Erinda Ballanca - S'ka problem fare. Ju falënderoj. I uroj që të gjithë pjesëmarrësit dhe anëtarët e KED-së për një punë sa më të frytshme këtë vit. Në fakt ky është një vit domethënës për KED-në dhe gjykoj që ka kaq shumë punë për të bërë për të vënë në vend atë që unë besoj se kjo reformë do duhet të sjellë te shqiptarët, një sistem drejtësie më të mirë, më eficient. Një sistem drejtësie i cili të zgjidhë me objektivitet dhe sipas ligjit problematikat e qytetarëve.

Megjithatë në rolin që unë kam, duke qenë vëzhguese dhe monitoruese e këtij organi, me atë detyrë që më ka caktuar Kushtetuta dhe ligji, nuk mund të rri pa evidentuar disa problematika, të cilat janë në vëmendjen e anëtarëve të KED-së për t'i vlerësuar, votuar, trajtuar dhe që besoj se këto problematika mund të kenë vend si shkak për vendimmarrje në këtë organ.

Unë ju dëgjova me shumë vëmendje zoti kryetar dhe ju falënderoj shumë për parashtrësën që ju bëtë në lidhje me natyrën e organit, anëtarësinë, vendimmarrjen, përzgjedhjen etj. Dhe, në fakt, nëse do të ishim përpara reformës në drejtësi, unë nuk do të kisha pasur asnjë presje për të shtuar ndaj asaj që ju keni thënë. Por, reforma në drejtësi për procesin e rivlerësimit përcakton një standard tjetër, për secilin prej nesh, për zbatimin e ligjit. Duke përcaktuar një standard tjetër, unë mendoj se, secili prej anëtarëve në këtë mbledhje, jo vetëm duhet të mjaftohet me faktin se emri i tij është dërguar nga kryetari apo Prokurori i Përgjithshëm për tu shortuar pranë Kuvendit, por duhet të vlerësojë nëse ai i plotëson kriteret e përcaktuara nga ligji.

Në sa raste në procesin e rivlerësimit kalimtar i janë bërë pyetje gjyqtarëve, pavarësisht ekzistencës së faktit x, y në atë rast konkret, nëse ti e ke zbatuar apo jo ligjin apo këtë kriter ligjor të përcaktuar qartësisht për emërimin tënd, për kandidimin tënd, për lidhjen e kësaj kontrate apo lidhjen e asaj kontrate. Pavarësisht se nuk ka pasur ndonjë shkelje në

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

lidhje me faktin, domethënë me atë që ka ndodhur, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, mjafton që të ketë pasur një shkelje të ligjit, të një dispozite apo të një vendimi të Këshillit të Ministrave, atëherë dhe gjyqtarët nuk kanë kaluar atë testin e besimit që do duhet të kishin.

Në rastin konkret, unë gjykoj se në këtë organ ka edhe anëtarë që nuk i plotësojnë të tëra kriteret e ligjit, të përcaktuara konkretisht në nenin 221 dhe konkretisht 221 pika ç, më fal, 221 pika d, që magjistrati duhet të ketë përfunduar Shkollën e Magjistraturës. Arsyeja për të cilën unë e ngre këtë problematikë është sepse, edhe në vitin e kaluar, Avokati i Popullit ka paraqitur një raport pranë Kuvendit në kuptim dhe në funksion të ligjit në kuadër të zgjedhjes së kandidaturave edhe të KED-së të mëparshme dhe ka trajtuar se kriteret e përcaktuara në ligj janë përjashtuese, nuk janë në frymën tërësore të ligjit. Këto kritere me gjendjen reale që ne kemi në sistem e bëjnë të pamundur përfaqësimin e organeve si Gjykata e Lartë apo Prokuroria e Përgjithshme me numrin e saktë apo të duhur për të bërë short pra, për t'i dhënë kuptim kësaj procedure që gjithashtu ka përcaktuar Kushtetuta. Nuk ka ndodhur asgjë në një vit, asnjë lloj iniciative dhe mund të them se, përsëri, në KED-në aktuale, u detyruan disa nga organet që kishin për detyrë për të përcjellë listat, siç është edhe organi i Prokurorisë së Përgjithshme, të dërgonin dy lista pranë organit të Presidentit fillimisht dhe më pas të Kuvendit për bërjen e përzgjedhjes.

Dhe në fakt, fakti se pse ne sot nuk kemi anëtar zëvendësues për Prokurorinë e Përgjithshme, s'kemi një anëtar nga Prokuroritë e Apeleve, është pikërisht fakti se janë zbatuar të tëra kriteret e ligjit që janë mjaftueshëm përjashtuese. Nëse do të ishin zbatuar të njëjtat kritere që janë zbatuar për anëtarësinë nga Gjykata e Lartë ne nuk do kishim mangësi në persona sot, pra nuk do të kishim çështje kuorumi dhe do të kishim të gjithë anëtarët, me të njëjtat kritere që janë zbatuar për Gjykatën e Lartë, ne do kishim edhe anëtarë zëvendësues, do kishim edhe proces shorti, sepse për disa nga kandidaturat nuk ka pasur proces shorti, sepse nuk ka pasur më shumë se një kandidaturë.

Unë besoj se institucioni, organi, duhet të funksionojë, është domosdoshmëri që ky organ të funksionojë. Por ne nuk mund të themi që, tashmë pas reformës në drejtësi, është detyrë e organeve të tjera nëse na zgjedhin apo na propozojnë apo jo, sepse mund të mos e plotësojmë një x apo y kriter, por e kanë zgjidhur ata këtë punë, sepse standardi tashmë është një tjetër.

Nga ana tjetër, besoj se misioni i parë i gjithsecilit prej nesh, përpara se të jemi anëtarë të KED-së apo vëzhgues të KED-së, është se duhet të zbatojmë ligjin, pra është një detyrim minimal zbatimi i ligjit dhe jo zbatimi i ndonjëres prej dispozitave, por i ligjit në

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

tërësi dhe i frymës së ligjit në tërësi. Kështu që unë gjykoj që do të ishte me vend që ky organ të vlerësonte, me përgjegjshmëri dhe në kuadër të standardit më të lartë të zbatimit të ligjit që pritet tashmë nga secili prej gjyqtarëve dhe në radhë të parë edhe nga ky organ.

Unë do të isha shumë dakord që, e kam shprehur edhe në raportin e kaluar në lidhje me shortin që u bë në Kuvend, ku kam thënë që kriteret janë përjashtuese se nëse do të zbatoheshin kriteret strikt do të ngeleshim pa përfaqësim nga Gjykata e Lartë në KED. Nga Gjykata Kushtetuese jo, sepse Gjykata Kushtetuese ka një kriter tjetër, parashikohet shprehimisht se mjafton të jesh një vit anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe ky është kriteri i mjaftueshëm pra ka përjashtim për ta. Ndërsa për të gjithë grupet e tjera nuk ka përjashtim dhe dispozita thotë kandidatët që nuk plotësojnë një nga këto kushte, përjashtohen nga shorti, pika 2 e nenit 221. Pra mendoj që secili prej organeve që e ka marrë raportin e vjetshëm do duhet të kishte bërë një punë që ta vinte në vend. Unë e kuptoj që kemi një problematikë vendimmarrje në Kuvend, por nga ana tjetër, ne nuk mund të rrimë pa i evidentuar këto problematika. Këto janë çështje të cilat janë problem. Prapë do ishte *okay* që ne zgjedhim të themi do të ishte më mirë ta krijojmë organin sesa mos ta krijojmë fare në kuadër të impaktit. Por do të ishte mirë që, të paktën, të gjithë emrat që do të hidheshin në short t'i nënshtroheshin të njëjtit kriter, nga secili prej atyre grupimeve të gjyqësorit apo sistemit gjyqësor që do të përfaqësoheshin në KED. Pra, mendoj se kjo është një problematikë thelbi, e cila do duhet të diskutohet në këtë mbledhje.

Për sa i përket çështjeve të tjera, unë kam qenë dhe jam e mendimit që anëtarët e KED-së mund të ushtrojnë detyrën e tyre pa iu nënshtuar procesit të rivlerësimit dhe ligji për këtë është i qartë. Dhe nga ana tjetër do të ishte bllokuese dhe i pamundur për tu realizuar kalimi prej të gjithëve i procesit të vetting-ut, për shkak se me kushtet aktuale do ta bënte krijimin e KED-së efektiv ndoshta pas dy ose tre vjetësh, sepse është e pamundur, besoj unë, që brenda një afati kaq të shkurtër kohor dymbëdhjetë muaj që i jepet detyrë KED-së, të kalojnë të gjithë vetting-un, të mblidhen, të bëjnë rregullat dhe të fillojnë të bëjnë procesin e rivlerësimit. Mendoni që procesi i rivlerësimit që do të bëjë ky organ për personat të cilët vijnë nga jashtë sistemit të drejtësisë duhet të jetë i të njëjtit standard apo i ngjashëm me atë që tashmë gjyqtarët kanë kaluar. Sepse është e pamundur që ne, gjykoj unë, por kjo është vendimmarrja juaj, që të lejohet një standard i ndryshëm për emërimin nga pjesët e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese dhe i ndryshëm një standard tjetër për ata që vijnë nga jashtë sistemit të drejtësisë. Kështu që besoj se puna do të jetë shumë e madhe dhe do të ishte e pamundur. Unë mendoj se ky organ duhet të ishte një organ me kohë të plotë, se aq kandidatura sa keni ju për të kaluar, nuk ka kaluar as KPK për një vit. Kështu që, realisht,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

është një problem tjetër goxha i madh dhe i rëndësishëm që do duhet të diskutohet besoj siç e keni vendosur në pikat e tjera të rendit të ditës.

Më falni që u zgjata kaq dhe në fakt unë jam vetëm vëzhguese në këtë organ, por e them këtë sepse është KED-ja e dytë dhe janë disa problematika që kanë pasur vijueshmëri dhe fakti që Avokati i Popullit ka pasur ca qëndrime të caktuara, doja që t'ia vija në dijeni edhe anëtarëve të KED-së, sigurisht në vlerësimin e tyre. Ju faleminderit.

Ardian Dvorani - Ju falënderoj zonja Ballanca. Nuk ka asnjë problem që u zgjatët. Nuk u zgjatët fare sepse ne nuk kemi limite kohore, por, sigurisht, e di gjithsecili prej nesh se sa kohë i duhet për të parashtruar ashtu si e mendon argumentet e tij. Kështu që ju falënderoj për mendimet tuaja. Zoti Dervishaj, nëse doni të flisni?

Bledar Dervishaj - Shumë shkurt. Për të gjithë çështjet apo problematikat që të gjithë anëtarët e KED-së dhanë opinionin e tyre, por edhe Avokatja e Popullit bëri një trajtim shterues, duhet të them se institucioni i Presidentit të Republikës e ka konsumuar këtë komunikim shkresor me Kuvendin e Shqipërisë, duke vënë në dijeni dhe partnerët ndërkombëtarë, tashmë për të dyja vitet dhe në 2017 për KED-në e 2018 dhe në 2018 për KED-në aktuale. Tashmë ky proces është përmbyllur dhe Kuvendi ka përzgjedhur për KED-në.

Ne kemi vlerësuar që për pikat e rendit të ditës të mos shprehemi po të qëndrojmë si një institucion vëzhgues në këtë mbledhje. Dhe ajo që është me rëndësi për institucionin e Presidentit të Republikës është që i gjithë procesi të jetë në frymën e Kushtetutës dhe në zbatim të ligjit. Kështu që unë do e rezervoj dhe kohën për t'ia kaluar kolegëve këtu, duke iu falënderoj edhe ju për fjalën që më dhatë.

Ardian Dvorani - Ju falënderoj unë zoti Dervishaj. Si përfaqësues i Kryetarit të Kuvendit është z. Gjonçaj.

Genci Gjonçaj - Zoti Dvorani, nëse mundet ta marrë fjalën zoti Manja dhe unë ta rimarr pak më vonë? Sepse ka një angazhim në zyrën e Parlamentit.

Ardian Dvorani - Mirë.

Ulsi Manja - Ju kërkoi ndjesë për edhe shkak të një angazhimi tjetër, në orën 11 kam në Konferencën e Kryetarëve prandaj e kërkova fjalën përpara përfaqësuesit të Kryetarit të Kuvendit.

Zoti Dvorani faleminderit për ftesën. Si mbledhje e parë më takon të them punë të mbarë dhe me krahë të lehta këtij institucioni të ri kushtetues që unë jam i bindur që gjatë mandatit të tij do t'i japë vendit Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë,

duke përmbyllur kështu zbatimin e plotë të reformës në drejtësi me ngritjen e të gjithë institucioneve të reja që përbëjnë dhe arkitekturë e kësaj reforme.

Unë mendoj që ju jeni një organ kushtetues i pavarur që ka mjaftueshëm kapacitetet intelektuale, në mos akoma më tepër në vlerësimin tim, për të gjykuar mbi zbatimin e Kushtetutës dhe ligjit. Unë në këtë tryezë nuk e kam luksin t'ju tregoj ju se çfarë thotë Kushtetuta dhe çfarë thotë ligji. Por bashkohem me zonzjën Tusha kur tha që ne kemi detyrimin të mblidhemi, të zbatojmë Kushtetutën dhe ligjin, sepse çështjet e tjera janë përgjegjësi e organit që e ka krijuar këtë organ. Në rastin konkret është një përgjegjësi mes Presidentit dhe Kuvendit, por, për të gjitha ato arsye që tha zoti Dervishi, ne e kemi ezauruar tashmë këtë fazë. Kuvendi i Shqipërisë në përmbushje të plotë të detyrimeve që burojnë nga neni 179 pika 11 e Kushtetutës, neni 149/d, pika 3, neni 284 i ligjit nr. 115/16 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” e ka përmbushur detyrimin e vet kushtetues dhe ligjor, dhe jemi sot në këtë mbledhje të parë të kësaj KED-je të dytë, të tretë në mos gaboju.

Neni 229 besoj i ka dhënë përgjigje mënyrës së funksionimit të kësaj KED-je. Është në detyrimin tuaj të mblidheni dhe të zbatoni Kushtetutën dhe ligjin. Ligji thotë pjesëmarrja është e detyrueshme dhe është i përcaktuar edhe kuorumi për vendimmarrje. Madje edhe brenda atij kuorumi për vendimmarrje, është i tejkaluar shqetësimi i ngritur nga disa kolegë lidhur me vetting-un, gjithmonë duke marrë në konsideratë edhe faktin se KPK tashmë është në punë me kapacitete të plota dhe vazhdon që të mblidhet dhe të japë vendime në mënyrë periodike.

Unë duke iu uruar punë të mbarë, edhe njëherë theksoj se ju jeni një organ kushtetues, i pavarur, kolegjal dhe keni të gjithë pavarësinë tuaj të vendimmarrjes për të zbatuar Kushtetutën dhe ligjin. Por ajo që presin shqiptarët nga ky Këshill është që sa më parë t'i japin vendit Gjykatën Kushtetuese, por edhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, si një nga organet më të rëndësishme për të disiplinuar sistemin e drejtësisë dhe sistemin prokurorial, tashmë që kanë filluar punën edhe KLGJ dhe KLP. Në këndvështrimin dhe në vlerësimin tim Inspektori i Lartë i Drejtësisë është zemra e sistemit që lidhet me kontrollin e sistemit. Një nga defektet që ka pasur sistemi jonë ka qenë mungesa e llogaridhënies dhe e kontrollit. Ndaj ky institucion që pritet të dalë nga ky Këshill për mua është shumë i rëndësishëm edhe besoj që nga kjo mbledhje, por edhe nga mbledhjet e tjera që ju do bëni në vazhdimësi, pse jo, shqiptarët presin lajme të mira. Edhe njëherë faleminderit dhe punë të mbarë, duke kërkuar ndjesë për tu larguar nga mbledhja për shkak të mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve. Faleminderit. Punë të mbarë të gjithë kolegëve.

Ardian Dvorani - Ju falënderoj së pari që ju ishit i pranishëm në mbledhje, pastaj është në vlerësimin tuaj, sipas angazhimeve përkatëse, për të vlerësuar sa kohë mund të qëndroni. Mirë atëherë, zoti Gjonçaj?

Genci Gjonçaj - Faleminderit kryetar. Faleminderit për mirëkuptimin që patët në rastin e kalimit të fjalës tek zoti Manja. Faleminderit për ftesën. Nuk do zgjatem shumë, nuk kam ndërmend të diskutoj lidhur me çështjet që ju i prekët dhe të gjithë anëtarët. Shkurtimisht, në rastin e debatit të krijuar lidhur me mënyrën e përzgjedhjes, paraqitjen e kandidaturave, hedhjen e shortit, janë gjëra të ezauruara, të përfunduara me vendimmarje dhe sot jemi në këtë mbledhje konstituive të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Sipas asaj që unë mendoj në cilësinë e përfaqësuesit të Kryetarit të Kuvendit janë të gjitha mundësitë që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi të eci shpejt dhe me vendimmarje lidhur me Gjykatën Kushtetuese dhe me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Me shumë të drejtë, juve por edhe anëtarët e tjerë thanë që ne jemi gjyqtarë dhe prokurorë. Po, ju jeni gjyqtarë dhe prokurorë dhe më mirë se ju nuk ka se kush ta lexojë as ligjin, as Kushtetutën dhe as ta interpretojë. Prandaj besoj që gjërat janë të qarta dhe nuk ka asnjë arsye për tu vonuar. Interesi më i madh publik e kërkon që vendi të ketë Gjykatë Kushtetuese. Janë mundësitë, në dijeninë time edhe Presidenti, edhe Kuvendi edhe Gjykata e Lartë, kanë depozituar kandidaturat e ardhura nga gara e shpallur nga këto institucione. Koha është më se e mundur që të kemi vendimmarje për të plotësuar vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe njëkohësisht për të vazhduar më tej me garën për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, një garë e cila duhet të hapet sa më shpejt të jetë e mundur, sipas kushteve që përcakton Kushtetuta dhe ligji, me një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Duke përfunduar ju uroj punë të mbarë dhe vërtet keni një mision shumë të rëndësishëm tanimë që kemi dhe KLP dhe KLGJ. Kjo vendimmarje do përfundojë në një farë mënyre problematikën e konstatuar deri më sot lidhur me reformën në drejtësi. Punë të mbarë edhe një herë.

Ardian Dvorani - Faleminderit zoti Gjonçaj. Zoti Alibeaj?

Enkelejd Alibeaj - Jo vetëm se e kërkova fjalën në fillim, por kam përshtypjen se ky është një nga momentet më të rëndësishme të ezaurimit të një nga hallkave më të rëndësishme të reformës në drejtësi. Jam këtu si përfaqësues i opozitës parlamentare, si një pjesë e Kuvendit të Shqipërisë që, së paku tre vite më parë, miratoi reformën në drejtësi, ndryshimet kushtetuese, totalisht me të tjera pritshmëri, me të tjera vlera romantike në atë kohë. Jam përfaqësues i Kuvendit këtu, së bashku me kolegun që sapo iku, si përfaqësues i interesit publik dhe ky ishte i dyti pozicioni im. Jam këtu përfaqësues i opozitës edhe për një

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

arsye tjetër, për shkak edhe të pozicionit të krijimit të kontrollit dhe të balancës, që të paktën në këtë situatë ku jemi është totalisht e munguar, e brishtë siç mund të jetë dhe shpresoj që përveç brishtësisë që mund të ketë ky mekanizëm kontrolli dhe balance sot, politik, maxhorancë dhe opozitë, shpresoj, uroj, që interesit publik t'i shërbeni, eventualisht, nëse do të kalohet ky moment i parë i konstituimit, gjithsecili prej jush.

Më lejoni të bëj edhe një konstatim për të qenë korrekt me Kushtetutën dhe me ligjin dhe me stadin aktual të konstituimit. Nuk jeni ende një KED e 2019-ës, as e përkohshme, jeni thjesht të shortuar. Kjo letër ju ka ardhur. Thirrja ime në këtë rast, jo këshillë, thirrje për interes publik bëhet thjesht dhe vetëm nisur nga brishtësia e garancive të munguara deri tani për reformën në drejtësi. Është thjesht dhe vetëm ndërgjegjes, prej funksionari publik, kush e ka ende. Prandaj, ky është një moment shumë i rëndësishëm, do të përcaktojë jo thjesht dhe vetëm veprimtarinë rutinore, administrative, burokratike, eventualisht të një Këshilli të Emërimeve në Drejtësi. Kini parasysh që produkti juaj, ngritja e Gjykatës Kushtetuese, eventualisht, ngritja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, eventualisht edhe kjo, jo vetëm që ka interes publik, por është një nga çështjet më të rëndësishme të reformës në drejtësi, po të doni ju edhe të debatit politik në këtë vend, që nuk është fjalë e keqe, nuk është mëkat ta thuash dhe ta artikulojsh.

Kjo është thirrja ime për qasjen që gjithsecili prej jush, si gjyqtar apo ish gjyqtar, prokuror apo ish prokuror, ka qenë dhe jo si anëtar të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Thënë kjo, opozita parlamentare mezi pret, mezi ka pritur, uron, shpreson që një orë e më parë të ngrihen institucionet e reformës në drejtësi. Jo këto që janë ngritur deri tani, me thënë të drejtën, për të qenë të sinqertë, KLGJ, KLP, ILD është një planet dhe një realitet tjetër ku politika nuk do duhet të futet as të bëjë të përvuajturin si është ngritur dhe si do ngrihet. Po ne kemi interes të drejtpërdrejtë për Gjykatën Kushtetuese sepse është institucion, veprimtaria e të cilit është e lidhur organikisht me produktin e Kuvendit. Për të qenë të sinqertë, e kush më tepër sesa opozita parlamentare në këtë rast, e jo vetëm, kërkon një orë e më parë, jo thjesht për interesat e veta pragmatiste, por si ekuilibruese e sistemit, do ta donte të kishte Gjykatën Kushtetuese. Mirë ose keq, ngritja ose jo, e legjitimuar apo jo, e Gjykatës Kushtetuese, është lëndë e parë për Kuvendin, është lëndë e parë për politikën, që do të thotë drejtpërdrejt do merrni edhe ju gjykimin tuaj për korrektësinë në zbatimin e Kushtetutës dhe të ligjit.

Kjo është mbledhja e parë e thirrur nga tetë të shortuar nga Kuvendi i Republikës. E në fakt, thirrja që unë i bëra ndërgjegjes tuaj si jurist është e tillë, unë besoj që të mos jem i gabuar që në këtë pikë të parë të konstituimit të organit, e drejta e gjithsecilit këtu është për të diskutuar, jo thjesht dhe vetëm se është thirrur në një tryezë në selinë e Gjykatës së Lartë për

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

shkak të një letre që Kryetari i Kuvendit ka shpërndarë apo thirrjes që një nga anëtarët e shortuar ka shpërndarë për një mbledhje. Jo nuk është kjo arsyeja se pse jeni mbledhur këtu e për të cilën do duhet të diskutoni. Do duhet të diskutoni qoftë edhe për profilin e juristit, edhe për mënyrën se si keni ardhur, se si jeni shortuar.

Përfaqësuesi i Presidentit të Republikës nuk e tha por po e them unë në këtë rast. Çështja e parë që do duhej të diskutohej ndoshta është sa të legjitimuar, sa i legjitimuar është gjithsecili prej jush këtu dhe për pasojë edhe kolegjaliteti që ju pretendoni të formoni. Ju kujtoj që Presidenti i Republikës për herën e tretë të formësimit të KED-së nuk e ezauroi të drejtën dhe detyrimin e vet kushtetues. Dhe ka ngritur një pretendim, i vlefshëm për tu diskutuar nga gjithsecili prej jush këtu. Sipas Kushtetutës dhe sipas ligjit, ky është leximi i Presidentit të Republikës, dy herë i aplikuar, KED i Përkohshëm është vetëm një herë dhe ngrihet vetëm në vitin e parë pas miratimit të reformës kushtetuese që do të thotë, vetëm në segmentin kohor të vitit 2017, short i cili do duhej të ishte bërë në dhjetor të vitit 2016. Premisa bazë e të cilit, pra e hedhjes së shortit, ishte përgatitja, verifikimi dhe servirja e listave të kandidatëve po i quaj për tu shortuar prej institucioneve ekzistuese të asaj kohe: Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Me logjikë, në atë kohë, Kushtetuta, kushtetutbërësit kishin parashikuar që tempizmi për formimin e KED kërkonte një fazë tranzitore, përdorimi për herë të parë i institucioneve ekzistuese, por vetëm një herë ama. Sepse siç edhe Kushtetuta parashikon organet që do duhet t'i zëvendësonin këto autoritete, Sekretarin e Përgjithshëm të KLD, Prokurorin e Përgjithshëm, Kryetarin e Gjykatës së Lartë, do të duhet të ishin dy : Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor. Madje edhe Kryetari i Gjykatës Kushtetuese do duhet të zëvendësohej nga Gjykata Kushtetuese me formacion të plotë. E thotë Kushtetuta. Afatet për ngritjen e njërit apo tjetrit institucion shkonin diku te tetë muaj pas miratimit të reformës kushtetuese. Me ekspirimin e kësaj ngjarje të sigurt të përcaktuar nga Kushtetuta, bie, rrëzohet e drejta e gjithsecilit prej këtyre katër autoriteteve për të marrë pjesë qoftë edhe në fazën periferike të formimit të institucioneve të reja. Nuk kanë të drejtë, së paku që tetë muaj pas përfundimit të afatit nga miratimi i Kushtetutës, të marrë pjesë në procesin e formimit të KED-së duke verifikuar, përgatitur dhe servirur lista, jo Prokurori i Përgjithshëm, jo Kryetari i Gjykatës së Lartë, as Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, aq më pak Sekretari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Kjo ishte arsyeja sepse Presidenti i Republikës për herë të dytë refuzoi, me të drejtë, bazuar në Kushtetutë, të merrte pjesë në një proces antikushtetues, ekstraligjor, pa legjitimim, virusi i të cilës do të mbartet, se s'ka si të jetë ndryshe, gjatë gjithë veprimtarisë, eventuale,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

nëse do të kryhet, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. E kjo është një çështje që ju do të duhet ta mbani parasysh. Shkelja kushtetuese dhe shkelja ligjore nuk është shkaktuar prej jush. Jeni të pafajshëm deri në këtë moment. Ama ajo është këtu, në tavolinë, tani, konstituimi sipas Kushtetutës ose në kundërshtim me të ,do të përcaktojë edhe këtë. Do ta merrni ju guximin për ta përthithur këtë virus antikushtetues në punën tuaj apo jo? Zgjedhja është e juaja.

E jo vetëm kaq. E gjithë veprimtaria e më pastajme e Kryetarit të Kuvendit, e habitshme, gjithmonë nga operatorët partiako-politik vijnë shkeljet kushtetuese, sesa e habitshme është që t'i ndërmerri dhe t'i përthithni ju këto shkelje të Kushtetutës, vazhdon në shkelje totale kushtetuese të përgatitjes së ca listave, të cilat, as nuk kanë bazueshmëri as në Kushtetutë, as kanë bazueshmëri në ligj, as kanë bazueshmëri në situatën faktike. Ka çuar Kryetari i Gjykatës së Lartë lista. Ka çuar Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm lista. Ka çuar edhe Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Nuk ka çuar Sekretari i Përgjithshëm i KLD-së. Janë fakte që do duhet t'i dini, nëse nuk i keni ditur. Nuk ka çuar, edhe se prej Kuvendit i është kërkuar, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, të verifikojë se cila është lista e gjyqtarëve që plotëson ato kushtet që Avokati i Popullit sapo tha. Jo, i është kërkuar cila është lista e gjyqtarëve që keni sot në disponim dhe ka çuar listën e gjyqtarëve, e paverifikuar, sepse s'kishte të drejtë, e pakontrolluar sepse s'kishte të drejtë dhe kanë operuar në hava. E çfarë ka ndodhur?

Lista që ka çuar Kryetari i Gjykatës së Lartë nuk përmban asnjë, kandidat po e quaj, që të ketë plotësuar së paku njërin prej kushteve, të ketë mbaruar Shkollën e Magjistraturës. Juve nuk e keni mbaruar Shkollën e Magjistraturës. E jo vetëm kaq, por Kryetari i Gjykatës së Lartë nuk e fut veten e vet në listë, ndryshe nga ç'ka ndodhur nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese që e ka futur veten e vet në listë, aq sa ishin. Që këtu shifet mënyra sesi interpretohet Kushtetuta apo ligji, çështje që do duhet të bëjë të mendojë këdo.

Prokurori i Përgjithshëm ka çuar një listë. Po me të drejtë, ka respektuar faktin që duhet të jenë magjistrat që ta kenë mbaruar Shkollën e Magjistraturës. Korrekte. Por, nga ana tjetër, nuk ka respektuar kërkesën tjetër që kërkon Kushtetuta dhe ligji, përfaqësuesit duhet të jenë të Prokurorisë së Përgjithshme ose të Apeleve. Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm ka servirur emrin e vet ndërkohë që nuk është e përcaktuar dhe emëruar përfundimisht si përfaqësuese e Prokurorisë së Përgjithshme. Emërimin përfundimtar të ligjshëm e ka në Prokurorinë pranë Gjykatës së shkallës së parë Shkodër. E kjo është çështje që do të duhet të diskutohet. Ka apo jo të drejtë të përfaqësohet Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, edhe pse mund të jetë e komanduar për një segment të caktuar kohor në Prokurorinë

e Përgjithshme? E për ta interpretuar këtë do duhet jo vetëm të shihet ligji, por dhe praktika, e meqë jemi në këtë rast, ju kujtoj, meqenëse unë kam qenë edhe vëzhgues gjatë procesit të përzgjedhjes së Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ju kujtoj, që është e drejta juaj ta konsultoni apo edhe detyrimi juaj për ta parë që, janë zgjedhur në KLP edhe prokurorë që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës, që detyrën e tyre si të komanduar e kryejnë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, por emërimin përfundimtar, final, e kanë në Prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë. E tua them edhe emrin. Zonja Sevdari që u zgjodh në KLP emërimin final të saj e ka, jo në Prokurorinë e Përgjithshme, edhe pse militon për shkak të komandimit në Prokurorinë e Përgjithshme. Standardi kushtetues që u mbajt është që duhet të përfaqësojë prokurorinë përkatëse dhe jo atë të përgjithshme, një standard totalisht i ndryshëm nga ajo që aplikohet sot në rastin e zonjës që mban postin e Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm. E kuptoj që ndërgjegjja juridike në këtë rast, për ju është e tillë që në zbatimin e Kushtetutës dhe të ligjit do të duhet të mbani gjithmonë të njëjtin standard edhe si të institucioneve të tjera. Është kërkesë primare kushtetuese.

Të gjitha këto problematika janë ato të cilat sjellin një problem të madh lidhur me konstituimin e këtij organi. Problemi kryesor i të cilit është edhe një tjetër: nuk jeni në formacion të plotë. U shortuan prej Kuvendit tetë dhe jo vetëm kaq, por sot jeni shtatë. Ka një arsye të fortë se pse Kushtetuta, kur u konceptua, kërkonte një numër relativisht të madh, nëntë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Dhe jo vetëm kaq, por kërkonte një numër të lartë, gjenerimi i të cilit të vinte nga flukset e ndryshme të sistemit të drejtësisë: Gjykatë Kushtetuese, Gjykatë e Lartë, prokurori, apele dhe shkalla e parë administrative. Ka një sens Kushtetuta në këtë rast. Cila është? Fare e thjeshtë, që ky organizëm nëse do të krijohet, të mos bjerë në kontroll politik. Çështja e parë, pavarësia, frymëzimi kushtetues për KED ka qenë pikërisht kjo, të largonte influencat e papërshtatshme politike. Si? Me një organ paraprak, i lartë në numër që nuk mundëson kontrollin politik dhe jo vetëm, por që kishte mundësi të ofronte ndjesitë e të gjitha ekstremiteteve të sistemit gjyqësor dhe Gjykatës Kushtetuese. Ky është një problem vërtet i madh. Arsyeja se përse Kushtetuta imponon në mënyrë imperative që duhet të jetë formacion i plotë është përcaktuar edhe në ligj. Po pse kërkon zëvendësues? Pikërisht për këtë arsye, ndryshe thoshte s'ka nevojë për zëvendësues. Janë nëntë dalin e teprojnë, nëse ndonjëri bie rrugës dalin e teprojnë ata që ngelen. Jo, kërkon domosdomshëmrisht edhe zëvendësuesit që në momentin kur njëri bie rrugës për një ose një tjetër arsye, do duhet të futet zëvendësuesi. E dëgjova këtu arsyetimin që ligji nr. 115, në nenin e vet, çfarë neni ishte, 221, për kuorumin, nenin 229 pika 3, përcakton që Këshilli vendos me shumicën e votave në prani të të paktën pesë anëtarëve. Pra thirrja ime është në

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

ndërgjegjen tuaj si jurist për të kuptuar, sigurisht për ta lexuar këtë dispozitë që normalisht është në fuqi, për sa kohë që nuk kemi Gjykatë Kushtetuese, është në fuqi dhe nuk është sfiduar në Gjykatën Kushtetuese. Po sigurisht nuk u ndjeva mirë kur pashë në siklet ata të cilët besojnë se kjo është një dispozitë ekskluzive, e vetmja, e cila mundëson konstituimin e KED, të lexohet vetëm, e izoluar, jashtë logjikës që përmban ajo në vetvete dhe distante nga fryma e Kushtetutës, ajo që sapo thashë.

Po, detyra e çdo juristi besoj unë në pozicionet shumë të nderuara që keni pasur ju është që kur ka çështje të cilat eventualisht mund të përplasen, interpretimi të jetë ai pajtues, në kuptimin që të ruhet fryma e Kushtetutës, jo vetëm sepse është një ligj, por është dhe ligji më i lartë, e cila kërkon domosdoshmërisht formacion të plotë të KED. Me këtë ligj që duket sikur bie ndesh, pra sikur këshillon që edhe vetëm me pesë anëtarë, të mund të konstituohet Këshilli i Emërimeve në Drejtësi e mund të bëjë mbledhje. Në fakt, po të lexohet në sfond, ky ligj nuk bën gjë tjetër veçse bën të mundur mbledhjen, po vërtet, të Këshillit të Emërimeve kur ai të jetë konstituuar edhe me pesë anëtarë, por jo në mungesë të katër anëtarëve të tjerë. Katër anëtarët e tjerë do duhet të jenë të zgjedhur, do duhet të jenë të konstituuar dhe për shkak të konfliktit të interesit për çështjen konkrete s'mund të marrin pjesë në atë mbledhje konkrete, por jo të mos jenë zgjedhur. Sepse ky nen ka edhe një gjë të bukur, Këshilli vendos me shumicën e votave në prani të pesë anëtarëve. Domethënë me tre vota? Do të arrijë në ekstrem vendimmarrja e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi? Pra, gjithë lufta e madhe e reformës në drejtësi për ta shkëputur emërimin e Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, zemrën e sistemit, nga influenca politike, rrudhet dhe degradon vetëm tek tre anëtarë, të cilët mund të blihen për çfarëdo lloj arsye nga jashtë ose brenda, nga kushdo? E kuptoni që këtu ka rënë komplet logjika kushtetuese.

Këshilla ime është që ta interpretoni në mënyrën e duhur atë Kushtetutë. Vlerat e Kushtetutës janë ato kryesoret që do duhet interpretim eventual të mbartë me vete. Këto janë arsyet e para sepse, ju të shortuar, nuk mund të konstituoni, një Këshill Emërimesh në Drejtësi të vlefshëm në aspektin kushtetues e as nuk mund të prodhoni veprimtari të ligjshme. Nuk është faji juaj. Mos u ngarkoni me çështje që as nuk keni shkaktuar, as nuk jeni pyetur, as nuk jeni këshilluar se si mund të zgjidhen. Mos u ngarkoni me diçka që s'është e juaja e për të cilën nesër, pasnesër do të mund të merrni qortim publik, për shkak se interesi publik cenohet në këtë rast, duke sjellë një dëm të parikuperueshëm për kohëra relativisht të gjata, nëntë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Së dyti, ka probleme prej disa anëtarësh këtu të cilët nuk kanë mandatin për të qenë përfaqësues në frymën e ligjit si anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Përfaqësuesi i Gjykatës së Lartë pretendon që është i shortuar në mënyrë të ligjshme. Po që të jesh i shortuar në mënyrë të ligjshme, ai ligj që Avokati i Popullit sapo citoi, ka jo vetëm kushtin që duhet të kesh përfunduar, si kusht *sine qua non* „Shkollën e Magjistraturës, por mbi të gjitha do duhet të jesh gjyqtar i Gjykatës së Lartë. I nderuar ju nuk e mbani në mënyrë të vlefshme kushtetuesmerisht dhe ligjërish postin e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Jeni emëruar në vitin 2005, mandati juaj 9 vjeçar ekspironte në vitin 2014, për shkak të një ligji të miratuar i cili thoshte se dhe nëse ka përfunduar mandati mund të qëndrosh në detyrë derisa do vinte pasardhësi. Po, një fare kohe ky ligj ishte në fuqi, i cili u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese. Dhe e dini mirë se kur një ligj shfuqizohet nga Gjykata Kushtetuese, edhe efektet e tij janë të tilla që aplikohen menjëherë. Mandati juaj si anëtar i Gjykatës së Lartë ka përfunduar ditën që ka hyrë në fuqi vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Sigurisht për shkak të atij ligji ju keni thyer rekordin, nga viti 2005 deri sot, mbani, pa të drejtë në këto momente, postin e anëtarit të Gjykatës së Lartë dhe bashkë me to, edhe si i shortuar në Gjykatën e Lartë. E jo vetëm kaq, por çdo pretendim se në momentin kur vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar ligjin e bashkë me të, edhe të drejtën tuaj për të okupuar një nga karriget e Gjykatës së Lartës ka hyrë në fuqi, ishte futur në fuqi Kushtetuta e re që parashikon të njëjtin rregull, nuk ju jep të drejtën që ta mbani postin derisa të vijë pasardhësi juaj. Për një arsye fare të thjeshtë. Ndryshimet kushtetuese dhe dispozitat transitorë përcakton fare qartë që mandati anëtarit të Gjykatës së Lartës do jete ai sipas Kushtetutës së mëparshme. Ke fituar një mandat 9 vjeçar, atë do mbash. Ata që do fitojnë një mandate si anëtar i Gjykatës së Lartës me regjimin e ri kushtetues, po, kur të ekspirojë eventualisht 9 vjeçari i tyre qëndrojnë në detyrë derisa të vijë pasardhësi. Nuk është rasti juaj. Nuk plotëson kushtin e Shkollës së Magjistraturës, nuk e mban me mënyrë kushtetuese të vlefshme ligjore postin e anëtarit të Gjykatës së Lartës. S’ke si të jesh anëtar i KED-se.

Së treti, nga letrat që keni ofruar paraprakisht po dhe nga media që jeni konsultuar, i nderuar ke kandiduar për Gjykatën Kushtetuese. E drejta e juaj, absolutisht e drejta juaj. Madje ke kandiduar në vakancën e parë për Gjykatën Kushtetuese nga Gjykata e Lartës, e para. Jo vetëm fryma kushtetuese, jo vetëm ligji 115/2016, por ligji i konfliktit të interesit, të urdhëron të zgjidhesh konfliktin permanent të interesit që ke. Nuk mund të jesh kryesuesi ynë, po as anëtar i KED-se, ndërkohe që kandidon për Gjykatën Kushtetuese. Çdo kush, edhe ata të cilët s’kanë kurrfarë shkolle juridike sa e marrin vesh këtë fakt do thotë ku emërovet dhe ato që marrin pak vesh nga e drejta thonë që po emëron veten po e po, por bën edhe rregullat sipas shijes dhe sipas profilit dhe çudi shoh, meqë ra fjala, këtu shoh që paska edhe veprimtari jashtë këshillit, formulimit të vendimit përkatës për rregulloren. Më duket e

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

çuditshme sepse ky është momenti i parë që mendoni të konstituoni e si i keni bërë rregullar paraprakisht? Kjo është çështje tjetër, pra jeni në konflikt interesi të vazhdueshëm, permanent. Ligji, neni 37 për konfliktin e interes, kur ai është permanent, siç është rastin tuaj, kërkon ta zgjidhni atë, në instancë të parë ju vetë, është e drejta juaj. Së pari ta deklaroni. Është detyrimi minimal për ta deklaruar. Së dyti do duhet brenda një afati të caktuar kohor ta zgjidhni ju dhe së treti, ka mekanizëm i cili do duhet të marrë përgjegjësinë për ta zgjidhur këtë konflikt interesi.

Nuk jeni vetëm ju që keni këtë lloj defekti. Në mandatin si i shortuar në KED, Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm nuk duhet të jetë këtu. Së pari, për arsyen që unë sapo thashë, e komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme, me emërim definitive në Prokurorinë Shkalles së Parë Shkodër, pra një nga nivelet e prokurorisë që nuk ka përfaqësim në KED. Përkohshmëria në një institucion nuk të jep përhershmerinë për tu zgjedhur në atë pozicion, siç është KED. Pretendimi është të vazhdoni në mënyre të përhershme, për një vit pra. Edhe jo vetëm kaq. Ka një arsye tjetër, tashmë është ngritur KLP. Detyrimi ligjor sipas ligjit të prokurorisë është që nga momenti që është ngritur, edhe mandat i përkohshëm i Prokurorit të Përgjithshëm ka expiruar dhe ligjërisht ai post është vakant dhe ka një njeri atje që mundet edhe të paraqitet këtu.

Zonja Tusha, edhe mandati juaj ka një defekt. Juve jeni, ishit anëtare e Gjykatës Kushtetuese po qëndroni në detyrë për shkak të një detyrimi kushtetues, që ju bën nder, megjithëse personalisht e shoh të paarsyeshëm sepse qëndrimi në detyrë, derisa të vij pasardhësi, ka sens në aspektin kushtetues për të mos e lënë Gjykatën Kushtetuese jofunksionale. Në fakt jeni tek, e vetmja, të tjerët janë shkarkuar ose nuk paraqiten më në detyrë. Por formalisht ju bën nder fakti që qëndroni në detyrë. Por sigurisht që çdo kush në ndërgjegjen vetë duhet të shoh a e përfaqësoj unë dot Gjykatën Kushtetuese? Ju s'keni asnjë lloj detyrimi për të qenë këtu. Është e drejta e juaj doni të vini, shume mire, s'doni të vini, shumë mirë keni të drejtën tuaj. Dhe në fakt elementi që ligji përcakton që pjesëmarrja është e detyrueshme për shkak se edhe kjo përbën një nga shkaqet për sanksionim ligjor, në rastin tuaj nuk aplikohet dot. Për të tjerët edhe, por në rastin tuaj jo. Ky është elementi që ju mban ju dhe gjithsecilit. Shkeljet eventuale në procesin e formimit të KED janë të tilla që mund të përbëjnë bazë për procedim disiplinor. Për rastin e zonjës Tusha nuk është. Ngelet thjesht në ndërgjegjen e individit.

Unë nuk marr përsipër t'ju them, a duhet a po s'duhet që magjistratët që nuk e kanë kaluar ende procesin e vetting-ut duhet ta kalojnë atë e të fillojnë punën apo jo. Por duhet thënë një gjë tjetër. Gjithsecili prej jush, por ndoshta edhe të ftuarave, zonjave të EURALIUS

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

dhe OPDAT, do të duhet tu bëjë përshtypje ore pse s'ka funksionuar të paktën dy herë me radhë KED? Fakt publik është që ajo çfarë është thënë edhe nga përfaqësuesi politik, kolegu im që iku për shkak të punës, vjet në procesverbalin e mbledhjes së KED 2018 është thënë me gojën plot si këshille miqësore nga Kuvendi i Republikës që pa kaluar vetting-u s'mund të filloni punë. Këshill ka qenë, duhet të marrë përgjigje. Ose ndryshe kryetari i vjetshëm i KED- së nuk ka kryer detyrën e tij Duhet të qartësohet edhe kjo çështje se s'mund të jemi në një republikë ku brenda dy viteve akti më i lartë të aplikohet në mënyra totalisht të ndryshme, një herë mblidhte një herë s'mblidhet, një herë vetting-u duhet të kalohet, herën tjetër vetting-u s'duhet të kalohet. Është çështje që kanë lidhje këto edhe me konsitutumimin tuaj. E në lidhje me vetting-un, ai që është synimi që ishte synimi hyjnor i reformës kushtetuese për të ngrit KED jashtë influencës politike, që të garantonte objektivitet në vendimmarrje dhe në për zgjedhje eventualisht, cenohet sot në mënyre brutale nga fakti që magistratët e nderuar Buhali, Roshi, Brahimllari, Veizi, Islamaj, të cilët nuk e kanë kaluar ende procesin e vetting-ut, janë aktualisht nën presionin politik të vetting-ut. O do të pësojnë fatin e Bashkim Dedjes, nuk ia uroj asnjërit, sepse asnjëri nuk e meriton, ose do jenë në një presion permanent që vota dhe pjesëmarrja e tyre të jetë në mënyre të tillë e orientuar politikisht. Dijeni se po flas sinqerisht por dikush duhet ti thotë këto gjëra.

Në vitin e trete të miratimit të reformës kushtetuese, tam-tamet e mëdhaja nga çdo anë, për një reforme të re kushtetuese, për një drejtësi të re, e ku jemi? Jemi në një situatë akoma më të keqe se para 2016. Këto janë çështje që thashë që në fillim që ndërjegja juaj profesionale individuale është ajo e cila duhet ti ketë parasysh, duke parë, jo çfarë, jo vetëm çfarë shkeljes kanë ndodhur më parë e padrejtësisht ju ngarkohen juve. Por edhe se çfarë udhëkryqi ky sistem ligjor, i mangët, po u detyron të ndërmerrni. Dhe ka zgjidhje, dhe ka zgjidhje, se jo me kot janë përfaqësuesit e Kuvendit, një mazhorance dhe një opozite, për të kuptuar dhe për të ndjerë që sistemi është një sistemi në impas të plotë e për të ndërmarrë zgjidhjen e vetme që është, ndryshimet ligjore. Aq më tepër që jeni përfaqësues të nderuar të OPDAT dhe EURALIUS, ndryshimet ligjore të cilat, së paku, për Gjykatën Kushtetuese janë inekzistente. KED, siç është konceptuar në Kushtetute, edhe në ligj, është menduar që të veprojë në atë mënyre si mekanizmi që do të ripërtërije herë pas herë Gjykatën Kushtetuese apo edhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Por kurrë nuk e ka menduar që do ta ngrejë nga e para dhe jemi në situatën e ngritjes nga para të Gjykatës Kushtetuese, kur ato organe të cilat duhet ta ngrenë janë inekzistente. Zgjidhja e vetme është kjo, zgjidhje ligjore, që e bën Kuvendi.

Fatkeqësisht nuk do t'ju jap këshillë se si ta orientoni votën tuaj është gjithçka në dorën tuaj. Kisha detyrimin, së pari personal, të them të gjitha ndjesitë, perceptimin që personalisht kam, por edhe të fluksit politik parlamentar që unë përfaqësoj. E mira e punës e do që në këto diskutime kaq të rëndësishme të formimit të këtyre institucioneve dikush do duhet të jetë i sqartë dhe të jetë pa doreza. Dhe ne mendojmë kështu dhe sigurisht jo vetëm mendojmë kështu, por nuk do të lejojmë asnjëherë, që sot, në 2019, me këtë lloj mënyre se si është duke u operuar, sistemi i drejtësisë të bjerë në darën e fortë politike të njërit krah politik të pushtetit. Jo miq të nderuar. Ky është vendi ku jetoni ju, është vendi ku jetojmë ne e do të jetojmë me shpresë gjithmonë. Nuk mund t'ia bëjmë vetes këtë gjë këtë. Nuk mund t'ia bëjmë vetes këtë dhuratë të hidhur, eksperiment. Gjithsekush nga ne brenda vetes e ndjen Ç'është bërë deri tani dhe po përgatitet të bëhet. Është e pa drejte, edhe përfitimet momentale, që mund të ketë ndokush, për ndonjë pozicion, Gjykatë Kushtetuese, Gjykatë e Lartë, KLGJ, KLP apo Prokuror i Përgjithshëm, nuk justifikojnë dëmin e madh historik që i bëjmë vendit. Një nga hallkat më të rëndësishme të cilat mund t'ia shkaktojnë është pikërisht veprimtaria e KED-së eventuale, që unë me ç'kuptova konstituohet nga juve të shortuar. Është thirrje shumë njerëzore, nuk kam për momentin asnjë mjet për ta sfiduar se do ta kisha shumë të thjeshtë për ta sfiduar veprimtarinë tuaj në çfarë do lloj institucioni. Qasje që unë besoj do mbante kushdo si njeri mbi të gjitha, si profesionist së dyti, si njeri që do jetojë në këtë vend është ta shihni duke dhënë shembullin që nuk është dhënë asnjëherë deri tani, ta shihni si një moment të artë për të shpëtuar reformën, pse jo, për ti dhënë edhe një ndryshim të madh këtij vendi. Shembull i vogël, por që mund të jetë model edhe për të tjerët. Kushtetuta zbatohet, ligji zbatohet, e drejta zbatohet, jashtë çdo lloj konflikti interesi, mos bini pre, të mos renit pre e influencës politike dhe mbi të gjitha, të mos jeni të frikësuar nga pushteti që mund t'ju bëjë diçka. Për shkak të mundësisë të përkohshme që këto mund t'ju bëjnë dëm, mos e pranoni këtë.

Këto ishin ato çfarë doja të thoja i nderuar që në fillim të mbledhjes dhe sigurisht doja ti thoja tani se nuk ka moment tjetër për ti thënë. Faleminderit për mundësinë, faleminderit për kohën, edhe për durimin apo edhe për bezdisjen që mund t'ju kem shkaktuar.

Ardian Dvorani - Jo në fakt ju falënderoj zoti Alibeaj që ju vlerësuat ti parashtroni në mënyrë të hollësishme dhe në të gjitha dimensionet mendimet dhe qëndrimet tuaja. Personalisht për mua nuk ka asnjë bezdi, përkundrazi, unë preferoj që të dëgjoj sa më shumë argumente, pavarësisht se nuk pajtohem, por kjo nuk ka rëndësi. Ka rëndësi që të respektojmë mendimet e njëri-tjetrit.

Atëherë, për të vijuar diskutimin, nuk e di tani është pjesa e debatit, diskutimit të hapur, nuk është se ka radhë. Gjithsecili mund ta vlerësojë vetë të marrë fjalën, për të bërë ndonjë *feedback* përpara se të konkludojmë.

Unë personalisht kam mbajtur shënim qëndrimet dhe mendimet e kolegëve. Po përpiqem të jap interpretimin tim për Kushtetutën dhe Ligjin për disa momente që unë vlerësoj se ishim më të rëndësishme dhe që kane të bëjnë me konstituimin e KED.

Së pari, pse nuk ka funksionuar KED në 2018? Unë nuk di ta them por kam lexuar procesverbalin, të gjithë procesverbalin e mbledhjes sepse ka qenë i integruar dhe unë kam kuptuar që ia Këshill, në atë mbledhje ka vendosur të funksionojë. Pse nuk ka funksionuar? Nuk kam asnjë dokument të shkruar përse nuk ka proceduar më tutje me veprimtarinë e tij. Unë dëgjova edhe opinione këtu që ka qenë arsyeja vetting-ut, por unë nuk e kam gjetur të dokumentuar dhe nuk mund të prezumoj asnjë motiv.

Së dyti, lidhur me faktin që është KED-i përkohshëm apo jo. Zonja Buhali e lidhi me vetting-un. Unë mendoj se nuk ka të bëjë me faktin që të gjithë anëtarët kanë kaluar ose jo vetting-un, por lidhet me një problem tjetër, pra që kishte të bënte me lindjen e KED të përkohshëm për sa kohë nuk ishin ngritur institucionet e reja të riformatuara të sistemit të drejtësisë, pra që ishin KLGJ dhe KLP, e prandaj quhej i përkohshëm. Unë mendoj që titullimi “i përkohshëm” ende mbetet edhe për këtë Këshill, për sa kohë që në momentin që ai u shortua, ende këto organe kushtetuese nuk ishin ngritur. Kjo është pikëpamja ime.

Së treti, lidhur me një nga kriteret për të qenë anëtar i KED, që e parashikon ligji dhe që është të ketë mbaruar shkollën e magistraturës. Sinqerisht unë nuk e kuptoj, nëse nuk ka qenë ndonjë gabim a një gjë në procesin e draftimit të atij ligji dhe asaj dispozite. Unë për veten time nuk e kuptoj kështu. Për shkak se qenia anëtar i KED-se nuk është promovim. Pra, nëse do të bëhej fjale për promovim në karrierën gjyqësore unë do ta kuptojë që për të pasur këtë detyrë duhet të kesh titullin profesor në shkencat juridike. Mund ta kuptoj këtë gjë sepse është promovim dhe ligjvënësi çmon që për tu promovuar duhet të ketë cilësi më të larta. Ndërsa rastin e KED unë nuk e shoh si mekanizëm promovimi, por si një detyrë për gjyqtarët, në ato pozicione ku ata janë, në momentin kur duhet të shortohen apo duhet të përzgjidhen për shortim. Dhe së dyti, unë personalisht shoh një, nuk e di do ta quaja edhe diskriminim. Nuk arrij të kuptoj se përse një gjyqtar që ka mbaruar Shkollën e Magistraturës mund të jetë anëtar i KED dhe një gjyqtar tjetër nuk mund të jetë, e ka të ndaluar. Si mundet të ekzistojë një kriter i tillë? Mua me duket që ajo shprehje aty, nuk duhet të ketë këtë kuptim. Nuk e di c ‘kanë pasur në mendje hartuesit kur e kanë formuluar normën, por, në thelb, nuk besoj se ka qene, nuk mund të jetë një motiv, pra të kesh studiuar për drejtësi dhe

pastaj të kesh mbaruar Shkollën e Magjistraturës e kështu me radhë. Kështu që unë e interpretoj në një mënyrë tjetër, e shikoj si një nga dy situatat kur ligji thotë, nuk e kam përpara tani, pra se si gjyqtarët janë emëruar, një pjesë janë emëruar pas Shkollës së Magjistraturës, të tjerët pa e mbaruar Shkollën e Magjistraturës. Ndryshe nuk e di, unë nuk e kam këtë forcë por praktikisht pastaj do ta quaja të papajtueshme me Kushtetutën si kriter. Si mund të përjashtohen gjysma e gjyqtarëve të sistemit sepse s'kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës. Atëherë përse janë gjyqtarë në të njëjtat nivele me ta. Ne jse s'dua të zgjatem më dhe ky është argumenti im shumë i përmbledhur në lidhje me këtë pikë.

Po ndalem edhe tek pozicioni im në këtë Këshill. Për motivin që nuk kam mbaruar Shkollën e Magjistraturës nuk shprehem më tej, sepse se nuk ka lidhje vetëm me mua personalisht, por me të gjithë kolegët, edhe ata që nuk janë të shortuar. E dyta, për faktin që jam apo jo gjyqtar i Gjykatës së Lartë, sigurisht që unë e kam menduar këtë gjë dhe interpretimi im është që unë jam gjyqtar i Gjykatës së Lartë. Sigurisht që duhet të zëvendësohem sa më parë të jetë e mundur sepse ka kaluar një kohë e gjatë që jam në këtë detyrë. Ligji që ka qenë në fuqi nuk ishte hartuar për mua personalisht. As vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ishte për mua personalisht. Pra aty diskutohej kushtetutshmëria e një norme ligjore. Dhe në interpretimin tim, për shkak të ndryshimeve të Kushtetutës, mandati im vazhdon edhe sot e kësaj dite sepse kështu parashikohet në Kushtetutë. Është e kotë të ndalem gjatë këtu edhe për të folur se kur fillojnë efektet juridike të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Por ai vendim kishte të bënte me kushtetueshmerinë e një norme dhe i njohim efektet e një vendimi të tillë se kur fillojnë dhe kur shterojnë në kohë. Pastaj është norma kalimtare e dispozitave të reja kushtetuese që më kërkon të qëndroj në detyrë. Pra, sigurisht që një gjyqtar, edhe përpara mbarimit të mandatit 9 vjeçar në Gjykatën e Lartë mund të largohet kur ai e mendon nga detyra, për çfarëdo lloj arsye. Por, kur kandidon dhe pranon të jesh gjyqtar, qoftë edhe në Gjykatën e Lartë, kjo është një detyrë, nuk është një luks, është detyrë që duhet ta përmbushësh derisa të zëvendësohesh, këtë thotë Kushtetuta dhe ligji. Ky është qëllimi mendoj unë dhe ky është interpretimi që unë i kam bërë. Mundet të jetë i gabuar, por është qëndrimi im, prandaj gjykova ta ndaj edhe me ju.

Për sa i përket faktit të kandidimit për në Gjykatën Kushtetuese sjell ne vëmendje që ka ndodhur kandidimi dy vjet më parë dhe në atë moment nuk pata menduar dhe as nuk isha i përzgjedhur në KED-në e asaj kohe si edhe as nuk e pata menduar se do kalonin dy vjet dhe ende kandidaturat nuk do të ishin shqyrtuar, të parashikoja që Gjykata e Lartë, nga 16-17 gjyqtarë në detyrë, do të përfundonte me 3-4 gjyqtarë. Pra janë të gjitha rrethanat që kanë ndodhur më parë. Pritshmëria e një juristi të zakonshëm apo edhe ekspert nuk mund ta

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

mendonte se mund te ndodhej në këtë situatë. Unë jam anëtar i KED për shkak se është një detyrë. Kandidimi im është një e drejtë. Unë e kam vlerësuar dhe jam duke e vlerësuar këtë moment me shumë seriozitet. Unë vlerësoj se për momentin nuk e kam konfliktin e interesit, konflikti i interesit nuk është permanent. Sikurse mund ta trajtoj, në pikën tjetër të rendit të ditës, unë jam një nga anëtarët e zgjidhur apo të shortuar siç thuhet, por nuk kam asnjë të drejtë vote me shumë, s'kam asnjë autoritet më shumë se cilido anëtar i Këshillit. Por, nëse do të kalojmë tek pika e dytë dhe do të vijë momenti për të diskutuar punën për hartimin e rregullave të shortimit, vlerësimit, të pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve, sigurisht është një akt nënligjor në të cilin unë nuk duhet të marr pjesë, as në hartimin dhe as në diskutimin dhe votimin e tij nga Këshilli, sepse ai është menduar unë akti që mund të jem vërtet në konfliktin të interesit. Sa i përket akteve të tjera, përfshirë dhe atë të verifikimit të kandidaturave, kjo për momentin mua nuk më sjell në konfliktin e interesit sepse unë, nëse ka mendim tjetër mund të ma thoni, duke e kaluar procesin e vetting-ut, praktikisht më ngelet që nga Këshilli ndoshta të bëhet vetëm vlerësimi i kandidaturave. Kjo nëse do të jetë momenti për të hyrë në vlerësimin e të tre kandidaturave, e që jemi tre kolegë të kandiduar në atë pozicionin vakant. Por që ka edhe një rrethanë tjetër që Gjykata e Lartë praktikisht nuk është në gjendje as që të marrë në shqyrtim dhe as të votojë kandidaturat, për shkak se ligji kërkon një mbledhje të vlefshme me tre të katërtat e anëtarëve të Gjykatës së Lartë, të cilët nuk janë, numri aktual me ligj është 19. Nuk e di çdo të vendoset nga KLGJ për të ardhmen por ky numër nuk është.

Këto janë mendimet e mia. Tani gjithsecili unë mendoj është i lirë të marrë fjalën dhe të shprehët. Unë këto pika evidentova si kryesoret por mund të ketë edhe të tjera. Atëherë kush e do fjalën?

Margarita Buhali – Kryetar, pa diskutim ishte shumë me vend ndërhyrja juaj. Por doja të sqaroja pse e mendoj, aq më tepër unë, që jam një nga anëtarët që ende nuk e kam kaluar vetting-un, pse dua që vota ime të jetë me peshë në të gjitha dimensionet e saj dhe mendoj se kjo peshë i rritet kur unë do ta kaloj këtë proces. Jo se në gjendjen që unë jam nuk arrij të vlerësoj vetëm time. Unë e njoh shumë mirë vetëm time se kush jam dhe sa e përgjegjshme jam për punën që bëj, por dua që dhe ata që kandidojnë për anëtarë të një nga institucionet me të lartë siç është Gjykata Kushtetuese, ta njohin dhe ta dinë qoftë edhe nga institucionet e tjera që unë meritoj ti votoj dhe ti për zgjedh për këtë pozicion.

Duke marrë shkak nga fakti që ne vazhdojmë të jemi dhe konsiderohemi Këshilli i Përkohshëm i Emërimeve, për shkak të procedurës se si ne u zgjedhëm përpara se sa të konstituoheshin dy organe tashmë shumë të rëndësishme siç janë KED dhe KLGJ, unë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

vlerësoj se pikërisht, për këtë mënyrë zgjedhje, ligji ka dashur të na japë një impuls të shtuar garancitë që është pikërisht parashikimi i nenit 284, ku thuhet se anëtarët e KED i nënshtrohen rivlerësimit me përparësi. Këtë e shikoj në raport edhe me parashikimin e nenit 179, tek dispozitat kalimtare kushtetuese, ku përsëri në pikën 11 thuhet që anëtarët e KED i nënshtrohen menjëherë procesit të rivlerësimit kalimtar të kualifikimit për gjyqtarë dhe prokurorë sipas nenit 179 /b të këtij ligji. Të gjitha organet dhe institucion që u zgjodhën, po marr KLGJ-në, e kaluan procesin e rivlerësimit ata kandidatë që ishin pjesë e këtij kandidimi, pikërisht duke u bazuar në dispozitat kalimtare sepse po të shikosh pjesën e zgjedhjes së anëtarëve tek neni 7 dhe kushtet, nuk është kusht të kalosh procesin e rivlerësimit sepse behet fjale për një situatë normale të kushteve kur zgjidhen anëtarët. Pra, pasi janë kaluar këto pjesët kalimtare, dispozitat ,mënyrat e përzgjedhjeve, pra kur ligji ka filluar të funksionojë dhe organet kanë filluar të mirëfunksionojnë e në bashkërendim të gjitha.

Prandaj unë mendoj që në këtë rast, duke qenë se ne kemi të njëjtin status dhe Kushtetuta vetë e parashikon se anëtarët e KED i nënshtrohen menjëherë procesit të rivlerësimit, po edhe neni 284 arsye për të cilin ne jemi këtu dhe pse gëzojmë statusin e anëtarëve të Këshillit të përkohshëm, nuk mendoj se këto dispozita janë vënë pa qëllim. Unë besoj se sot komisionet e kualifikimit i kanë të gjitha mundësitë ti japin jetë kësaj KED-je. Një pjesë, katër nga anëtarët e kanë kaluar dhe besoj se edhe një pjesë tjetër, pra dërrmuese, si psh për shkak të statusit si kryetar, e kanë filluar, kështu që mund të procedohet me një procedurë më të përshpejtuar që ne, edhe përballë kolegëve tanë, ta ndjejmë veten dhe të jemi të legjitimuar për ti kontrolluar ata si të denjë, sepse unë do të thoja se secili nga kolegët këtu i njoh dhe i vlerësoj si të tillë, por dua që edhe kandidati të më vlerësojë si të tillë. Faleminderit .

Ardian Dvorani – Faleminderit zonja Buhali. Po, zonja Marku.

Arta Marku – Faleminderit kryetar. Unë në vazhdim të asaj që foli zoti Alibeaj, kërkoj të sqaroj pozicionin tim si e shortuar, për të vazhduar me atë terminologji, në këtë Këshill. Jam në detyrë me një vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili nuk është atakuar në Gjykatën Kushtetuese dhe që asaj kohë ka qenë funksionale. Kështu që, pavarësisht mendimit të kujtdo, unë ushtroj funksionin e Prokurorit të Përgjithshëm deri në përzgjedhjen dhe emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm me mandat. I plotësoj të gjitha kriteret për të qenë anëtare e KED, për më tepër, nëse nuk jeni në dijeni, i kam dërguar Presidentit, Kuvendit, edhe listën me emrat e të gjithë prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorëve të apeleve. Ka qenë Kuvendi që ka bërë përzgjedhjet dhe ja ku

jemi. Kështu që jam e detyruar të marr pjesë këtu dhe kam ndërgjegjen e një zyrtari për të marrë pjesë aty ku kam detyrimin. Faleminderit

Ardian Dvorani - Faleminderit zonja Marku. Nga kolegët ose të ftuarit, kemi ndonjë mendim tjetër? Pyetje?

(Ndërhyhet pa mikrofon)

Jo, sepse është ende i hapur diskutimi. Po, zoti Islamaj.

Fatri Islamaj - Ndoshta e diskutoj në formën e pyetjes a të një paqartësie. Nuk e kam të qartë ndoshta për sa i përket bazës ligjore ku ne e mbështesim pikën e parë të rendit të ditës. Pasi në aspektin e përgjithshëm të konceptimit të konsistutimi, ashtu siç e thashë dhe po e përsëris, unë mendoj se çështjen e konstituimit e kanë zgjidhur në parlament dhe kam përshtypjen që qoftë ligji për organet e qeverisjes në drejtësi, si edhe Kushtetuta, mos qofsha i gabuar, nuk parashikon ndonjë procedurë që ne duhet të mblidhemi, pavarësisht faktit që është mbledhja e parë, e të verifikojmë mandatin e njëri-tjetrit, të verifikojmë kushtet e vlefshmërisë së mandatit tonë. Në këtë aspekt unë mendoj se është në ndërgjegjen personale të secilit prej nesh, nëse jemi në kushtet e respektimit të ligjit ose ligjeve, në zbatim të Kushtetutës dhe të dispozitave që parashikon Kushtetuta lidhur me kriteret e anëtarëve të KED. Prandaj them që jemi para përgjegjësisë profesionale dhe personale që ne duhet dhe kemi, që duhet të karakterizojë secilin prej nesh dhe e kemi dhe detyrë. Pse duhet të marrim përgjegjësinë e ripërsëritjes të një vullneti që nuk ka qenë vullneti jonë, por vullneti i një organi tjetër, i cili, në zbatim të parashikimeve ligjore, është rasti i Kuvendit të Shqipërisë, i cili ka bërë procedurën e shortimit dhe përzgjedhjes së emrave. Duke pasur parasysh edhe faktin që e them këtë gjë se ne nuk është se kemi një dosje personale të secilit, nuk mendoj që është kompetencë e jona. Nuk është në misionin tonë të vlerësojmë kushtet dhe kriteret e secilit prej anëtarëve të KED, pasi nuk e kemi as bazën informative për ta bërë dhe as kompetencën.

Ardian Dvorani - Unë në fakt po reagoj për këtë moment, Unë në fakt në fjalën time, ashtu siç e kisha menduar unë, thashë që ky është momenti që e përmbyll procesin, janë parapërgatitur listat, është bërë shortimi nga Kuvendi. Dhe meqenëse është mbledhje e parë, mbledhja e parë e përmbyll gjithë procesin në tërësi të konstituimit të një organi kushtetues dhe unë jam dakord me ju se ne nuk kemi asnjë kompetencë, edhe asnjë mundësi apo mënyrë për të verifikuar vlefshmërinë e mandatit të secilit prej nesh. Prandaj edhe pajtohem me argumentet që ju thatë. Por, gjithsesi, është një diskutim që mendoj se na bën shumë mirë dhe unë e vlerësoj shumë fjalën e gjithsecilit, pavarësisht se si është. Është mirë të diskutojmë me njëri-tjetrin, të kuptojmë se ku jemi ulur dhe nëse konsiderohet çfarë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

përgjegjësie e jashtëzakonshme na pret për ta ushtruar, ashtu siç tha zoti Alibeaj, në interes të publikut.

Dikush tjetër? Mund të diskutojë?

Klodiana Veizi (Mema) - Pikërisht tek çështja që shtrojmë unë mendoj se jam anëtare zëvendësuese dhe përderisa marr pjesë në mbledhje, ashtu siç e shtroi pyetjen zoti Fatri, ku është e parashikuar që të funksionojë ky Këshill ne duhet të konsistojmë veten tonë. Mendoj se e gjithë kjo procedurë mbaron aty ku Kuvendi hedh shortin, zgjedh anëtarët, institucionet me përgjegjshmërinë e tyre që e kanë vetë ato në ngarkim në bazë të ligjeve dhe Kushtetutës, kanë përcjellë listat, janë shortuar, shorti ka qenë publik, secili nga anëtarët aty, ku di unë, ka mazhorancë e opozitë, kanë qenë të pranishëm. Pastaj, kundërshtimet e procedurave apo përzgjedhjeve nuk di nëse është ky vendi që ti mbartim ne dhe të vlerësojmë çfarë ka ndodhur dhe pastaj të themi po jo se ne nuk jemi krijuar siç duhet, ne duhet të bëjmë kështu apo ashtu.

Pra, ne jemi produkt i një procedure. Mbase nëse do kishte një Gjykatë Kushtetuese, opozita mund të shkonte atje ose pozita, ose dikush tjetër, nga forcat politike që nuk kanë miratuar. Pa dashur që ti japim një ngjyrim tjetër kësaj mbledhje, ideja është që ku është e përcaktuar që unë si anëtare apo secili nga ne, duhet të ngremë dorën dhe të themi që po, ne duhet të konstituohemi. Mbase thjesht vazhdueshmëria apo mbledhja apo vijimi i punës tregon atë që ne jemi krijuar dhe anëtarët që janë shortuar sepse janë ata kryesorët, meqenëse ne jemi zëvendësues, duhet të përmbushin detyrimet kushtetuese. Për mua gjithmonë mbetet ai ngërçi që duhet të kishim kaluar vetting-un apo jo. Nga vetë dispozitat që lexoi aty Margarita që thotë se duhet nënshtrohemi me përparësi vetting-ut, i mbetet KPK-së, e cila ka marrë emrat e anëtarëve të KED-se, që të fillojnë me përparësi punën dhe ti nënshtrohemi vetting-ut, kur ndërkohë, edhe puna duhet të vazhdojë sipas mendimit tim. Prandaj në lidhje me konstituimin, sepse edhe ne, apo anëtarët që do të votojnë, se nuk e di kush e ka të drejtën e votës, do të ishin përpara përgjegjësishë të vendosin që po, kam një akt, që jemi në një mbledhje ku anëtarët e zgjedhur në Kuvend duhet të konstituohen dhe vijojnë punën. Jo, unë u zgjedha sepse ra shorti dhe kjo është detyra. Nëse ke arsye të tjera pastaj... por unë kështu e mendoj.

Ardian Dvorani - Faleminderit. Tjetër? Po, zonja Tusha.

Vitore Tusha - Lidhur me çështjen e ngritur për problemin e vetting-ut, jo pa qëllim, as nuk e harrova, por nuk u shpreha fare në bisedimin tim të parë. Jo vetëm sepse nuk ka qenë dhe nuk është kriter i ligjit, të zgjedhurit, të përzgjedhur apo secili që është paraqitur për të qenë në short, por e kemi trajtuar edhe në mbledhjen e parë të vitit që kaloi, kur unë kam

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

qenë anëtare zëvendësuese. Në mbledhjen e parë, e zhvilluar më 19 mars, kjo çështje ndonëse është ngritur dhe është prezantuar nga përfaqësuesi i një force politike, s'ka rëndësi se kujtoj kush, por me poste politike, si çështje e rëndësishme, nuk është marrë, vlerësuar nga asnjëri nga anëtarët e KED-së së mëparshme si çështje që mund të bllokonte, stoponte, pezullonte këtë procedure.

Prandaj mendoj, e kam shprehur edhe zyrtarisht sepse më është kërkuar një opinion në vitin e shkuar nga komisioni i monitorimi që është ngritur në Kuvend dhe ato po përsëris: pas mbledhjes së parë që ka zhvilluar KED, është kaluar tek çështja e akteve të detyrueshme, rregullave që duhet të bëhen në mënyrë të detyrueshme si kërkesë e ligjit dhe është ngritur edhe një grup pune i cili do të funksiononte dhe të bënte parapërgatitjen e rregulloreve për t'ia paraqitur Këshillit. Më pas është vendosur, po në këtë mbledhje, që grupi i punës do të konsultohet me organet e huaja që monitorojnë reformën në drejtësi. Në këtë kuptim është bërë një draft i parë nga ish kryetari, zoti Broci, dhe grupi që është ngritur dhe e ka vazhduar këtë punë në këtë proces, i cili nuk u finalizua, pasi KED –ja nuk u mbledh më. Çështjet pastaj, në drejtim të interpretimi, të ngritjes, të pasjes kuorum apo mospasjes kuorum, ishin çështje që mund të ishin diskutuar nëse mbledhja do ishte thirrur. Mbledhja nuk u thirr më. Kryetari, në muajin korrik në mos gaboj, kishte procedurën e vetting-ut, një procedurë nga e cila nuk u konfirmua. Këtë çështje unë e bëra prezent më tepër meqë Margarita e tha dhe po e shpreh më shumë si një pengesë a përgjegjësi morale tek argumenti që ngriti. Qëndrimin për përgjegjësinë morale mund ta vlerësoje gjithsecili, por përgjegjësia ligjore është e para, kriteri për të respektuar organin që na ka shortuar. Faleminderit .

Ardian Dvorani - Faleminderit zonja Tusha. Në fakt zoti Alibeaj, ju e përmendet, projektaktet që ju shikoni bashkëlidhur, duhet ti keni përpara, nuk janë akte të hartuar nga ne. Thjesht i kemi marre dhe i kemi vënë në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve punën që është bërë nga Këshilli i vitit 2018 dhe deri në këtë moment që po flasim, ku edhe zonja Tusha ka qenë pjesë. Procesi i hartimit të tyre nuk është ndonjë punë e bërë nga ne, por është thjesht....

Enkelejd Alibeaj - I dilni për zot juve këtyre?

Ardian Dvorani - Jo jo, ato janë dokumente pune, nuk është se i kemi klandestine këtu. Janë dokumentacioni i punës dhe bashkëpunimit të mëparshëm në KED. Më kuptoni në këtë pikë. Nuk është se kam ndonjë qëndrim të veçantë për to.

Enkelejd Alibeaj - Mund ta marr fjalën, meqenëse mu drejtove? Faleminderit.

Unë kam qene pjesëmarrës në mbledhjen e parë dhe të vetme të vitit të kaluar të KED-s. Nji dhe e vetme, pa asnjë lloj mbledhje tjetër. Dhe me sa kujtoj dhe nuk kujtoj pak,

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

akti i vetëm do të ishte një rregullore për funksionimin e KED-së dhe jo për vlerësimin e kriterëve, që është akti më i rëndësishëm që përcakton se kush do jetë fitues e kush jo, që ta dini ju këtë punë. Unë nuk e di kush i ka dalë për zot, OPDAT, EURALIUS apo ndonjëri nga ata që kanë qenë apo janë. Por nëse fillohet veprimtari që axhendën dhe produktin këtij organi ia cakton dikush tjetër jashtë kësaj sale, kjo më duket që është me këmbën më të mbrapshtë të mundshme. Meqë ma kërkuat, ua thashë këtë gjë.

Ardian Dvorani - Ju kuptova drejt në atë çfarë thatë juve. Në fakt, në pikën e dytë e kemi parashikuar këtë diskutim. Në fakt, e para njëherë që po e them paraprakisht, është se nuk bëhet fjalë për akte që duhen çmuar apo rrëzuar. Ligji i përcakton dhe i jep delegimin KED të bëjë rregullat e brendshme, aktet nënligjore normative tashmë, për verifikimin e kandidaturave, aktin normativ për vlerësimin dhe renditjen e kandidaturave. Madje mendoj se mund të ketë vend edhe për një akt tjetër sepse aty ka një delegim të qartë që ka të bëjë me krijimin dhe funksionimin e sistemit të administrimit të çështjeve. Pra, këto janë arsytet. Pra, unë thashë, nuk jam dëshmitar për aktet që i gjeni të bashkëlidhur. Ne i vendosëm jo thjesht për transparencë por mirë është që, kushdo që të jetë, të njihet me çfarë ka ndodhur. Ky është një organ kushtetues dhe nuk është se po e krijojmë ne. Ai ekziston, përbërja është e re dhe prandaj ju kemi vënë në dispozicion materialet e punës që janë punuar deri më tani. A janë apo s'janë të vlefshme e kështu me radhë unë për momentin nuk e di. Zonja Memçaj ju keni qenë anëtare, a keni diçka për të thënë.

Fatjona Memçaj – Po, unë kam qenë anëtare me status të plotë në mbledhjen e kaluar dhe të vetme të Këshillit të kaluar. E kujtoj mirë gjithë ecurinë e mbledhjes dhe mënyrën edhe të diskutimit që, në gjykimin tim, ishte shume e saktë dhe korrekte. Në gjykimin tim ishte e saktë pasi çdo pikë që ngrihej pasi çdo anëtar e jepte mendimin e vet dhe kjo është e parashtruar në ligj dhe më pas votohej për çdo lloj çështje dhe diskutimi që ngrihej. E sugjeroj që të vijohet kështu edhe në këtë mbledhje, është sugjerimi im, por nevojitet gjykimi i të gjithëve, normalisht.

Së dyti, për sa i përket problemit të rivlerësimit të anëtareve, përsërit të njëjtën gjë që e tha zonja Tusha, është edhe e pasqyruar në procesverbal. Nga anëtarët e KED-së dhe ato zëvendësues, nuk është diskutuar asnjëherë problem i pasjes së tagrit të funksionimit të tyre si anëtare apo si zëvendësues për efekt të moskalimit nga procedurat e rivlerësimit.

Së treti, për sa i përket mënyrës se pse nuk vijoj më tej, nuk mundem dhe nuk jam kompetente të them shkaqet, por, në gjykimin tim personal, siç e di unë ecurinë e atij Këshill, Këshilli në mbledhjen e tij e pa të nevojshme dhe të domosdoshme për funksionimin, hartimin e rregulloreve, për të cilat u krijua një grup e pune, me tre anëtare të Këshillit, që

ishin kryetari, nënkryetari dhe anëtarja zëvendësuese e Gjykatës së Kushtetuese. Në mos gabofsha ky ishte procesi, si dhe që të asistoheshim edhe nga stafi administrativ i Gjykatës së Lartë. Dhe u votua nëse do kërkohej apo jo asistenca e EURALIUS në hartimin e këtyre rregulloreve, të cilat, në përfundim të tyre, si projektakte do ti kalonin të gjithë anëtareve për të dhënë opinionet e tyre dhe do të diskutoheshin në mbledhjen më të afërt të mundshme dhe do të kalohej pastaj dhe në votim. Unë këtë kujtoj nga mbledhja, besoj procesverbali është publik dhe mund të konsultohet nga çdo kushdo tjetër.

Ardian Dvorani – Zoti Alibeaj? Po.

Enkelejd Alibeaj - Unë jo vetëm që e mbaj mend, por e kam procesverbalin para.

Ardian Dvorani - Ai është publik.

Enkelejd Alibeaj - Dhe meqë është publik, për dijeninë e atyre që kanë qenë apo që pretendojnë të jenë anëtarë të KED-së, po citoj pjesën hyrëse të procesit, për rendin e ditës së asaj mbledhje të kryesuar nga kryetari Artan Broci që ka thënë se kam përcaktuar si rend dite konstituimin KED-së, dy shkresa dërguar nga Presidenti i Republikës për dy vakanca të shpallura nga Presidenti, kam përcaktuar krijimin e një grupi për hartimin dhe shqyrtimin e rregullores që përcakton ligji etj. Në përfundim, e lexoj edhe vendimin përkatës, akti i vetëm është rregullorja e funksionimit, se nuk ka sens që pa përcaktuar rregulloren e funksionimit të mendohet për një akt tjetër. Unë po e them thjesht për të qenë në tryezë e për të qenë të saktë e për të mos abuzuar me veprimtarinë okulte, marr guximin ta them dhe këtë, okulte të servirjes së akteve që minimalisht KED –ja, vlefshmërisht e ngritur, do të duhet ajo ti artikulojë, ti formulojë dhe ti miratojë. Pyetja është ju ku i gjetët? Kush ua dha? Cila është dora që jua dha? Cili është guximi për ti marrë e për ti ofruar këtu dhe për ti shndërruar këto në akte zyrtare, projekte. I keni përcaktuar edhe në rend dite. Mbledhja e parë, e pa konstituuar, Kaq. S'mund të veprohet kështu.

Ardian Dvorani - Unë të falënderoj për mendimin dhe qëndrimin. Por nuk ka nevojë dhe nuk dua të ripërsëris ato që sapo thashë. Këto janë të gjitha materiale që janë në zyrën e KED dhe këtu janë edhe anëtarë të grupit të punës dhe të Këshillit të mëparshëm të Emërimeve, por që koincidojnë që janë përsëri anëtarë të KED, të cilët na i kanë vënë në dispozicion këto dokumente. Ata mundet prapë ta shpjegojnë mënyrën se si kanë punuar. Nuk kam absolutisht asnjë paramendim apo mendim paraprak, preferencial apo të çdo natyre qofshin, se që këto janë aktet. Për shkak se ato janë dokumente pune, nuk do të miratohen sot e që mund të mos ishin fare bashkëlidhur. Por që ne menduam ti japim, thjesht për të pasur një ide se si kolegët tanë të Këshillit të mëparshëm, me asistencën e misionit EURALIUS, kanë prodhuar një dokument pune dhe vetëm kaq. E sigurisht që akti i parë që do duhet të

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

diskutohej dhe të miratohet pastaj nga ky Këshill, janë rregullat e brendshme te funksionimit të KED.

Po. Zonja Avokate e Popullit?

Erinda Ballanca - Zoti Dvorani unë kam qenë në atë mbledhje dhe për hir të së vërtetës, ashtu si e thotë zoti Alibeaj, e vërteta është që vendimmarrja ka pasur të bëjë vetëm me rregulloren e funksionimit. Pavarësisht kësaj çështje apo faktit që ka pasur vendimmarrje për të krijuar grupin e punës apo për të bërë rregulloren e funksionimit, është e qarte që kryetari mundet të paraqesë, të përgatisë, të hartojë dokumente të tjerë për t'ia nënshtruar vendimmarrjes së organit që në këtë rast këto dokumente duhet të paraqiten dhe parapërgatiten në bazë të ligjit.

Ka pasur një qëndrim publik, akuzë që i ishte bërë kryetarit të kaluar publikisht në të cilën i është thënë që ju nuk keni duke funksionuar dhe ai ka pasur një qëndrim të tij, ka kthyer një përgjigje publike dhe ka thënë që ne jemi duke përgatitur draftet dhe ia kemi dërguar për mendim EURALIUS-it. Pra nuk është se këto janë akte që kanë dalë sot. Ka dhe qëndrime publike, unë i kam ndjekur për shkak se nuk isha anëtare në grupin e punës për përgatitjen e akteve, por sigurisht kam pasur interesimin tim në rolin që unë kam dhe më njeh Kushtetuta dhe ligji për këtë çështje që puna të eci përpara. Pra, në kuadër të kuptimit se çfarë po ndodh kam pasur këtë shpjegim nga kryetari se janë përgatitur, po përgatiten drafte rreth stafit që ai kishte kërkuar nga Kryetari i Gjykatës së Lartë për përgatitjen e drafteve të para. Këto nuk janë akte të cilat janë përfundimtare. Kjo është një fillësë, në gjykimin tim dhe sigurisht KED e vlerëson, që këto janë dokumente të cilat do të jenë, do të shërbejnë si bazë për të vazhduar më tej punën. Është më mirë të kemi një bazë nga e cila do të fillojë puna. Këto drafte mund të hidhen komplet poshtë nga KED-ja e mund te japim argumente, por ama është një punë e bërë, të cilën edhe në kuadër se çfarë ka ndodhur apo çfarë po ndodh rreth kësaj që ne kemi si problematikë kryesore, pra që kemi vendin pa Gjykatë Kushtetuese, mendoj që është shumë mirë të kemi disa dokumente se sa mos ti kemi fare. Por fakti që kjo ka qenë një veprimtari e kryer nga KED-ja e mëparshme dhe kryetari i mëparshëm, është edhe një fakt publik, përveçse një informacion që unë e kam.

Sigurisht që KED mund të vendosë mos i marrë fare parasysh këto e të nxjerre drafte të reja, këto janë vendimmarrje që mund të vlerësohen. Por besoj që mund të përdoren si një fillësë për punën dhe vendimmarrjen e gjithsecilit. Unë mund të kujtoj që në rastin konkret, kryetari ka pasur një vullnet të posaçëm që të na paraqesë dokumente që ai i ka hartuar ose jo, në një mënyrë apo tjetër. Sepse edhe në rast se është kështu, Kryetari i paraqet, edhe bën vërejtje dhe secili të gjejë aty çfarë nuk shkon dhe kjo çështje të ecë përpara. Por duhet filluar

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

nga kjo punë. Kështu që, në gjykimin tim, janë te vërteta realisht si punë për sa i përket organizimit të mëparshëm dhe të qëndrimit, letër publike, qëndrim publik i ish kryetarit të KED-se, i cili ka pasur akuza publike që nuk po bënte punë dhe ai ka thënë jo ne po punojmë. Tani koleget që sigurisht kanë qenë në atë komision e dinë. Shpresojë që isha e qartë. Faleminderit.

Ardian Dvorani – Mirë. Faleminderit.

Vitore Tusha - Vetëm mund të them këtë. Kjo është një kopje origjinale e bërë nga kryetari bashkë me ndihmësin e tij, të cilin ma ka dhënë mua personalisht, për të parë dhe për të hedhur mendimin, ashtu siç punohet në grup, dhe unë këtë kopje e kam ruajtur, po ta doni për çdo gjë, mbi vërejtjet, mendimet, sugjerimet dhe pastaj aty ka stopuar bashkëpunimi në grup sepse nuk kishte më grup pune, në kuptimin e grupit të ngritur nga KED.

Ardian Dvorani – Po, zoti Gjonçaj?

Genci Gjonçaj - Ju faleminderit kryetar

Në fakt, unë kisha vendosur të mos ndërhyrja sepse pjesa e të ftuarve këtu është për të parë, për të dhënë ato mesazhe që sipas pozicioneve që përfaqësojnë duhet ti japin mbledhjes së parë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Ju jeni organ që jeni konsoliduar nga ligji, sipas gjithë procedurës që është ndjekur dhe kjo është mbledhja e parë. Ka pasur një KED vjet, e cila ka funksionuar si ka funksionuar, ka prodhuar çfarë ka prodhuar, kjo është një çështje e cila ka një memorie administrative. Këtu ka një stad gjykate, secili ka qenë në dispozicion, ka anëtar që kanë qenë dhe vjet, kemi dhe materialet përpara.

Do t'ju lutesha që të fokusohemi ose të fokusoheni, tashmë nuk do kisha dashtë të ndërhyja fare, nuk është në tagrin tim këtu që të ndërhyj, sesi është vendimmarrja në KED dhe çfarë ndodh. KED mund të diskutoj çfarë ndodh, mund të marrë në konsideratë një material apo nuk duhet të marrë në konsideratë një material. Është në tagrin juaj dhe nuk ka asnjë arsye që secili nga ne apo të tjerë jashtë kësaj tryeze të paragjykojnë apo të intimidojnë veprimtarinë e KED-së. KED është krijuar konform ligjit, në zbatim të Kushtetutës dhe marrëdhënies që ka pasur Presidenti i Republikës në Kuvend. Kaq e thjeshtë është. Ju jeni njoftuar zyrtarisht, kjo është mbledhja e parë. Pastaj materialet si janë vënë në tryezë apo si nuk janë vënë në tryezë, kjo më duke-ët që kjo bën pjesë në intimidimin të panevojshëm për veprimtarinë në mbledhjen e parë të Këshillit të Emërimeve. Rekomandoj kryetarin të eci me materialet që kemi dhe me rendin e ditës.

Ardian Dvorani - Faleminderit.

Unë, personalisht shprehem të mos e keni merak. Unë nuk intimidohem. Absolutisht. Nga askush. Kjo është e sigurve, të paktën për mua.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

(ndërrhyrje pa mikrofon)

Ardian Dvorani – As mos e mendoni se mund të intimidohemi. Unë as nuk e mendoj këtë gjë dhe besoj se, edhe kolegët e tjerë.

Ka njeri tjetër që do të marrë fjalën?

Enkelejd Alibeaj - Po kam unë për të plotësuar.

E para, hera e parë dhe e fundit që secili nga anëtarët apo edhe të ftuarit, të mund të vendosin fjalë apo interpretime të tipit indimitim apo jo, për pozitën që kam dhe përfaqësimin që bëj, kjo së pari .

Së dyti, ajo çfarë ju thashë nuk ishte për të sqaruar se kush ka punuar, çfarë dhe kujt ia ka dorëzuar. Ajo çfarë juve keni bërë personalisht duke përcaktuar rendin e ditës, duke vendosur në tryezë, ca letra, informale, nuk ka lidhje me faktin që pse kanë punuar dhe t'ia hedhim punën poshtë. Jo. Ka lidhje me respektin e së drejtës e të gjithë secilit për të përcaktuar punimet e një KED-je, nëse do të konstituohet në mënyrë të vlefshme. Dokumenti asnjëherë nuk ka qenë i miratuar në mbledhjen e parë dhe të vetme. Mund të ketë punuar informalisht dhe i bënë nder kryetarit të KED-së së vjetshme, të shkarkuar tashmë nga KPK-ja, dhe, ndoshta, kjo është edhe arsyeja se përse është shkarkuar dhe ky nuk është indimitim në qoftë se doni të dini. Por ky është realiteti, realiteti që ca prej këtu e rrezikojnë dhe ca jo. As ky nuk është indimitim. Ky është realiteti. Qoftë edhe për fasadë do të ishte në nderin e gjithë secilit këtu që të thoshte ato fjalë që unë thashë.

Kjo është mbledhja e parë, konstituimin e keni vendosur ju si pikë të parë dhe, zakonisht, unë besoj se e keni eksperiencën, përvojën akademike apo edhe të punës, për të kuptuar që akti i parë është pikërisht konstituimi. Ngelet gjithmonë në ndërgjegjen tuaj nëse ju do të shihni shkeljet, defektet e zgjedhjes suaj, e juaja dhe e gjithë se kujt. Pot një gjejë nuk mund ti shkëputen. E them këtu edhe meqenëse nuk e thashë më parë. Po, gjithsecili prej jush mund ta konsideroj veten në mënyrë legjitime të zgjedhur, me një shkresë të Kuvendit. Por, mos harroni, se jeni pjesë e një organi kolegjal, produkti i të cilës është i përbashkët, produkti i së cilës është i përbashkët dhe nuk u mbron fakti që pse ndërgjegjen e kemi pasur individualisht, ndërkohë që kolegu juaj, anash apo përball kudo që është, nuk e meriton të jetë për shkak të Kushtetutës. Nuk do mund ta mohoni dot produktin, Që një pjesë e produkteve është bërë nga individi X, që pretendon të jetë në mënyrë legjitime i zgjedhur, është i pastër dhe pjesë tjetër jo. Këto shifeni. Këtë, unë besoj që është mirë ta arsyetoni. Produkti është përgjegjësi kolektive pastaj, nuk është individuale. Mund të isha edhe unë i zgjedhur prej Kuvendit, për një ironi të fatit, prej këtij Kryetari të Kuvendit. Asnjë kusht nuk plotësoj dhe do vija të trokisja në mbledhjen e Gjykatës së Lartë. Më ka zgjedhur Kryetari i Kuvendit, as

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

gjyqtar, asnjë kusht. Do të më pranonit të bashkëpunojta me ju? Por nuk shkon, sepse kam përshtypjen se secili nga ju ka ato që quhet ndërgjegjja profesionale. Ka të drejtën që, jo vetëm për vetë, por edhe për interesin publik, do të duhet ta arsyetoj këtë. E njëjta gjë është kjo që po ju ndodh tani, më këto letra. Minimalisht respekti për ta filluar aty ku ka ngelur. Ky është detyrim ligjor. E ku ka ngelur? Ka ngelur në një mbledhje të vetme, ku nuk u përcaktua asgjë, nuk mori së paku, së paku nuk mori as edhe një konfirmim të punës të lavdërueshme, informale, e papaguar e kam përshtypjen, për të cilën u sanksionua kryetari i vjetshëm. politikisht, pse kishte atë pozicion. E kemi të qartë, nuk është në indimitim i askujt, është realiteti

Ardian Dvorani – Faleminderit zoti Alebeaj. Po, zoti Roshi.

Eriol Roshi - Mbase duhet te ecim me rendin e ditës.

Në qoftë se pranuar të gjithë dhe me argumentet që dhamë deri tani që u bënë edhe nga raundi i dytë i diskutimit, pra pranuar që jemi të konstituuar për shkak të procedurës së përzgjedhjes me short, atëherë konstituimi që mbetet të bëjmë ne këtu është e thjeshtë e shumë formale siç e thatë dhe ju. Megjithëse jemi të gjithë të njohur me njëri-tjetrin dhe p.sh e dimë që ai është Eriol Roshi dhe ai është paraqitur,. Ky është konstituimi në organet kolegjiale të zgjedhura. Me atë që kuptoj unë, ne jemi të konsituuar pas vendimit të Kuvendit. Në qoftë se nuk ka gjë tjetër me këtë pikë, të procedojmë më çështjen lidhur me aktet nënligjore. Faleminderit.

Ardian Dvorani – Faleminderit. Atëherë nëse nuk ka më diskutim tjetër të mëtejshëm, besoj se debatuar as sa duhet. Ka ndonjë kundërshti që të procedojmë me pikën tjetër të rendit të ditës dhe ta quajmë të mbyllur procesin e konstituimit të KED? Ka kundërshti? E votojmë?

(ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Veizi(Mema) - Për procedurën, unë gjykoj se çdo gjë duhet të kalojë në votim. Pra çdo gjë të shtrohet si pikë se si do të votohet nga ana jonë. Secili të anëtar ka detyrimin të japë mendimin e tij dhe në fund të votohet nga Këshilli. Ky është sugjerimi im.

(ndërhyrje pa mikrofon)

Ardian Dvorani – Mirë atëherë. Anëtarët kanë të drejtën e votës dhe të procedojmë me votimin.

Po e filloj unë dhe me cilësinë e anëtarit të KED e quaj të mbyllur procesin e konstituimit të KED dhe të kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës.

Vitore Tusha – Dakord për këtë. Të vijojmë me rendin e ditës. Kemi detyrimin të punojmë.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Arta Marku – Dakord. Nuk është kusht procesi vetting. Nuk ka mundësi për procedurë shortimi tjetër e të ri.5 anëtarë sipas ligjit janë edhe për kuorumin minimal. Të vazhdojmë.

Fatri Islamaj - Dakord. Mund të vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës.

Margarita Buhali - Jam kundër vetëm për arsyen që mendoj se duhet të kalojmë pjesën e vetting-ut, ashtu siç e thashë, i qëndroj nenit 179 të Kushtetutës. Me të vetmin qëllim sepse pas konstituimit të këtij organi, janë një sërë vendimesh të tjera që janë shumë të rëndësishme për tu marrë, që nga renditja e kandidatëve, që nga miratimi i rregullores për sistemin e pikëzimit, deri edhe në renditjen që ne do ti çojmë organeve. Të gjitha këto janë pjesë e një vendimmarrje shumë të rëndësishme dhe unë mendoj që anëtari i KED-së, për të përmbushur këto detyra, duhet patjetër ta këtë kaluar procesin e rivlerësimit. Jo se e pengon pjesëmarrja ime që unë të jap vendime dhe diçka tjetër, do të votoj patjetër për çdo vendim, por unë mendoj që kjo është hallkë shumë e rëndësishme dhe jo pa qëllim, prandaj e ka dhënë edhe Kushtetuta dhe jo pa qëllim e ka dhënë neni 284. Në rast se nuk do kishte dhe asnjë lloj qëllimi, atëherë pse do ishin parashikuar. Ky është mendimi im.

Fatjona Memçaj – Unë jam dakord. Viojmë me rendin e ditës.

Eriol Roshi – Dakord jam edhe unë.

Ardian Dvorani - Mirë atëherë. E quajmë të përmbyllur pikën e parë të ditës. U bë një kohë e gjatë që vazhdon mbledhja, afër tre orë dhe mendoj se kemi nevojë për një pushim 15 - 20 min. Fillojmë në 1.15? Ka kohë dhe përpiqemi të ecim më shpejt. Faleminderit shumë për gjithçka deri më tani.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Ardian Dvorani – Rifillojmë mbledhjen dhe viojmë me rendin e ditës.

Tani është pika që ka të bëjë me “Përgatitjen e akteve nënligjore dhe të rregullave të brendshme, sipas detyrimeve dhe delegimeve të ligjit nr. 115/2016, të nevojshme për organizimin dhe funksionimin e këshillit të emërimeve në drejtësi. Afatet, përparësitë dhe veprimet për përgatitjen dhe miratimin e tyre në kohen më të shkurtër dhe të arsyeshme.”.

Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, na përcakton, na obligon që të miratojmë rregullat mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Këtë e parashikon pika 1 e nenit 229 dhe veçanërisht neni 230 i ligjit.

Po kështu, për organizimin dhe funksionimin e tij Këshillit të Emërimeve në Drejtësi duhet të përgatisë dhe të miratojë sipas pikës 3 të nenit 230, sipas mendimit tim, rregullat e brendshme të krijimit të sistemit të administrimit të çështjeve.

Janë edhe tre akte me natyrë normative. Sipas nenit 228 pika 3 ku përcaktohet se Këshilli miraton rregulla më të detajuara për të bërë të mundur që procedura e shortit për caktimin e relatorit t'u përmbahet parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit.

Pika 2 e nenit 229 na kërkon të miratojmë edhe procedurat e verifikimit të kushteve ligjore, të pasurisë, të integritetit, të së shkuarës profesionale dhe personale të kandidatëve.

Po kjo pikë, na kërkon të miratojmë edhe rregulla më të detajuara, përveç atyre që vetë ligji i ka përcaktuar, për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve.

Meqenëse janë të gjitha këto akte që duhen përgatitur në mënyrë që efektivisht Këshilli jonë të fillojë të ushtrojë kompetencat unë kam mendimin që, për të mos u sforcuar më shumë se nevojitet, kërkohet që në kohën më të shpejtë të mundshme të miratohen Rregullorja e Brendshme e Këshillit dhe dy aktet nënligjore. Pra ai që lidhet me mënyrën e shortimit dhe rregullat më të detajuara të shortimit, si edhe ai për rregullat e detajuara që lidhen me procedurat dhe kriteret e verifikimit të plotësimit të kushteve për kandidim.

Për këtë arsye mendoj se duhet të diskutojmë dhe unë do të sugjeroja që të vendosim të punojmë me përparësi për këto akte, për të përgatitur njëherësh dhe ndoshta për ti miratuar në mbledhjen e ardhshme të KED-se. Unë do sugjeroja që për një afat një javor, grupi i punës që mund të ngrihet, të punojë intensivisht dhe të përgatisë aktet të cilat më pas duhet ti nënshtrohet diskutimit dhe miratimit në mbledhjen e KED.

Gjithashtu duhet të sugjeroja që, duke qenë se koïncidon që dy nga koleget që janë në anëtare të Këshillit kanë qenë edhe në përbërjen e KED paraardhës dhe janë investuar në procesin e përgatitjes së një pjese të këtyre projektakteve, përveç atij për vlerësimin e pikëzimit për të cilin, me sa di unë nuk është punuar, të vijojnë të jenë në grupin e punës. Unë personalisht ofrohem për të qenë pjesë përbërëse e këtij grupi pune edhe për shkak të përvojës sime të gjatë profesionale në të kaluarën në procesin e hartimit të projektakteve. Siigurisht unë kam një angazhim dhe kemi shumë ngarkesë në Gjykatën e Lartë. Jemi vetëm tre gjyqtarë në detyrë. Por mënyra se si procedojmë këtu është që prezenca fizike dhe puna që ne bëjmë për të përgatitur aktet e gjykimit është duke u mbledhur një herë ose dy herë në javë në dhomë këshillimi dhe aty procedojmë. Pjesa tjetër është një kohë që më takon mua barra dhe përgjegjësia ta administroj, të bëj edhe punët e gjykatës por edhe të angazhohem në grupin e punës për hartimin e projektakteve.

Mundet, mendoj unë, që të shtohet edhe një anëtar tjetër. Nga 3 tashmë të bëhemi 4 anëtarë. Nuk e di? Nuk më takon mua ndoshta ta caktoj. Ndoshta një nga koleget mund ta marrë përsipër edhe këtë angazhim dhe, ndërkohë që punojmë intensivisht dhe miratojmë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

këto akte, të cilat pse janë të rëndësishme, sepse janë akte pa të cilat ky Këshill, nuk mund të fillojë procedurat e verifikimit të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë.

Nëse këto akte përgatiten dhe miratohen, ndërkohë që kryen procedurat verifikimit, mund të punohet paralelisht edhe për hartimin e projektaktit që ka të bëjë me procedurat e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve. Por, sigurisht që, me gjendjen deri tani, unë personalisht, nuk mund të jem pjesë jo vetëm në procesin e hartimit të rregullave, por as edhe në diskutimin dhe në miratimin e tyre.

Dhe natyrisht që në këtë proces do të vijojmë që të kemi bashkëpunimin dhe mbështetjen e kolegëve të misionit EURALIUS. Me atë që unë kam kuptuar, paralelisht juve jeni duke punuar edhe me KLGj dhe KLP sepse edhe aty po përgatiten disa procedura dhe kriteret që kanë të bëjnë me verifikimin apo vlerësimin e kandidatëve. Nuk është se kam një ide të saktë për këtë, por ideja është që grupi jonë i punës, duke pasur edhe mbështetjen e EURALIUS mund të garantojë që jemi një sistem drejtësie dhe të kemi një lloj standardizimi, edhe pse qëllimet dhe ndoshta edhe proceset nuk janë ekzaktesisht të njëjta, por standardet për verifikim dhe vlerësim duhet të jenë sa më të përafërta. Unë nuk mund ta them dot nëse duhet të jenë të njëjta apo jo sepse mund të gaboja, por duhet të jenë sa më të përafërta. Kjo është ajo çfarë doja të parashtroja për këtë pikë të rendit të ditës.

Zonja Tusha, mendimi juaj

Vitore Tusha - Sigurisht përpunimi dhe miratimi i rregullave që kërkon ligji është detyrim kushtetues që duhet ta përmbushim dhe pa të cilin ne nuk mund të vijojmë me misionin apo me kompetencën që e ka ky organ. Për qëllimet që i ka përcaktuar në mënyrë të qartë, transparencën, paanësinë dhe për elemente të tjerë që i ka ky ligj apo edhe për rregulla që nuk i ka kërkuar ligji dhe për nevojën që të kemi uniformitet në zbatim të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese.

Pra, bie dakord që, në përputhje me nenin 210 pika 1, neni 228 pika 3, neni 229 pika 2 të ligjit, të miratohen rregullat dhe rregulloret përkatëse. Lidhur me propozimin që ju bëni për ngritjen e një grupi edhe unë bie dakord, Në çdo rast kur kemi të me një organ kolegjal është më mirë të kemi një material, një draft paraprakisht. Do të sugjeroja dhe nuk e kam për tu tërhequr, sepse unë jam marrë me këtë, mbase është më mirë të përcaktohet të tjerë dhe ndoshta mund të sjellin diçka të re, ku mund të ecim pak më shpejt. Nuk e di, si ta vlerësoni ju. Nuk e kam fare për tu tërhequr, unë kam punuar që në qershorin e vitit që shkoi, kam parë dhe kam ndjekur dhe jam marrë me Këshillin, nuk është se unë kam një ngarkesë të madhe edhe këtë e them, janë ngarkesa të natyrës administrative, pra nuk dua ta them këtë për tu

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

tërhequr, por, mbase, nëse ju e vlerësoni, se është më mirë, ne kemi paraqitur një mendim të caktuar dhe mos është më mirë të jenë të tjerë. Megjithatë në vlerësimin tuaj.

Për afatin nuk e di, për mua do të dëshiroj të dëgjoj të tjerët ndonëse nuk kanë punuar ose nuk i kanë parë rregullat ose nuk i kanë studiuar, sepse sot janë njohur, mbase e dinë ato në vlerësimin e tyre. Unë gjithsesi jam gati dhe e shpreh disponimin.

Ardian Dvorani – Faleminderit. Zonja Marku?

Arta Marku – Besoj se të gjithë biem dakord që të ngrihet një grup pune, për të punuar mbi rregulloret e ndryshme dhe është në vlerësimin e gjithë secilit dhe në vlerësimin tuaj për të ngritur këtë grup pune. Afati për një javë me thënë të drejtën, mua më duket i shkurtër pasi bëhet fjalë për shumë material që duhet punuar. Është e pamundur që të realizohet për një javë pasi secili prej nesh ka dhe angazhime të tjera. Megjithatë, gjithsesi, do të dëgjoj mendimin e kolegeve të tjerë.

Ardian Dvorani – Mirë. Zoti Islamaj?

Fatri Islamaj - Së pari për ndërtimin e grupeve të punës, kur kemi të bëjmë me organe kolegjinale me numër të konsiderueshëm anëtarësh, është efiçente dhe rrit shpejtësinë e përgatitjes së akteve por në një organi kolegjal me numër të kufizuar anëtarësh, unë mendoj që ndoshta të mos vëmë në siklet secilin anëtar se kush duhet të marrë më shumë ngarkesë qoftë edhe si grup pune për aktet e rëndësishme siç janë rregulloret bazë. Në fakt ashtu është, ato diskutohen dhe votohen këtu, por në këtë aspekt mendoj se ose duhet të jemi të gjithë dhe të kontribuojmë të gjithë ose të na jepet materiali, se në fakt nuk njihemi, ne që nuk kemi qenë më parë në KED. Kemi zero informacion për draftet që mund të jenë punuar nga Këshilli i mëparshëm i Emërimeve, na jepen draftet dhe mund të japim opinionin në mbledhjen e radhës. Ndërkohë që për sa i përket vlerësimit sesa është koha e arsyeshme për të mbledhur, diskutuar dhe miratuar këto akte, unë mendoj se një javë është shumë pak. Ndoshta do të duhet pak më shumë.

Ardian Dvorani - Përpara se ti jap fjalën zonjës Buhali, dua të them se ideja është që ndërkohë grupi i punës punon, mundet që të gjithë anëtarëve t'ju komunikojmë mbi ecurinë e projekteve dhe ndoshta, secili të vlerësojë për të bërë komentet paraprake. Unë nuk mendoj që të vazhdojë grupi i punës dhe secili duke e pare projektin e përgatitur, të bëjë vërejtje dhe të mbajë qëndrime. Unë do të kisha këtë ide, por ndoshta unë nuk e thashë apo harrova ta theksoj sa duhet. Po, zonja Buhali.

Margarita Buhali - Në fakt ndaj të njëjtin mendim për pjesën që thatë ju, mendoj se një grup më kompakt mund ta kishte më të lehtë diskutimin, duke pasur parasysh afërsinë e komunikimit, me sa po shikoj unë, unë jam e vetmja që vij nga Gjykata e Apelit Vlorë, pra

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

nga rrethet. Kjo nuk do të thotë që unë nuk jam disponibël 100%, por për shkak të numrit të pakët të gjyqtarëve që ka kjo gjykatë unë kam një impenjim më të madh dhe do isha e mendimit që një grup më kompakt dhe komunikimi gjithmonë midis nesh, nëpërmjet dërgimit paraprak të informacionit dhe të akteve që do të përgatiten, do të na jepte mundësinë që të ishim më fleksibël, edhe për të dhënë mendimin tonë paraprakisht, edhe për diskutimin e ardhshëm paraprakisht. Grupi i punës do të ishte më mirë. Do të doja mos të ndodheshim ballë për ballë në momentin e fundit e të na viheshin në dispozicion aktet, por që ti kishim edhe ne paraprakisht në një kohë të mjaftueshme për tu përgatitur qoftë duke dhënë opinione paraprakisht ose duke u konsultuar me pjesën tjetër. Një javë edhe për mua duket se është një kohë shumë e shkurtër. Faleminderit

Ardian Dvorani - Faleminderit. Zonja Memçaj.

Fatjona Memçaj - Zoti kryetar, së pari gjykoj të diskutoj që Këshilli të vendosë se cilat janë rregulloret për të cilat do punohet. Kjo pasi neni 228, 229 dhe 230 flasin për rregulloren e administrimit të brendshëm, rregulloren mbi verifikimin e kushteve paraprake dhe vlerësimin e renditjen, si edhe rregulloren mbi shortimin e relatorëve. Pra, së pari, duhet të biem dakord në parim se çfarë rregulloresh duhet të fillojë të përgatisë ky Këshill dhe pastaj sugjeroj që për aq rregullore sa do vendosen, të krijohen grupe pune për çdo rregullore. Për shkak se duhet të jetë shumë më e lehtë dhe më e aksesueshme të përgatiten, sepse sa më e madhe të jetë grupi i punës aq më i vështirë është organizimi i punës në gjykimin tim. Çdo draft që do të përgatitet nga grupi i punës patjetër duhet ti shpërmdahet të gjithë anëtarëve për të dhënë vërejtje dhe sugjerime përkatëse por edhe reflektime që të mos ketë përplasje ose parashikime të njëjta mes rregulloreve. Kështu që unë së pari këtë kam si sugjerim .

Kam një gjë personale, meqenëse u propozua të jem në grupin e punës, pasi nga lista e vendeve vakante, në një ndër mandatet plotësuese të Presidentit është një anëtar i familjes time, është motra e bashkëshortit tim dhe, në bazë të nenit 223/c, kjo krijon papajtueshmëri për mua si anëtare e KED për efekt të verifikimit të kushteve ligjore dhe vlerësimit dhe renditjes së tyre. Nuk e shikoj mungesën në këtë, por më tepër në konceptin e pengesës ligjore dhe të konfliktit të interesit që do të doja të diskutohej. Pra, a jam unë në gjendje pengese dhe konflikti i interesit në këtë rast që të marr pjesë në hartimin e drafteve, në diskutime me pas edhe në votim. Do të doja ta diskutonin anëtarët dhe ju lutem do të kërkoja një votim nëse do të jeni dakord për përjashtimin tim apo për mos përfshirjen. E kam më shumë këtë për transparencë dhe nuk e kam fare me idenë që ti shmangem procesit të hartimit të rregullores. Faleminderit.

Ardian Dvorani - Faleminderit zonja Memçaj. Zoti Eriol?

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Eriol Roshi – Mbase do të ishte më mirë që mbi këtë drafte, që kemi përpara, por që s’jemi njohur realisht, ky secili nga anëtarët në kohën që do të përcaktojmë do ti duhet të njihet, kam përshtypjen që edhe grupi i punës që do të ngrihet mbi këto drafte do të punojë. Ka goxha pune për te bere dhe mbi këtë drafte ka për te punuar pak a shume. Do të duhet të ekonomizojmë kohën e që secili ta shikoj vetë materialin e vënë në dispozicion. Duke marre dhe parasysh faktin që mbase edhe grupi i punës do punojë mbi këto draft. Ky është mendimi im.

Ardian Dvorani - Faleminderit. Kolegët dhe anëtarët zëvendësues meqenëse sot janë në mbledhje. Do të presim edhe një mendim të shprehur prej tyre.

Klodiana Veizi (Mema) - Nuk e di sesa ne zëvendësuesit duhet të përfshihemi në këto drafte, sepse edhe ne si kolegët e tjerë jemi shume të impenjuar me gjyqe, me ngarkesën. Edhe ne mbase duhet të themi marrim pjesë, por do parë se çfarë roli kemi, si do të përfshihemi, kur do paraqitemi. Diçka thuhet në këto drafte, por nuk e di sesa duhet ti përmbahemi, ose nëse do te mbetemi asaj që do të vendosni juve meqenëse jeni anëtarë me të drejtë vote.

Ardian Dvorani - Faleminderit. Zoti Brahimllari.

Gurali Brahimllari - Unë si opinion, doja të sugjeroja që materiali që na është vënë përpara, posaçërisht rregullorja me te cilën pata mundësi ti hidhja një sy, mendoj se duhet të shërbej si bazë shumë e mire për organizimin dhe funksionimin e Këshillit. Ai është akti i parë që mund të bëhet edhe brenda javës, sepse e shikoj që është punuar shumë mirë dhe mund të kalojë pa ndonjë debat të hollësishëm. Ndërsa problematika që lidhet me aktin tjetër, që është për vlerësimin, mendoj që, sikurse tha zonja Memçaj, për përfshirjen apo jo të anëtareve që kanë pasur një problematikë në një kandidaturë, ky mund të jetë problemi edhe tek koleget e tjerë, rast në të cilën edhe ne vijmë për zëvendësim. Lidhur me problematikat e përfshirjes ne aktet e përgjithshme, mendoj se nuk ka asnjë nga ne ndonjë konflikt, pavarësisht nga nisma që ka shprehur kohë me parë për të qenë pjesë e një pozicioni apo do ta shprehi në të ardhmen. Sipas ligjit, pengesa qëndron vetëm në rastin konkret, në votimin konkret, të vendit për te cilën preferohet i afërmi apo anëtari i KED-se. Prandaj, lidhur me përgatitjen, unë mendoj se asnjëri nga ne, anëtarët, përfshirë dhe kryetarin, nuk mendoj se kanë pengesë. Në fund të fundit, rregullorja apo të gjitha aktet që do të dalin nga KED-ja do ti nënshtrohet votimit të përgjithshëm dhe nuk është determinant mendimi i njërit apo tjetrit.

Ardian Dvorani - Faleminderit. Zonja Ballanca?

Erinda Ballanca – Nuk kam mendim lidhur me këtë çështje. Mendoj që duhet një kohë e mjaftueshme që aktet të jenë në formën e duhur dhe të trajtohen. Afatet e shkurtra, për

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

mendimin tim, e bëjnë pothuajse të pamundur kryerjen e punës efektive, duke ditur dhe ngarkesën e personave të tjerë. Sot na u vu në dispozicion aktet, secili duhet të marrë kohën për tu menduar dhe duhet të konsultohen dhe gjëra që janë të gatshme se nuk është se kemi praktikë e një lloj eksperience lidhur me këtë çështje. Kështu që mendoj që koha duhet të ishte pak më madhe.

Ardian Dvorani - Faleminderit. Zoti Gjonçaj?

Genci Gjonçaj - Mendoj se është lehtësisht e përballueshme. Ka një material bruto, ku qarkullohet ndërmjet anëtareve, me *track* dhe *change*, me një fokus në 2 persona, 3 persona, nuk e shikoj shqetësim këtë gjë. Çështja është që procesi duhet të eci, në vështtrimin tim, sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ardian Dvorani - Faleminderit. Zoti Alibeaj?

Enkelejd Alibeaj – Kam përshtypjen që e para gjë që duhet të saktësohet, lidhur edhe me pozicionin tim të pjesëmarrjes në mbledhje dhe jo vetëm besoj, për të gjithë ata që efektivisht nuk mund ta marrin pjesë me të drejtë vote dhe këtu përfshij përfaqësuesit e Kuvendit, Kryetarit, Presidentit. Pak më shumë është i konsoliduar roli i avokatit të popullit. Pak më tepër është konsoliduar roli i zëvendësuesve. Pra është fakti që do të duhet, gjithmonë i kam këshillë, i them në ajër këto, nuk ia drejtoj asnjërit prej jush, thjesht kështu si zgjidhje për ta patur në mendje. Akti i parë që do duhet një organi i cili konstituohet, në mënyrë të vlefshme gjithmonë, do ta dëgjoni këtë këngë nga unë, është funksionimi i tij, rregullorja e brendshme dhe akt tjetër çfarëdo emri që të ketë. Është logjike, është rregull logjik. Ai akt do të jetë besoj unë lënda e parë që mund të zgjidhë shumë nga dilemat, që mesa shoh unë janë shumë. Kjo për sa i përket procedurës.

Për sa i përket përmbajtjes, diçka që më duhet dhe duhet ta them tani dhe besoj që është një çështje që duhet ta diskutojë gjithsecili, sepse është detyrim ligjor. Çështja e konfliktit të interesit. E thashë edhe njëherë, elementi bazë që jep besueshmëri veprimtarisë së këtij komisioni, këshilli, në fakt çdo lloj organi tjetër, po këtij posaçërisht, për shkak të frymës se si e ka konceptuar Kushtetuta, përbërjes, është pikërisht eliminimi i çfarëdo lloj sfumature sa do të brishte të këtij konflikti interesi. Me aq sa unë kam njohuri të legjislacionit, baza ligjore e detyrueshme për konsultim me rezulton të jetë, ligji 115/2016, meqenëse ra fjala ka dhe gabime materiale, kur të vij puna besoj që do të konstatojmë.

Ardian Dvorani - I kam parasysh. Ka disa gabime në referencat ligjore

Enkelejd Alibeaj – Gabime në referenca në një ligj të përforcuar që pretendon të ruaj, koracojë, imunizojë organin ndoshta më të rëndësishëm. Është dilemë e madhe kjo, nuk besoj se nuk do keni mundësi ta zgjidhni. I pari ky ligj. I dyti Kodi i Procedurës

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Administrative, ligji ne te njëjtën fuqi, i barasvlershëm me këtë, edhe me shtrirje edhe për këtë organ dhe i treti është ligji për konfliktin e interesit, ligj i cili përcakton rregullat përplotësuese ndaj ligjeve te tjera, të cilat mund të kenë mangësi. E meqë ra fjala, për aq sa unë e njoh këtë ligj, për aq sa e kam konsultuar, lidhur që me hapat e parë të tentativës për vendimmarrjen e një organi të tillë, kam përshtypjen që gjithë secili prej atyre të cilët kanë të drejtën abstraktë për të votuar, gjëja e parë që sigurisht duhet ta vetë deklarojnë konfliktin e interesit. Është detyrim ligjor por që shkon edhe në nivele morale.

Së dyti gjithmonë për ta sjellë në vëmendjen tuaj, jeni ju që duhet ta vlerësoni, kur bëhet fjalë për vendimmarrje që premisa bazë për të konstatuar ekzistencën ose jo të konfliktit të interesit, prapë ju sjell në vëmendje që neni 4 i atij ligji përcakton fare qartë se cili është koncepti i vendimmarrjes. Po, vendimmarrja është momenti final kur shprehet vullneti i gjithë secilit dhe mishërohet me anë të një votimi eventual në një akt administrativ. Por, ai ligj me shumë delikatesë dhe elegancë, ka përcaktuar që vendimmarrja do të përcaktohet se përfshin edhe momentet paraprake e do të vlerësohen ato çaste paraprake te vendimmarrje sipas shkronjës A, ishte ajo që thashë, të cilat janë thellësisht të rëndësishme dhe përcaktuese në përmbajtjen përfundimtare të aktit. Që do të thotë se edhe konsultimi është një trajektore procedurale që përfshihet, mbulohet dhe monitorohet nga konflikti i interesit. Kështu që kjo është një çështje që ka nevojë për gjithë secilin prej jush që të ndër marrë, me iniciativë ose jo, në respekt të këtij ligji, vendimmarrjen përkatëse. Se fundi, ju thashë, derisa të miratohet të rregullorja përkatëse për funksionimin, ndjesë nga ana ime që nuk janë të përcaktuara limitet e pozicionit tim, por do pres deri në atë moment kur të saktësohet edhe pozicioni im, për sa i përket pjesëmarrjes, fjalës, kohës që mund të kemi si përfaqësues të Kuvendit për të folur këtu. Faleminderit.

Ardian Dvorani - Faleminderit zoti Alibeaj. Përpara se te diskutojmë apo të riçelim diskutimin edhe mbi problematikat dhe qëndrimet që mbajtën kolegët, në fakt, një nga motivet se përse kolegët e nderuar nga EURALIUS dhe OPDAT janë të pranishëm sot këtu, është kontributi që kanë dhënë dhe që personalisht mendoj e pret të japin për të na mbështetur në përgatitjen e këtij kuadri rregullator dhe nënligjor të KED. Nëse nuk keni kundërshtime do të doja të dëgjoja njëherë edhe mendimin e tyre dhe pastaj të rishprehemi lidhur me pikat e rendit të ditës.

Anita Mihailova (*përkthen përkthyesja*) - Faleminderit shumë zoti Dvorani. Marr fjalën në emër të EURALIUS dhe jam Anita Mihailova, jam eksperte e jashtme në EURALIUS. Së pari, dua të theksoj që kemi pasur një bashkëpunim dhe një punë shumë të frytshme me grupin e punës, i ngritur nga KED i mëparshëm. Dhe kam pasur vërtet kënaqësi

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

të shikoja këto materiale që janë punuar nga ne, ti dorëzoheshin edhe anëtarëve të rinj të KED-së. Sepse unë besoj që kontributi i dhënë nga ekspertët e huaj dha ata vendas, gjatë punës që është bërë nga grupi i punës, ka qenë dhe ka pasur një rëndësi vërtet shumë të madh. Megjithatë kontributi më i madh tani mbetet ai kontribut që do të jepet nga anëtarët e rinj të KED-së, pra që është kontributi juaj. Ne besojmë dhe për këtë ju rekomandojmë të gjithëve që të merrni kohën që ju nevojitet dhe mundësi të punoni në thellësi dhe të konsideroni këto materiale që u janë të shpërndarë. Duhet ti konsideroni me kujdes projektetregullat dhe të jepni edhe versionin tuaj përfundimtar. Në emër të ekipit të EURALIUS, doja të shprehja gatishmërinë tonë, për punën e përbashkët të mëtejshme. Faleminderit shumë.

Ardian Dvorani - Ju falënderoj për mendimin tuaj. Nëse përfaqësuesit e OPDAT vlerësojnë të thonë diçka lidhur me këtë pikë?.

Michelle Lakomy (*përkthen përkthyesja*) - Në emër të OPDAT, unë jam Michele Lakomy, faleminderit që na përfshitë në këtë mbledhje. Ne mezi presim që do të vazhdojmë partneritetin me Këshillin dhe dua që ti përsëris dhe ti ritheksoj momentet që bëri përfaqësuesja e EURALIUS. Unë mendoj që është e rëndësishme që Këshilli ti bëj të vetat këto drafte dhe këto dokument. Por megjithatë ne do të jemi të gatshëm që të ofrojmë mbështetjen tonë dhe të koordinojmë në punën e mëtejshme.

Ardian Dvorani - Ju Faleminderit. Tani nëse unë i përmbloodha ashtu si duhet, është çështja a duhet të kemi një grup pune apo jo apo grupe pune, e dyta të qartësojmë gjithë secili nëse ka ndonjë konflikt interesi apo një pengesë për të marrë pjesë, qofte edhe në këtë fazë të hartimit të projektakteve dhe e treta është çështje e afatit të përgatitjes së tyre.

Afati i sugjeruar nga unë, u nis thjesht nga kjo bazë, pra meqenëse kishim një bazë për të punuar, mund të tentonim, sipas meje, për të bere disa nga këto akte, sigurisht e para rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të këshillit, si dhe rregullat normative, sepse unë dua ti ndaj këto, pavarësisht së në këtë projektakt ato janë bashke, por sipas mendimit tim nuk janë. Rregullorja e brendshme janë tonat ndërsa procedurat e shortit kanë natyre tjetër dhe duhet të ndahen. Por pa i hyrë këtyre teknikaliteteve sot, ideja ishte që mund të tentohej të punohej sa më shpejtë, pra thjesht me vullnetin e mire dhe me dëshirën e mire nëse arrijmë ti miratojmë këto akte shpejt, atëherë mund të filloj edhe procedura, pra mund të fillojë efektivisht ajo për te të cilën ne jemi caktuar si anëtar këshilli, ku janë edhe procedurat e shortimit të relatorit për pozicionet vakante dhe të kryen më pas një mori e madhe veprimesh që ligji parashikon, nuk e di pastaj sa do të detajohen në aktet nënligjore për procesin e verifikimit te kandidaturave.

Për sa i përket konfliktit të interesit, unë e vlerësoj këtë gjë gjithsesi, edhe ato që tha zonja Memçaj dhe zoti Alibeaj. Unë prandaj u shpreha personalisht që unë nuk e shoh veten, e kjo pavarësisht ndërgjegjes time, përgatitjes time, pra nuk ka rëndësi se çfarë mendoj unë, por nuk e shoh veten mire që të përfshihesha, se koincidenca e rrethanave ashtu e solli, pra të përfshihesha në procesin e përgatitjes të rregullave të detajuara të vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve.

Nuk mund ta di, por nëse nuk keni dakordësi që për një javë mund ta përmbylim këtë punë, unë mendoj se mund të bëjmë edhe një ndarje, të përfundojmë njëherë me rregulloren e brendshme, e cila mendoj që është shumë e rëndësishme për ne për organizimin e brendshëm, por që, nga përvoja ime, mundet t'ia dalin edhe që brenda një afati një javor ta përfundojmë. Unë jam dakord me disa nga folësit, që aty mungojnë disa rregulla, edhe rregullat se si zhvillohet kjo mbledhje, si merret fjala, edhe për pozicionin i të ftuarve që e tha zoti Alibeaj. Jam shumë dakord me problematikat dhe kam disa shënime që unë i kam bërë për veten time e që duhet të gjejnë vend edhe në rregullat e brendshme të funksionimit të këtij Këshilli. Dhe pastaj mund të tentojmë që brenda dy javëve të kemi rregullat nënligjore të shortimit dhe të verifikimit.

Ne mund të marrim edhe kohën, askush nuk na detyron, edhe mua as kush nuk më detyron, të angazhohem për afate të shpejta. Por, ashtu sikundër unë e mendoj, duke e parë situatën konkrete, pra, nuk kemi një gjykatë kushtetuese, nuk ka Inspektor të Lartë të Drejtësisë. Në qofte se ne marrim kohë 1 apo 2 muaj për të hartuar aktet e brendshme të funksionimit, atëherë mund ti krijojmë një konformitet, pak konfort dhe pak rehati vetes, por në fakt i bëjmë dëm interesit publik dhe detyrimeve ligjore dhe kushtetuese që kemi. Kjo është dhe arsyeja. Pra nuk ishte ideja ime e nxituar për të thënë thjesht ecim shpejt dhe nuk mendoj se janë gjëra të thjeshta për tu diskutuar apo për tu përgatitur. Ne që jemi gjyqtar dhe jemi mësuar të mos i marrim afatet më të ngushta por për ata që punojnë në një organ ligjvënës apo në ekzekutiv shpeshherë punojnë edhe me një ngarkesë të jashtëzakonshme sepse duhet të përfundojmë, për arsye të tjera, e jo thjesht formale, sa më parë një punë të caktuar. Kjo është arsyeja që unë e thashë. Kërkoj të më mirëkuptoni, nuk kisha idenë që hajde se gjëra të lehta janë këto dhe ti bëjmë shpejt e shpejt. Por që e evidentoj këtë problem dhe do të kërkoja edhe nga juve një angazhim ekstra. Unë do ta them edhe në pikën e fundit, unë mund ta antiçipoj tani, një nga mendimet e mia është që ne duhet ti drejtohem KLGJ dhe KLP, jo vetëm për projektaktet, por edhe për pjesën që do të vijë së shpejti në punën tonë për të ushtruar kompetencat tona. Unë do ti sugjeroj KLGJ dhe KLP që të lehtësojë apo të shkarkojë tërësisht nga ngarkesa e punës, anëtarët e Këshillit, në mënyrë që ata ti dedikohen

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

kësaj nga pune. Sepse ka edhe afate, në qoftë se rregullat hyjnë në fuqi, pastaj unë e di se sa afat kanë ikur por ne nuk mund të fshihemi mbas afateve. Kandidaturat duhet ti verifikojmë dhe shikojmë në kohën më të shpejtë të mundshme, edhe sipas të afateve ligjore. Kështu që prandaj po e them tani këtë gjë, e kam tek pika e fundit e problemeve tona. Shpresoj që KLGJ dhe KLP të na përkrahi në këtë shqetësim që kemi. Nuk e di.

Unë vetëofrohem për të marrë pjesë në grup pune por nuk kam asnjë arsye për të vendosur, disa nga kolegët tuaj më thanë është në vlerësimin tuaj por unë nuk kam asnjë rol. Jo vetëm sepse nuk kemi rregullat e brendshme, por edhe mbas rregullores se brendshme, ligji nuk i ka dhënë kryetarit të Këshillit ndonjë autoritet për të vendosur ai se kush duhet të punojë. Unë nuk mund të vendos absolutisht asgjë. E vetmja kompetence e imja është të përgatis rendin e ditës, të thërras Këshillin dhe të drejtoj mbledhjen e kur kam pengesë këtë rol e merr zëvendëskryetarja. Këto janë kompetencat ekskluzive të miat. Por jo që unë të vendos se kush duhet të jetë në grup pune. Unë thjesht, si çdo anëtar tjetër, dhashë mendimin tim se si mund të punohet dhe kush mund të jetë. Nuk e di si mendoni të procedojmë?

Unë e di shume mirë që koleget janë shumë të ngarkuar me punët e veta gjyqësore e prokuroriale, por kjo nuk është vetëm çështje që mund të votohet, nuk është vetëm problem vote. Kjo është diçka që ne duhet ta gjykojmë dhe ta vendosim bashkërisht. Unë mund të votoj vetëm për veten time, por nuk mund të votoj për të ngarkuar kolegët.

Fatri Islamaj - Kjo ishte edhe arsyeja pse bëra atë propozim. Ndoshta i shkon përshtat kësaj situate dhe momenti që duket si ngërç procedural. Duket që është e paarsyeshme të diskutojmë, si pak më parë, lidhur me rregulloren e brendshme të Këshillit. Edhe meqenëse ne sot që flasim nuk kemi përcaktuar rregullat te brendshme përsëri po përsëris vetveten dhe po them qe ndoshta me rregulloren e brendshme, po e përsëris veten dhe po them që ndoshta mund të merremi të gjithë me draftin që ne kemi në dispozicion e të shikojmë një kohë më urgjente për miratimin e saj. Pas miratimit të rregullores se brendshme, kemi parasysh që tek rregullorja e brendshme të parashikohen edhe dispozita për këtë që po diskutojmë tani, edhe për mënyrën e organizimit, procedimit, të grupeve te punës, numri i anëtareve të një grupi pune, sa është e arsyeshme të ketë një grup pune etj.

Ardian Dvorani – Mendim tjetër?

Vitore Tusha - Rregullat që duhet miratohen në përmbushje të detyrimeve ligjore që lidhen me organizimin e brendshëm apo administrimin e këtij organi, ato që lidhen me shortin, në rastet e shortit manual, në rastin kur sistemi elektronik nuk funksionon, apo rregullat që lidhen me verifikimin e pasurisë, të integritetit dhe të shkuarës profesionale, këto rregulla, sipas meje, pavarësisht se i leme në ditë të ndryshme për ti miratuar apo i miratojmë

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

në një ditë të gjitha, kjo varet, por sipas meje këto rregulla duhen miratuar përpara se të fillojmë me veprimtarinë për të cilën është krijuar ky organ. Kjo sepse të gjitha këto, na imponojnë pastaj rregullat për fillimin e veprimtarisë dhe menjëherë do të kemi parasysh se do të jemi të detyruar të ndjekim disa afate. Tani ne nuk mund ti ndjekim afatet që na imponon ligji nga sjellja e listave, sepse listat kanë një vit që kanë ardhur, afërsisht ne shkurtin e vitit që shkoi, mars, shtatori etj., por do të vendosim një rregull ose një normë e cila do të na kushtëzoj me miratimin e rregullores, apo me kalimin e një afati, me publikimin, me hyrjen në fuqi, pra duhet të kemi një uniformitet. Të gjitha këto kanë menjëhershëri, nuk është vetëm çështja e monitorimit thjesht e mbledhjes. Mendimi im është se të gjitha këto rregulla duhen miratuar para se të fillojmë veprimtarinë esenciale, veprimtarinë kryesore që ne kemi. Rregullat mbi vlerësimin dhe mbi pikëzimin presin edhe një moment të dytë, na lënë një hapësirë sepse procedurat e tjera duan kohë dhe mënyra se si operohet sipas kërkesave ëe ligjit, na lejon që të kemi edhe një etapë të dytë për të miratuar rregullat. Kështu e kam kuptuar unë në tërësi. Pastaj për ti ndarë është tjetër gjë, një një javë, një javën tjetër edhe mundet. Por nuk mendoj që mund të hyjnë disa rregulla në fuqi të shkëputura nga rregullat e tjera. Mendoj që duhet të jenë në tërësi, pavarësisht se si i ndajmë si rregullore të veçanta si i ka titulluar ligji apo në pjesë dhe kapituj të një rregulloreje.

Ardian Dvorani – Pra ju mendoni të përgatiten të gjitha si paketë, njëherësh ?

Vitore Tusha - Po mundet që njëriën ta lëmë që javën që vjen. Ajo që mund të vlerësohet më e shpejta, mund të ezaurohet mbas një jave, tjetra mbas dy javësh, por gjithë këto grup rregullash që përmenda, mendoj që janë të domosdoshme të miratohen përpara se sa të fillojë detyrimi për të bërë shortin, për të caktuar relatorin, për të bërë ato shkresat e institucioneve, sepse ato na imponojnë, në mënyrë të menjëhershme, të ndjekim të gjitha rregullat që ka ligji, të gjithë procedurat.

Klodiana Veizi (Mema) - Mund të jap një mendim?

Ardian Dvorani - Po, patjetër.

Klodiana Veizi (Mema) - Tani duke qenë se kjo është një përvojë e re për pjesën më të madhe tonën dhe duke parë që, në thelb, këtu jemi në një procedurë administrative dhe gjithë problemi është si do të konkludojmë ne me rregulloren tonë të brendshme që do ta rregullojmë me veprimtarinë tonë. Me të miratuar rregulloren, pastaj mund të kalojmë në këto pikat e tjera, por pa miratuar rregulloren jemi ende tek pika 2 e rendit të ditës.

Tani pa dashur të përsëris zotin Alibeaj, në çdo procedure administrative është fazë e parë paraprake e përgatitjes së aktit dhe faza përfundimtare. Në fazën paraprake zakonisht ata që e përgatisin aktin kanë ato, le të themi është një grup teknik që e bën, që merr të dhëna nga

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

institucione apo ku di unë, nga praktika të ngjashme. Në rastin tonë jemi vetë KED që do miratojë rregulloren e saj të brendshme. Ndoshta me short, ndoshta me një mënyrë tjetër ose me vullnet, një grup pune prej 4 vetash mund të shohë këtë projektregullore të brendshme që e ka pasur KED e mëparshme, ose që ka ardhur me këshillën e OPDAT ose të EURALIUS. Të paraqesë ato mendimet e veta nëse duhet të kalojë kështu ose ka nevojë për një ndryshim, i kalon secilit prej nesh me e-mail, apo me ndonjë rrugë tjetër për tu parë, mblidhemi dhe e diskutojmë për të gjitha ato pika dhe marrim vendim. Kjo do ishte më e arsyeshme. Që të gjithë bashkë? Është njësoj sikur ne të konkludonim direkt në vendimmarrje. Projektin që duhet ta përgatisim vetë të votojmë. Kurse kështu do të ishte mbase më e udhës, kështu mendoj unë, duke pasur logjikën e aktit administrativ, si krijohet dhe si miratohet. Pastaj u takon juve. Mendoj se edhe zëvendësuesit mund të përfshihen, përderisa ata duhet të kenë ndonjë dispozitë për pozicionin e tyre.

Gurali Brahimllari - Edhe unë kisha këtë mendim që përfshirja të jetë e të gjithëve, posaçërisht e anëtarëve, po të jetë e nevojshme, edhe në që jemi zëvendësues nëpërmjet rrugës elektronike. Por të ngrihet një grup pune ku ne adresojmë mendimet tona për ligjin dhe pasi ky grup i mbledh të gjithë mendimet e sugjerimet e ardhura nga personat që janë interesuar për të studiuar dhe për të dhënë mendim për ligjin, krijon grupi një draft mbështetur në draftin e mëparshëm dhe me të gjitha këto mendime. Sepse në qoftë se do mblidhemi të gjithë së bashku, të mblidhemi dhe një herë dhe të votojmë dhe njëherë pikë më pikë, mendoj se është dicka jo produktive. Ndërsa në qoftë se grupi do të jetë thjesht për të mbledhur të gjitha mendimet dhe vete grupi i përpunon ato dhe jep dhe mendimet e tij, secili nga anëtarët i ka versionet e tij se çfarë mendimesh ka dhënë dhe ballafaqohet në mbledhjen e ardhshme që mund të jetë edhe e shpejtë dhe të përfundojë rregullorja sa më shpejt të jetë e mundur., Pra unë mendoj të veprohet në këtë formë, pastaj hap pas hapi, të mendojmë mund të veprohet më tej. Faleminderit.

Ardian Dvorani - Mirë pra. Procedojmë me rregulloren e brendshme -

Për grupin e punës, edhe njëherë. Rregullorja e brendshme ka thjesht rregullat tona të brendshme dhe unë mendoj se nuk ka asnjëri konflikt interesi se si do të funksionojë, se si do të marrim fjalën, kjo është një gjë që nuk lidhet kompetencat. Ka një lidhje sigurisht, por duhet mënjanuar sepse është thelbësore, këtu është mënyra se si ky organ kolegjal funksionon, diskuton, voton e kështu me radhë. Pra nëse i kthehemi propozimit tim të parë mund të vazhdojë i njëjti grup, duke u shtuar edhe unë. Për rregulloren e brendshme që të jemi të qartë. Kurse për të punuar me aktet e tjera ju sugjeroj që të mbarojmë me pjesën e

parë pastaj në mbledhjen e ardhshme marrim vendime të tjera. Shikoj që jeni dakord të gjithë me këtë mënyrë.

Gurali Brahimllari - Pikë kontakti do jeni ju?

Ardian Dvorani - E para njëherë, të gjithë kontaktet e njëri-tjetrit i kemi dhe sigurisht pastaj grupi punës. Por ne mund të jemi, sipas teknologjisë aktuale, gjithmonë *online*. Nëse më dërgoni diçka mua, sigurisht që e merr në të njëjtën kohë zonja Tusha automatikisht dhe praktikisht do ta ndërtojmë në atë mënyrë që, realisht, të marrë dijeni gjithkush Nuk është se mbetet një komunikim konfidencial midis dy anëtarëve apo dy subjekteve të tjera që marrin pjesë dhe kanë interes në këtë proces. Mund të procedojmë në këtë mënyrë? Sepse kjo na obligon pastaj që të caktojmë paraprakisht ditën e mbledhjes së ardhshme. Mendoni që një afat rreth një javor do të ishte e mjaftueshme të paktën të bëjmë përpjekje, të shpallim datën e sotme dhe nëse nuk ja dalim, uroj që jo, pastaj të njoftojmë për shtyrjen e mbledhjes? A mund të tentojmë mbas një jave, vetëm për rregulloren? E them në parim këtë edhe për arsyen se gjithkush nga ne ka angazhimet e veta dhe nuk kemi të tilla angazhime që i vlerësojmë vetë ti kryejmë ose jo. Duhet të zbatojmë dhe ligjin në organet tona përkatëse ku punojmë dhe prandaj them unë që të programohet dhe këtu kam unë më shumë merakun. Unë mund t'ju marr në telefon dhe më mirëkuptoni, e me këtë rast duhet t'ju falënderoj se me anë të telefonatave reciproke ne lamë datën e mbledhjes së sotme, por tani mirë është që të vendosim edhe datën, të paktën të tentojmë datën. Mendoni që është e hëna tjetër? Juve si i keni ngarkesat tuaja, për të hënë?

Margarita Buhali - Mendoj për të hënë. Vendosim edhe orarin. Duke qenë se do të jetë e fokusuar vetëm tek rregullorja dhe ne do të duhet ta marrim paraprakisht dhe ideja është që tek mbledhja e ardhshme ne do të diskutojmë më shumë për ndarjen e grupeve të punës, për sa i përket përcaktimit dhe përgatitjes së akteve ligjore, besoj se nuk do jetë kaq e zgjatur në kohë, them unë, dhe ndoshta mund të caktomë një orar pasdite, ose si ta vlerësoni ju.

Ardian Dvorani - Jo, mua personalisht mos më diskutoni, unë jam 24 orë këtu për këtë çështje.

Margarita Buhali - Si ta vlerësojmë, të gjithë së bashku.

Ardian Dvorani - Unë e kam luksin të jem edhe më i kollajshëm se ju, sepse për mënyrën si procedon Gjykata e Lartë e kam të përcaktuar faktikisht kohën se kur gjykoj.

Fatri Islamaj - Angazhimet tona janë të paracaktuara për të hënë që vjen, unë mendoj që, në qofte se është e arsyeshme dhe në qofte se bini dakord të gjithë, e lëmë për të hënë që vjen, të paktën ta lëmë nga ora 3 që të mbarojmë disa angazhime të tjera që janë të

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

planifikuara shumë kohë më përpara dhe kanë rëndësinë e vetë dhe vazhdojmë pastaj sa të mundemi.

Ardian Dvorani - E lëmë ditën e hënë, ora 15.00. Mund ta quaj të ezauruar këtë pikë të rendit të ditës?

Në dy pikat vijuese të rendit të ditës, në fakt qëllimi është më shumë ose u gjykua më shumë për paraqitur informacion paraprak për kolegët lidhur me ngarkesën e punës, e cila e pret KED për gjatë vitit 2019, përveç rrethanave të tjera. I kemi përsëritur të gjithë sot se nuk kemi funksionale Gjykatën Kushtetuese dhe s’kemi në detyrë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Për pikën “Informacion për pozicionet vakante, të shpallura nga Presidenti i Republikës, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë, për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, numrin e kandidatëve dhe administrimin e dokumentacionit përkatës”, thjesht do ta përmbledhja këtë informacion të përgatitur dhe nuk po e lexoj, kemi përgatitur tabelën e pozicioneve vakante, e kam ndërtuar këtë tabelë duke menduar se si është ligji i zbatueshëm dhe pak a shumë mund të kuptohet edhe se si “skenari” do të thosha i ecurisë së vakancave në Gjykatën Kushtetuese, nëse e vëreni aty.

Pra në tabelë praktikisht kam vendosur kush janë gjyqtarët, për të cilët duhet të plotësohet mandati aktual apo që duhet të zëvendësohet në mandat të plotë, afatet, kush janë kandidatët që kanë shprehur interesin për të qenë gjyqtarë kushtetues e kështu me radhë. Siç mund të vihet re 3 janë vakancat e plota për mandat të plotë dhe 5 janë për mandatet plotësuese.

Për sa i përket ngarkesës që ne na pret, unë dua të sjell në vëmendje dy nga pozicionet vakante për mandat plotësues që aktualisht mbarojnë në 20 Maj 2019 Janë shpallur nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi. Për vendin e shpallur nga Presidenti i Republikës, në fakt ka 3 kandidatura të ardhura, por unë nuk e di, ne do të bëjmë sigurisht punën tonë, por kjo varet dhe nga ata se kur mund të përfundojnë aktet nënligjore të verifikimit dhe të vlerësimit, patjetër. Por ajo që dua të sjell në vëmendje është që meqenëse mbaron mandati në 20 Maj, atëherë në shkurt, sipas ligjit, pra mbas pak javësh, Presidenti dhe Kuvendi duhet të shpallin edhe vakancat e plota. Dhe, siç tregon tabela, mund të vini re që për vakancat e plota, sidomos ato afatgjate, numri i kandidatëve është i madh. Kështu që pritshmëria ose parashikimi im është që, nëse aktualisht kemi 71 kandidime nga 37 kandidatë, ky numër mund të rritet ndjeshëm, nuk mund ta përcaktoj se sa do rritet, por ka mundësi që të jetë një numër dhe më i madh kandidatësh.

Për kandidatët, një gjë që do të evidentoj se do të rrisë ngarkesën e punës sonë, nuk është ende e shënuar edhe në tabelë, por 19 kandidatë janë plurikandiduar, pra kanë kandiduar në më shumë se një pozicion vakant. Dhe kjo është një nga sfidat edhe për rregullat që do të bëjmë, se si do të procedojmë kur të shorthet pozicioni vakant dhe njëkohësisht kandidati është i pozicionuar në 3 vende të lira etj, etj. Do procedojmë 3 relatorë përnjëherësh e kështu me radhë etj. Prandaj do të bëjmë me rregulla me të detajuara, pasi dhe ligji nuk i përcakton.

Shkurtimisht mund të parashtroj edhe se nga 37 kandidatë, 15 janë magistratë, janë kolegë tanë dhe 22 jo magistratë. Nga të gjithë kandidatët 3 janë konfirmuar në detyrë përfundimisht, ka 2 kandidatë të cilët kanë vendimin nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, por nuk janë zbardhur vendimet, me sa di unë, kështu nuk do të kemi ankim apo jo, njëri është konfirmuar në detyrë dhe tjetri i shkarkuar. Sikurse më tregojnë shifrat, janë 4 kandidatë apo me saktë 3, vendimet e të cilëve janë ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe, e fundit, janë ende 7 kandidatë magistratë të cilët nuk janë shqyrtuar nga KPK-ja.

Këto të dhëna i kisha më shumë për informimi tuaj. Prandaj është e rëndësishme se pse duhet të miratojmë aktet në rregulloren e brendshme dhe atë të funksionimit sepse puna që parashikohet është shume voluminoze dhe komplekse. Ne kemi Presidentin e Republikës dhe Kuvendin, të cilët janë të gatshëm dhe vetëm presin nga Këshilli Emërimeve në Drejtësi që të sjellë kandidaturat e renditura. Gjykata e Lartë nuk është në gjendje, për momentin, të ushtrojë misionin e saj për të zgjedhur sepse aktualisht ka vetëm 3 gjyqtarë. Por Presidenti i Republikës dhe Kuvendi presin kandidaturat e renditura nga ana jonë. Kjo është prognoza e punës dhe kjo është ajo që doja të evidentoj dhe të ndaja me ju. Nëse keni për të diskutuar ndonjë gjë?

Erinda Ballanca - Kam një pyetje që më ka shqetësuar vazhdimisht. Ju falënderoj njëherë shumë për panoramën e të gjithë emrave dhe kandidimeve. Nuk e kam çështje verifikimi. Kjo është një tabelë e cila nuk përbën një dokument zyrtar që ne do ta miratojmë apo nuk do ta miratojmë, kjo është një panoramë, e cila nëse ka çështje që duhen saktësuar, rregulluar, mund të saktësohen. Ajo që unë shikoj dhe që ve re është numri i madh i kandidaturave që ju duhet të vlerësoni dhe unë do të jem pjesëmarrëse bashkë me ju për efekt të vlerësimit nga jashtë sistemit të drejtësisë.

Pra ka një numër të lartë kandidatësh për të cilët KED duhet të bëjë vlerësimin, pra vetting-un ta bëjë ajo, atë që ka hyrë si fjalë, rëndom, si vetting. Unë gjykoj që standardi i vetting-ut duhet të jetë i njëjtë me standardin, i cili është përcaktuar për gjyqtarët, pra

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

standardi duhet të jetë shumë i lartë dhe, në fund të ditës, nuk ka pse persona jashtë sistemit të kenë një standard besueshmërie tek publiku të ndryshëm nga persona brenda sistemit. E nëse ky do jetë standardi që ky organ do zbatojë, unë dua të di se me çfarë kapacitetesh njerëzore do ta bëjë këtë punë? Ky është një problem shumë i madh sepse sado që ne të përgatitemi, edhe pa papërcaktuar rregullat, duhet ta kemi të qarte dhe pa u marrë vendimi i rregullave, duhet të jemi të qarte, se do të duhet të keni në këtë organ persona të specializuar dhe të bëjnë punën reale të verifikimit dhe ne do të duhet të dërgojmë, menjëherë mendoj, kërkesat buxhetore në lidhje me këtë çështje. Në qofte se nuk identifikojmë kërkesat për burimet njerëzore për këto kapacitete, së pari duhet të pyesim Kryetarin e Gjykatës së Lartë nëse i ka ai këto kapacitete, sepse ligji e përcakton atë si individin parësor Por unë nuk kam parë ndonjë rritje në buxhetin e Gjykatës së Lartë në lidhje me këtë çështje apo ndonjë përcaktim buxhetor apo zë në lidhje me këto çështje, në mos duhet të bëjmë kërkesat buxhetore që ti japim mundësi Kuvendit që, në një mënyrë apo në tjetër, ta adresojnë këtë problematikë. Sepse pa personel unë e shoh, edhe sikur *full time* të punojmë ju dhe ne, është e pamundur me këtë numër të madh kandidatash dhe me një proces të tillë vlerësimi që me sa duket do të jetë me standard i caktuar, besoj që do të duhet të kemi domosdoshmërisht persona me kapacitete, burime njerëzore të cilat duhet të jenë në dispozicion të këtij organi për këtë çështje. Faleminderit.

Ardian Dvorani - Faleminderit Zonja Ballanca. Në fakt e kemi vendosur si pikë të fundit të rendit të ditës. Kjo ka qenë logjika e rendit të ditës, pra të marrim informacion dhe për çka na nevojitet për ta bërë këtë punë. Prandaj unë e vlerësoj shumë që ju e ngritët por e kemi pjesë të programit. Nuk e di. A ka ndonjë koment tjetër paraprak?

Enkelejd Alibeaj - Ajo që parashtroi Avokatja e Popullit unë mendoj se është një nga çështjet me të rëndësishme që do të përcaktojë mbarëvajtjen apo dhe suksesin e veprimtarisë eventuale të KED. Kam përshtypjen që nga çështjet me të rëndësishme do të duhet të jetë kjo për tu përballur nga ju.

Ligji për Gjykatën Kushtetuese përcakton në nenin 7/A të tij kushtet dhe kriteret. Pika 1 shkronja “dh”, thuhet të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe familjare të tij sipas ligjit. Më poshtë, bëjmë një referencë, tashmë jo si kusht por si kriter, tek aftësitë profesionale dhe integriteti i tij moral. Çështje që duhet ti përballojë KED-ja. Ndërkohë, kandidat për Gjykatën Kushtetuese ka jo gjyqtarë, anëtarë nga ju dhe magjistrat, për shkak të Kushtetutës dhe procesit që është në vazhdim ata janë duke iu nënshtruar një procesi rivlerësimi në tre kritere sipas ligjit, disa prej të cilëve janë, ose e kanë kaluar, ose do ta kalojnë.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Çështja që duhet të zgjidhet, sipas mendimit tim, është cili do të jetë autoriteti që do të ezaurojë, së paku, kushtin e pikës 1 shkronja “dh”, procesin e kontrollit dhe të verifikimit të pasurisë. Sepse janë vendosur dy kritere e tjera janë vendosur si kritere kualifikuese e duhet ta bëj dallimin midis kushtit dhe kritereve. Duhet ta bëni ju apo do të bëjnë organet e vetting-ut sipas ligjit. Nuk jam duke marrë pozicionin, o njëri o tjetri, veçse së paku po ngre problematikën. Nëse do ta bëni ju, siç edhe ligji thotë, rreziku më i madh është që nëse do ta bëni të përshpjeguar e do ta bëni vetëm për pasurinë, dhe eventualisht kandidati magjistrat për në Gjykatën Kushtetuese rezulton i suksesshëm, të keni parasysh që procesi paralel që zhvillohet prej vetting-ut mund të mos ketë të njëjtin përfundim. Besoj që është një figurë e shëndetshme që mund ta bëjë Këshilli. Alternativa tjetër është që ta bëjmë organet e vetting-ut, për sa kohë që referenca është sipas ligjit, e cila, nga ana tjetër, sjell një tjetër implikim, çështjen e barazisë para ligjit apo të diskriminimit që Avokatja sapo e tha. Si standard kushtetues, detyruet, nëse je magjistrat dhe kandidon për në Gjykatën Kushtetuese dhe nëse i nënshtrohesh rivlerësimit prej organeve të vetting-ut, të njëjtin fat duhet të kenë edhe të tjerët e askush nuk duhet ti shpëtojë. Implikimet ju besoj i kuptoni vetë dhe nuk ka nevojë që ti them. Por kjo, sjell një implikim tjetër, akoma dhe më të rëndë, parë ritmin e veprimtarisë së organeve të vetting-ut, nuk po i futem cilësisë. Vetëm ritmit. Duke parë edhe numrin e atyre që kanë kandiduar, prej magjistratëve, apo nëse do ti nënshtrohen, të të gjithëve, kam përshtypjen që nuk e ngremë dot Gjykatën Kushtetuese, edhe sikur ta kërkojnë me ngulm Presidenti a Kuvendi. I solla këto në vëmendje thjesht dhe vetëm për tu matur temporitmin e veprimtarisë. Ndoshta dhe mund të shkojë deri edhe pamundësia fizike për të verifikuar 37 kandidatë, përveç të tjerëve. Të mbahen në vëmendje, pastaj për zgjidhjen e situatës mendojeni ju më mirë. Faleminderit.

Ardian Dvorani - Faleminderit, unë i vlerësoj shumë të vlefshme edhe këto problematika që u ngritën . Në fakt puna për hartimin e projektakteve që kanë të bëjnë me verifikimin dhe vlerësimin duhet të zgjidhin edhe këto pikëpyetje. Nuk kam asgjë për të shtuar në këtë pikë. Janë shqetësime që qëndrojnë dhe ne duhet të diskutojmë paraprakisht para se të fillojmë punën dhe do të jetë grupi i punës dhe puna e jonë që duhet ti analizojë dhe të zgjidhë këto probleme.

Në lidhje me pikën tjetër të rendit të ditës “Informacion për problematikën lidhur me pozicionin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, numrin e kandidaturave dhe administrimin e dokumentacionit përkatës”, për informacion janë kandiduar, deri më tani, 3 kandidatë. Kanë qenë 4 në fakt, por njëri nga kandidatët është dorëhequr, kështu që aktualisht numri është 3. Janë dy kandidate magjistratë dhe një kandidad jomagjistrat. Një

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

kandidat magjistrat ka kaluar shkallën e parë të procesit të vetting-ut nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, por vendimi është ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Kolegia tjetër kandidate magjistrate ende nuk ka kaluar në shkallën e parë të rivlerësimit pranë KPK-së. Kemi një kandidate jomagjistrate, e cila, siç u tha nga parafolësit duhet të “vettingohet” nga ne, se me çfarë parametrash pastaj do ta vendosim bashkë, duke vlerësuar drejtë dhe saktë ligjin.

Meqenëse me të drejtë këtu u evidentuar që këto kandidatura kanë më prioritet, e mira është që të miratojmë rregullat e brendshme dhe mënyrat si do të veprojmë dhe si do të vendosim. Unë nuk po shkoj më tej, por lidhur me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë mund të kemi dhe një diskutim, sipas mendimit tim, sepse Kushtetuta në këtë rast parashikon 5 kandidatë, të renditur dhe të zgjedhur nga KED dhe ne jemi organi që bën shpalljen dhe çojmë në Kuvend numrin e kandidatëve. Por, kaq vetëm sa për informacion. Nuk kam asnjë pozicion për të mbajtur në këtë moment. Këto kisha për të thënë, emrat i keni aty, i njohim besoj të gjithë.

Nëse nuk keni gjë për të diskutuar unë them të kalojmë edhe tek pika e fundit e rendit të ditës. Disa gjëra u anticipuan nga unë më parë, por edhe tani nga Avokatja e Popullit dhe nga zoti Alibeaj në fakt.

Pika e rendit të ditës është lidhur me “Çështje të organizimit, dokumentimit dhe administrimit të dokumentacionit dhe të çështjeve, si edhe mbi nevojat e mbështetjes administrative dhe me personel nga gjykata e lartë për mirëfunksionimin dhe efektivitetin e veprimtarisë së këshillit të emërimeve në drejtësi.”.

Unë nuk dua ti përsëris. Bashkërisht, për të gjitha pozicionet vakante, kanë kandiduar 40 kandidatë, 23 prej tyre janë jomagjistratë. Kapacitet tona, problemi i parë është që nuk jemi 9 por jemi 7 gjyqtarë të K.E.D-së, madje dhe zëvendësues nuk janë 5, por janë 3. Kështu që, në asnjë rast, ky Këshill nuk do të ketë më shumë se 7 relatorë, kjo është e pamundur të ndodhë. Pra e kemi një minus në kapacitetin tonë njerëzor për të caktuar relatorë dhe për ti ndjekur çështjet. E dyta, po këtu kemi një problem që e kemi për vete, mendoj unë, po edhe e kemi pastaj për pjesën tjetër që na mbështet. Nuk kemi asnjë përvojë të mëparshme që të bëjmë *screening*, që të bëjmë vlerësimin e kandidaturave dhe ndoshta nuk kemi asnjë trajnim paraprak për të kryer këtë proces. Mund të na shërbejë ajo e komisionit të vetting-ut, unë mendoj që po, por nuk e di.

Erinda Ballanca - Por ata nuk kanë bërë asnjë trajnim, as vetë.

Ardian Dvorani – Nuk e di se si e filluan dhe se si e bënë përgatitjen, por, ndoshta, duke filluar nga anëtarët e Këshillit dhe ata zëvendësues, unë mendoj që mund të vetofrohem

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

dhe të kërkojmë një mbështetje për të marrë një lloj trajnimi, për të marrë një eksperiencë, besoj nga OMN-ja, kjo lidhur me metodiken e vlerësimit sepse pjesa tjetër ligjore është në ndërgjegjen dhe përgjegjësinë tonë duke vlerësuar kriteret. Ky është një sugjerim i im. Problemi tjetër që ka të bëjë me kapacitetet është që Gjykata e Lartë aktualisht ka jo vetëm 3 gjyqtarë në detyrë, por nuk ka 38 këshilltarë ligjorë siç mendohej të kishte. Aktualisht ka vetëm 9 këshilltarë ligjorë Gjykata e Lartë. P.sh nesër është një ditë e tmerrshme për ne, sepse ata, sipas programit, do të vijnë të gjithë, njëri pas tjetrit, në dhomën e këshillimit gjatë gjithë ditës e deri në mbrëmje për të relatuar. Pra janë vetëm 9 këshilltarë ligjorë dhe ata duhet të përballojnë një punë jo të vogël. Mund t'ju them që ne, nuk neglizhojmë, por mund të rezervohemi pak për të trajtuar rekurset, për shkak mungese kapacitetesh, ndërkohë ka një numër shumë të madh të vendimeve të ndërmjetëm, për juridiksionin, konfliktet e kompetencave, për pezullimet, për afatet e arsyeshme etj. etj., të cilat janë vendime që nuk mund të presin et janë vendimet që mund të bëjë treshja që ka mbetur është e detyruar ti gjykojë. Edhe prandaj këshilltarët janë shumë të ngarkuar. Për ta vlen i njëjti problem, për mendimin tim, edhe këta janë njerëz pa përvojë dhe të pa trajnuar. E treta, sipas urdhrave që ka nxjerrë vitin e kaluar Kryetari i Gjykatës së Lartë, ishte caktuar një këshilltar, është një sekretare, një punonjës i IT dhe specialistja apo përgjegjësjë e zyrës së shtypit dhe mediave. Janë 4 punonjës mbështetës, nuk janë me kohë të plotë, e ndajnë detyrën dhe ky është një diskutim.

Unë do të sugjeroja, nëse kam dhe përkrahjen tuaj, sigurisht unë do ta bisedoj dhe informalisht, por në mënyrë zyrtare ti kërkoja Kryetarit të Gjykatës së Lartë për të angazhuar menjëherë pranë Këshillit së paku 4 nga këshilltarët, madje duke përcaktuar rezervë dhe 2 këshilltarë të tjerë, pastaj do të shohim nga dinamika si kjo nuk është gjë e fiksuar. Unë mendoj se duhet ta kërkojmë këtë numër, se siç e thashë janë dhe ata të pa trajnuar, nëse do të gjejmë mbështetje, nëse do të jeni dhe ju dakord, sigurisht do të këtë nevojë për një trajnim apo për shkëmbim eksperience, duhet të dihen ata që do të përfshihen në këtë proces dhe që të marrin informacion dhe trajnimet e duhura për ta kryer punën e tyre për aq sa ju takon për punën që do bëjnë.

Kemi vetëm një sekretare. Meqenëse Këshilli pararendës nuk kreu veprime konkrete për verifikimin dhe vlerësimin e kandidaturave, punonjësja e ngarkuar nuk ka qenë shumë e ngarkuar, por nëse fillon procesi, unë mendoj që me atë që përmenden disa nga koleget, ne praktikisht më shumë se gjysmat nga kandidaturat mund të bëjmë një vetting praktikisht të plotë, e unë e kam kaluar vetë vetingun dhe disa prej nesh, ndaj e di se sa shumë shkresa dhe dokumente bëhen, lëvizin dhe qarkullojnë për secilin nga kandidatët, pa përmendur pastaj

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

faktin që për secilin do merret nga një vendim e kështu me radhë. Pra nevojitet që ti sugjerojmë Kryetarit të paktën dhe një sekretare tjetër, madje nga sekretaria gjyqësore dhe nga ato që kanë një eksperiencë të mirë, sepse ne kemi çështjen e administrimit të kandidaturave dhe të vakancave. Dua që të regjistrohet dhe jo thjesht të protokollohet, por të ketë një koncept që është një çështje çdo kandidat dhe çdo vend vakant është një çështje dhe ka nënçështje secili kandidat. Çdo gjë duhet të jetë i monitoruar, për afate korrekte, në adresën ku drejtohet, si e kur merret përgjigje, si komunikon, vendimet duhet të jenë aty, një regjistër vendimesh dhe kështu me radhë. Pra ti kërkojmë dhe një sekretare, të paktën një.

Erinda Ballanca - Një propozim të vogël kam, se në fakt më pëlqeu si ide ky fakti që këshilltarë janë me pak se numri i kërkuar. Me një justifikim të asistentes që duhet ti jepet e KED, meqenëse buxheti ekziston duhet që menjëherë të nisë rekrutimet Kryetari i Gjykatës së Lartë për vendet vakante se buxheti qenka, për këshilltarët është, ekziston buxheti për këshilltarët. E kjo më gëzoj që nuk ka nevojë që të zgjidhet për momentin në një buxhet tjetër dhe mundet që të na e zgjidhë Kuvendi në miratimin e buxhetit 6 mujor që bëjnë atë si rregullim sepse ndoshta deri atëherë do jetë plotësuar edhe Gjykata e Lartë me anëtarë dhe do të duhet të kemi njerëz dhe kapacitete të tjera. Por, provizorisht u gëzova shumë që qenka mundësi tek buxheti për efekte të këshilltarëve, janë edhe ndoshta numri i këshilltarëve nga personat të cilëve iu ka përfunduar kontrata për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtarëve, mund të ketë nga këta persona. Unë di që një pjesë e këtyre kanë shkuar në magistraturë, por ky fakt mua më gëzon që, nga njohja e problematikave buxhetore në institucionin që unë punoj është pak më e thjeshtë nga sa e kisha menduar. Faleminderit, më fal që ndërhyra por u entuziazmova.

Ardian Dvorani - Nuk ka asnjë problem, thjesht e bëra me shenjë për shkak se, me aq sa kam unë dijeni, në kuadrin e ri të Reformës në Drejtësi është KLGJ-ja ajo që mund të vendosë. Kryetari i Gjykatës së Lartë thjesht mund të informojë në KLGJ dhe unë e mbajta shënim që, në komunikimin zyrtar që do ti bëjë KLGJ-së, përveç problemit të ngarkesës sonë të kërkojmë të bëjë vakancat për këshilltarë.

(ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Më ndiqni një minutë ju lutem, meqenëse e vendos KLGJ-ja, pjesa e asaj që thashë se çfarë problematikash kemi ne, mund ti shtojmë edhe këtë element, apo jo zoti Medi, procedoni dhe me vakancat për këshilltarë. Pastaj aty ka dhe disa raporte që disa duhet të jenë magistratë dhe disa jo, por kjo nuk është çështja jonë. Ne thjesht e tentojmë, ky nuk është problem buxheti, jam dakord me ju, është problemi që sa dhe si do të jetë në gjendje KLGJ ta përmbushi këtë dhe sa kohë i duhet, nuk e di.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Medi Bici – Ka edhe probleme të tjera se edhe këta që janë duhet të kalojnë në vetting.

Ardian Dvorani - Ne do ta tentojmë, nuk e di. Ju lutem. Ne do t'ja kërkojmë, e përmendën dhe disa të tjerë, ne nuk e dimë kur komisioni i i pavarur i kualifikimit do të votojë anëtarët tonë ose kandidatët, por ne kemi për detyrë ti drejtohem me shkresë, ti kërkojmë, ti sjellim në vëmendje të zbatojmë ligjin sa më shpejt, kaq.

Një çështje tjetër e fundi. Meqenëse mund të bëhet, ndonëse praktikisht nuk e di nëse dhe në çfarë formati ne do të bënim ndonjë lloj vetting-u, sidomos për kandidatët jomagjistratë, me aq sa po shohim tek vetting-u, ata kanë këshilltarë ekonomik, sepse duhet të bëjnë një analizë financiare. Gjykata e Lartë ka dy zonja të nderuara që janë punonjëse të financës sonë, janë dy apo 3 zonja të financës, të cilat sigurisht do ti drejtohem me kërkesë Kryetarit që të gjitha ose dy prej tyre të angazhohen në këtë proces. Por ato kanë eksperiencat dhe profilet e tyre personale, por nuk e di se sa do ta kenë kapacitetin për ta bërë këtë detyrë. Por edhe ato, gjithsesi, pastaj duhet të bëjnë trajnim sepse është e njëjta situatë.

(ndërrhyrje pa mikrofon nga salla)

Eriol Roshi – Vetëm se është problemi që ligji për rivlerësimin kalimtar, me sa e kujtoj, këta persona që përmendëm e që janë eksperte të ekonomisë, ekspertë nga fushat e tjera kanë një status të caktuar dhe ata e dinë se çfarë bëjnë sipas ligjit, çfarë veprimesh kryhen. Problemi është se si dhe kush do e përcaktojë kornizën normative ku mund të veprojnë këta persona.

Ardian Dvorani - Jam dakord me juve, por ligji e thotë që personeli administrativ është nga Gjykata e Lartë. Unë nuk e di tani se ne nuk do bëjmë xhonglime dhe ti themi KLGJ-së gjejini ku janë ekspertë e që janë financierë etj, nuk e di a është e mundshme kjo gjë. Por unë po them thjesht faktin që janë vetëm 3 zonja punonjëse të financës e që nuk e di nëse i plotësojnë kushtet ligjore që të mund ta bëjnë këtë punë. Unë jam i detyruar t'ia ngarkojë Kryetarit të Gjykatës dhe ai te më japë shpjegime nëse mund të plotësojnë kërkesat.

Fatri Islamaj - Lidhur me këtë çështjen e ekspertëve të fushës së kontabilitetit, të financës apo të vlerësimit të pasurive të çfarëdolloj, unë mendoj që është shumë e vështirë që të presim që këtë punë ta bëjë ndihmësit ligjorë të Gjykatës së Lartë, qofshin ata që janë në detyrë, qofshin ata që mund të rekrutohen edhe pse me emergjencë Ndaj e mbështes plotësisht mendimin tuaj që Këshilli i Emërimeve, ju si kryetar e tij dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë të vihen në lëvizje në komunikim me K.L.GJ që me përparësi të hapin procedurën për plotësimin e vendeve vakant në Gjykatën e Lartë për ndihmës ligjor. Problemi është se ndihmësit ligjor nuk i kanë këto njohuri të posaçme në këto fusha që po flasim ne dhe nuk

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

është gjë e pamundur për tu zgjidhur, pasi administrata e gjykatave, përfshirë dhe Gjykatën e Lartë, përfshijnë në administratë jo vetëm ndihmësit ligjor por edhe staf tjetër administrativ siç ju përmendet e që janë dy zonjat të cilat mund të bëhen edhe 12 nëse është vullneti i Gjykatës së Lartë dhe mbështetet financiarisht nga fondet dhe burimet financiare të Gjykatës së Lartë, duke vendosur një numër ose një set të caktuar kriteresh për rekrutimin, qoftë dhe me kohë të pjesshme një vjeçare ose më tepër, për një staf të kualifikuar dhe karakter kontabël financiar apo vlerësues pasurish. Kjo është çështje tjetër, nuk lidhet me KLGJ.

Gurali Brahimllari - Mund te shikohet dhe mundësia e angazhimit të personelit administrativ që ndodhet në zyrën e buxhetit gjyqësor dhe ka një varësi nga Gjykata e Lartë dhe në qoftë se mund të angazhohen.

Ardian Dvorani - Ata janë të KLGJ-së tani. Ka ndryshuar realiteti sepse është K.L.Gj dhe titullarët e gjykatave kanë ato kompetenca që kanë por nuk mund të vendosin më për disa gjëra. Dhe e fundit është, unë e thashë pak më përpara. Po ? Më fal.

Eriol Roshi – Në qoftë se do të ndalojmë një subjekt për të marrë pjesë se nuk e plotësuar kriterin e pasurisë a do ti themi që është për shkak të analizës financiare të bazuar me këtë mendim që e ka dhënë filani ti nuk e justifikon dhe je i ndaluar për të vazhduar më tej. Në dallim, nga ne gjyqtaret, domethënë, që nuk kanë kujt ti drejtohen përveç KPA, këta mund të shkojnë në gjykatë nesër dhe është procedurë tjetër. Duhet të jemi pak të kujdesshëm.

Ardian Dvorani - Nëse ne vendosim me vendim skualifikimin, kandidati ka të drejtë të shkojë në gjykatë,

Eriol Roshi – Dhe ai do të thotë që këtë provë e ke marrë nga një personel i pakualifikuar.

Enkelejd Alibeaj - Më fal Kryetar, e thashë edhe njëherë në pozicionin që jam, e ngrita si çështje dhe do të doja që diskutimi do të vazhdojë, do doja një sqarim nëse dikush mund të ma thotë apo nëse është një çështje që do të vendoset më vonë. Dhe çështja për të cilën nuk jam i qartë të them të drejtën është kjo, do të procedohet me një vetting paralel, pra në një autoritet tjetër, juve, ndryshe nga organet kushtetuese që po e realizojnë këtë apo jo? Përse po pyes, sepse unë nuk e kam për interes personal por është çështje e cila e implikon, sipas mendimit tim, situata kushtetuese dhe jo vetëm. Këtë e kam për ta analizuar nëse ju bëni si KED bëni një vetting paralel, për një komponent, që do të thotë ligji, siç unë e lexoj, a nuk do të kishim paragjykim për ata magjistratë, të cilat janë në ezaurim e sipër të procesit të vetting-ut, kur atje ende s'ka mbaruar? Unë besoj se kjo është çështje me implikim kushtetues. Tjetra, ata të cilët e kanë përfunduar tashmë, po themi fatkeqët të cilët janë

rrezuar, me çfarë pashë unë, të paktën njëri është kandidat, tani atij do ti merret i mirëqenë fakti që vettingu e ka rrezuar dhe i pengohet kandidimi në Gjykatën Kushtetuese, meqenëse është dhënë një vendim apo jo? Edhe ky është një implikim i natyrës kushtetuese. Nëse ka ndonjë përgjigje për këtë unë jam shumë i interesuar, sot apo javës tjetër, por meqenëse po shoh që po diskutohet çështja rreth kësaj situatë.

Ardian Dvorani - Faleminderit

Enkelejd Alibeaj - Më fal. Pse po e them? Edhe njëherë po e them sepse nëse do të njëra apo tjetra alternative, po e them që nuk është faji juaj as problemi juaj, por është faji i ligjit i shkruar keq, pa i harmonizuar atëherë kur bëheshin këto projektligje në mënyrë të njëanshme. Zgjidhja e vetme në situatë të tilla që tejkalon kapacitetet tuaja në këtë pozicion eventual apo edhe të mirëbesimit, ngelet vetëm tek ndryshimet ligjore. Sigurisht kjo nuk është lënda apo brumi në diskutimin tuaj. Por e thash, në këtë pozicion që jam, duhet të marr perceptimin dhe ndjesitë tuaja që mund pastaj ti përcjell aty duhet, ku jam si përfaqësues i Kuvendit. Për këtë arsye e bëra dhe këtë ndërhyrje.

Ardian Dvorani - Po, zonja Tusha?

Vitore Tusha - Jemi të njohur me këto çështje. Në momentin kur do të miratojmë rregullat dhe lidhur me kërkesën e nenit 229/pikën 2, për rregullat dhe procedurën e verifikimit, mendoj se është një çështje shumë e rëndësishme kjo që ngrihet, të cilën ne do ta diskutojmë sipas kriterit të përcaktuar nga neni 7 e ligjit për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, të lidhur me rregullat që përcakton neni që sa po citova, 229 pika 2, 235, apo edhe më pas kemi nenet 236, 237, pra lidhur me interpretimin e këtyre dhe kjo do të jetë çështja më e rëndësishme që do të diskutohet në rastin kur ne do të shqyrtojmë, diskutojmë dhe miratojmë këto rregulla.

Ardian Dvorani - Zonja Memçaj, e kërkuat fjalën?

Fatjona Memçaj – Jo. Nuk është më nevoja. Kjo që sapo u tha ishte çfarë do të parashtroja.

Ardian Dvorani - Patjetër që do të diskutohet dhe nuk mund të mbajmë një qëndrim sot, sepse edhe vetë thamë që po nuk patëm rregullat e brendshme nuk procedojmë më tej. Sigurisht do ta mendojmë dhe çdo gjë është e vlefshme nga çfarë është thënë sot në këtë mbledhje, nga minuta e parë dhe deri tek e fundit, për mua. E sigurt me çfarë shoh unë, të paktën për ata që janë jomagjistratë, edhe për parimin e barazisë që ngritën disa nga ju, nuk mundet që edhe jomagjistratët të kenë një proces rivlerësimi të “lehtë” po themi, ndërsa magjistratë është një proces rivlerësimi aq të thellë. Ndonëse të mbahet parasysh që procesi i rivlerësimit ka qëllim tjetër, ndërsa ky ka për qëllim promovimin e jo verifikimin e

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

përshatshmërisë. Por, gjithsesi unë e gjej si të nevojshme që të mos barazohen por të afrohem, por nuk e di do ta diskutojmë këtë gjë. Kjo është lënda dhe kjo na implikon pastaj dhe për kapacitetet që kemi ne. Por është e sigurt që disa kapacitete ne do na duhen, a do na duhen 3 ose 6, kjo pastaj varet se deri ku do shtrihet kompetenca jonë e verifikimeve dhe vlerësimit.

Edhe momentin e fundit, unë e thashë më përpara. që meqenëse pritshmëria është se ngarkesa e punës do të jetë e madhe, do ti drejtohem KLGj-së, tani po i bie shkurt dhe do ti kërkojmë që për kolegët të këtë lehtësim apo shkarkim nga ngarkesa, sipas situatës, sepse ne jemi gjyqtarë e prokurorë dhe ne i dimë punët tona të përditshme. Të jesh anëtar relator për një pozicion vakant do të qëllonjë 10 kandidatura, është një punë shumë e madhe edhe përse do të këtë personel mbështetës, por ka edhe 22 në një rast. Ndaj do të duhet të jetë edhe fizikisht në Gjykatën e Lartë dhe kështu me radhë. Mendoj që këtë parashtrim duhet ta bëjmë dhe shpresojmë të gjejmë dhe mbështetje. Pra jo vetëm fjalë por të kemi mbështetjen për të gjitha problematikat për mirëfunksionimin e KED. Nëse nuk keni gjë tjetër?

Gurali Brahimllari - Unë mendoj që shqetësimi lidhur me kontrollin që do këtë KED është i kapërcyeshëm nga vetë ligji, pasi mendoj që, sipas nenit 235, nuk kemi asnjë atribut që të bëjmë vetting apo të kontrollojmë persona, por të gjithë veprimtarinë do ta kryejë ILDKP dhe rezultatin e ILDKP-së duhet ta marrim të mirëqenë, sipas mendimit tim. Në qoftë se kandidati ka problematikë do ti drejtohet gjykatës administrative. Pra unë po them se nuk ka nevojë, për mendimin tim, as për këshilltarë ekonomikë, as këshilltarë të tjerë, por vetëm plotësimi i formularëve që përcillet tek ILDKP dhe pastaj gjykata administrative që do ta zgjidhë. Ky është mendimi im.

Ardian Dvorani - Në rregull zoti Gurali. Ta shikojmë kur ta diskutojmë.

(ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Ardian Dvorani - Nëse nuk kemi gjë tjetër mund ta përfundojmë mbledhjen për sot dhe unë ju falënderoj shumë për durimin dhe për angazhimin dhe, deri në mbledhjen e ardhshme, të hënën në orën 15.00, faleminderit dhe javë të mbarë.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretari

Redjona Myrtja

Kryetari

Ardian Dvorani

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi